How then should the library community respond to the external pressure of competing service providers on the one hand the internal pressure of outmoded service models on the other? I wish I could say that one particular software package or hardware configuration is the answer. Certainly, the work of some of your libraries to migrate to an automated catalog is an example of the significant steps libraries all over the world are taking. Unfortunately, the solution to the library community's dilemma will not boil down to one answer, one process, or one list of actions to take. It will take many actions, some successful and some not successful before the library community will have realigned itself to the new realities of information technologies. I would like to take a few minutes to discuss some of examples of how the library community has already been taking actions to transform itself to met the needs of its users. These actions alone will not align libraries with the realities of the 21st century information technology, but these and hundreds like them are a good start on this journey of change. Let me first draw your attention to how some library networks around the world are using technology to change their traditional concept of collections within their library network. Most library networks, such as those in a public library system, have a separate collection fro each facility in the network. When these library networks migrate to an Integrated Library System, they maintain the traditional notion that each item within the library network belongs to one specific facility.

An automated catalog helps make management of the many separate collections within a library network more efficient by tracing the movement of materials among facilities. With many integrated library systems, users can go online and request an item from any library facility in the network. The automated catalog then tracks the shipping of the item from the home library facility to the facility nearest the user. When the user returns the item at her local facility or return an item to the wrong facility, the automated catalog will generate a system prompt that tells a library staff to return the item to its home, or owning, facility. This system capability enables the user to get and return information without having to travel great distances.

A willingness by some library networks to consider how technology might alter this traditional process has resulted in a radically different view of collections within library networks. These networks have started creating what they call "floating collections." If you have not already heard of floating or home collection when the user returns an item to the wrong facility, the place where an item is returned becomes the new "home" for that item. This solution is only possible because, with online catalogs, staff do not need to go and change the location printed on every card in every card catalog throughout the library network. An automated system means that locations can be changed one time, in one place. When an item is returned, staff make a couple of clicks and the location changes in the catalogs of all the facilities in the network. The item can then be shelved at the facility in which it was last used. As a result, library networks that have floating collections are shifting to the view that the network has one collection rather than as many collection as there are facilities in the network.

These libraries that have adopted the concept of a floating collection are finding that the benefits of rethinking traditional library models can be great. The expenses related to transporting materials is greatly reduced, with some libraries reporting reductions between seventy to eighty percent.15 Libraries are also able to spend considerable fewer resources purchasing items so that each facility in the system can have its own wide variety of materials. As materials float thought the library network, users have the advantage of being able to browse different materials without the library having to make additional purchases. Imagine how dynamic the collections of a library network must be with hundreds of thousands of items floating among its library facilities each year.

Floating collections may not be the best solution for every library network, but library network, and the library community in general, can learn from its lessons. The concept of floating libraries demonstrates that the implementation of technology to realign library activities does not always require tremendous technological skill. In fact, technological solutions can be quite simple. It also illustrates how thinking beyond traditional concepts of libraries can often bring dramatic and positive changes.

The small town I grew up in did not have a library that could float. It did, however, have a library that rolled. Like many towns without permanent library facilities, my town benefited from the regular visit of a bookmobile. It is this example, the case of technology changing even than old workhorse like the bookmobile, that I want to talk about next. Bookmobiles, as many of you probably already know, are usually large buses that have been converted into rolling libraries, They travel from town to town throughout a region, brining small, select collections to those who might otherwise never visit a library. Even though the collection on the bookmobile that traveled to my town was small, the weekly visit of the bookmobile was a magical time when new ideas and new information came into our sometimes dull town. This traditional service has been provided for decades to countless individuals around many parts of the globe. It took Brewster Kahle, however, to see how the traditional bookmobile could be transformed by combining the technology of desktop publishing and satellite-based Internet connections with a paper cutter. Kahle's bookmobile, dubbed the Internet Bookmobile, downloads Internet books that are free of copyright restrictions, prints them

with a personal computer and high-end printer, and uses a paper cutter and a desktop binder to put them in book form. These print-on-demand books cost less than E1 each to produce. In fact, the Internet bookmobile itself const only about E12,000 for the equipment plus the price of the minivan.16 The idea for an Internet bookmobile has caught the attention of leaders around the world. In areas where libraries are few and Internet access is limited, many leaders are now considering the full range of possibilities that an Internet bookmobile offers. India's Department of Information Technology, for instance, has started a Mobile Digital Library to promote literacy in villages and remote areas.17 In Uganda, efforts are underway to use the Internet Bookmobile model to disseminate health information, turning it into a traveling health library. The concept is to build an online database of health literature that has been translated into all major Ugandan languages. The Internet Bookmobile will roam the country downloading and printing these materials for populations that do not have access to a medical library.18 Even if libraries are not eager to print millions of books for their users, the Internet bookmobile illustrates a way I which libraries can bring the Internet and other information technologies to underserved users for relatively little cost. In fact, many librarians are discovering that it does not take tremendous founding to take better advantage of technology. Sometimes, it simply requires libraries to prioritize resource usage. If you will indulge me, I would like to relate an experience that I had a few years ago that demonstrates this point. Before I started working at the Library of Congress, I worked in a medium-sized university library. I walked into my office my first day on the job at this university library and faced an overwhelming site. Every available space -- my desk, my table, the chairs at the table, and parts of the floor had pile after pile after pile of unprocessed materials. Although it did not seem like it the first day on my new job, fortune was on my side. I had great coworkers who, facing piles and piles of materials on their desks, wanted something different.

Around this same time, we started shifting collections and discovered a rich collection of World War II era pamphlets and posters. We also discovered that many boxes of these materials had been discarded a couple of years before in an effort to eliminate some of the piles of materials lying around our department. It was clear that something had to be done. We were being

overwhelmed with processing demands on the one hand and , on the other hand, materials that could be of high value to information seekers were being thrown in the trash. We resolved to do two things. Eliminate processing backlogs and promote the inherent value of the collection.

Eliminating our processing backlog became quite simple. We stopped processing. We were already subscribing to a cataloging service that gave us catalog records for each shipment of materials. Our processing involved us putting a barcode on every time in a shipment, searching our catalog for each of these items, and, once a match had been made, linking each catalog record to each barcode. This was a very labor-intensive process. Our solution came when we realized the implications of our automated catalog's ability to barcode items on demand. With many Integrated Library Systems, if an item does not have a barcode, a barcode can be attached to an item at the circulation desk when a patron wants to check it out. Our collection was not high-use, and we decided that the benefits or waiting until someone wants to use an item before putting on a barcode outweighed the problems that this would cause. We stopped bar-coding, and our backlogs, as a result, disappeared.

With our backlogs gone, we freed up valuable staff time to work on promoting the inherent value of our collection to information seekers. We had few other resources and did not have much money to embark on the project. The money we did receive went most to buy a few desktop scanners at around E200 each. We took advantage of the existing resources where we could. Our campus technology department gave us service space and we decided to use our Integrated Library System to mange the digital collection We also benefited from the guidance published online by the Library of Congress and reports sponsored by the Council on Library and Information Resources. By setting priorities and taking advantage of available technologies, we were able to complete a small project that has generated enough feedback and use to keep the collection from the trash bins.

Our work to create a digital collection was a very small drop in the ocean of activity that is blurring the distinction between libraries, which have traditionally stored information, and publishers, whose traditional role has been to produce information. I would like to mention this topic at least briefly because this transformation from purchasers of information to producers of

information is going to be one of the most important change for libraries in the 21st century.

Even though it has taken a little while, libraries had librarians have now come to a general consensus that helping information seekers get information in the age of Internet access often means that they have to produce contents. This has transformed many institutions around the world. Most major libraries now list the creation of digital content as one of their core activities. The Association of Research Libraries Digital Initiatives Database lists some 569 digital collections that have been registered by its member libraries. Many other libraries outside of the Association of Research Libraries have also ventured into the world of creating digital collections. The library community's combined efforts are making millions of digital items available to information seekers via the Internet.

This being said, however, the majority of the digital collections that libraries are producing contain materials that are more than 70 years old because copyright laws place strict limits on the reproduction of more recent materials. Libraries that want to offer information seekers access to more current collections of digital materials are turning to commercial services to subscribe to databases that contain hundreds or even thousands of full-text publications. Coverage varies from databases to databases. One database, JSTOR, has coverage of some journals back to the 1840's, but does not offer the most recent issues of its publications. Many other databases, however, cover more recent publications. To have access to a full range of journals means that libraries have to subscribe to multiple databases. Many libraries are finding that this can be quite costly.

One solution has been for libraries to form cooperatives to share virtual commercial database subscriptions. Library cooperatives essentially share virtual collections rendering the distinction among library digital collections almost meaningless. Technology, in this case, has helped bind libraries together in ways never imagined in the past and enabled libraries to give information seekers at even the smallest library access to hundreds of thousands of current, full-text items.

Some university libraries, faced with the high costs of purchasing academic publications, whether online or in print, are going one stop further by becoming full-scale publishers. The University of California, for instance,

has developed an eScholarship Repository to meet their researchers' needs for current academic publications. This electronic repository enables University of California researchers to upload to the Internet their pre-publication or peer-reviewed publications so that other researchers in the University of California System can have quick and full access to the publication. As Kate Wittenberg at Columbia University explains, "Library publishing activities demonstrate a strong interest in providing resources, information, and services that meet the changing needs of users… What is important is that the end product satisfies the user's need to access, in one place, all the important content."19

Libraries, through all these various digital initiatives are making significant progress toward meeting their users' needs. The work to build digital collections and the other examples that I have mentioned are but a few of the many things libraries are doing to realign their traditional services with the realities of new information technologies. There is still much work to be done by all libraries. What will libraries look like in 50 years? It depends on what those of us here do today.

Before I close, I want to take a brief detour into the past because this is the source of my optimism for the present. In 1848, Edward Edwards published an impressive inventory of the collections of the major libraries throughout Europe. His analysis showed that these collections were growing at very rapid rates for that era, The library of the British Museum was going especially fast. This library reported approximately 12,000 new volumes were added in 1845. This figure almost quadruples in 1846, when the library added more than 40,000 new volumes to its collections.

In this context of rapidly growing collections, libraries became the center of several hotly debated issues. How should libraries shelve collections? Should catalogs (really indexes in this period) be printed or kept in handwritten form? What should the library of the modern age look like? The library community was seriously divided on these topics. As one author indicated in his 1843 description of the shelving debate "One [side] has strongly contended that they should be grouped together… according to their subjects… Another maintains, with equal zeal, that they should be placed… alphabetically."20 The debate was also quite headed if Edward Howland's 1871 comments about his opponents are any indication, he wrote

of his opponents that "… those who are most incompetent to judge are generally the most prompt tin expressing opinions, and the opinion is generally pronounced with a positiveness which increases in direct ration to its worthlessness."21

The debates about how libraries should be managed and organized raged on into the early 20th century. In a review of Eugene Morel's two volume analysis of the French national library, the reviewer described Morel as being angry at "… librarians…[for]… spending valuable time and money on trivialities, while neglecting the really unimportant problems before them; that the rate of progress is so slow (?) that accessions are actually coming in faster than the catalogue can incorporate them…"22

At the heart of these debates was a realization that 19th century models of library services were not up to the task f helping information seekers get information in the 20th century. The library model that ultimately emerged from these hotly contested issues was a model that went beyond the imaginings of many people who started the debate. The invention of the card catalog, for example, eliminated the need to debate print versus handwritten indexing. In the end, the new library model that emerged has served the library community well for nearly a century.

One person, one event, one library did not transform the library community of the 19th century. It took many debates and many individual stories of success and failure to give libraries of the 20th century the capacity to help information seekers get information. If we remember that our purpose is to help information seekers get information and that our traditional processes are merely means to this goal, we can open our minds to the possibilities of technology and begin imagining many new says to help the library community on its journey of change in the 21st century.

References:

1. Witten, Ian, "Creating and Customizing Digital Library Collections with the Greenstone Librarian Interface." University of Waikato, New Zealand. Available at http://www.kc.tsuksba.ac.jp/dlkc/e-proceedings/papers/dlkc04pp97.pdf

2. 1993. American Libraries.

3. Library count global

4. The Odum Institute. "Public Opinion Poll Questions Database"

5. International Telecommunication Union. http://www.itu.int/ITU-D/ict/statistics/

6. "Top Search Engines by Search Share, January 2005" U.S., Home and Work. http://www.clickz.com/stats/sectors/search_tools/article.php/3486206

7. Google Inc. Technology Overview. http://www.google.com/press/overview_tech.html

8. Hafner, Katie. "Old Search Engine, the Library, Tries to Fit into a Google World." New York Times. June 21, 2004.

9. PEW/Internet/ "Internet and American Life Project." http://www.pewinternet.org/

10. PEW Internet & American Life Project. 2004.

11. Lyman, Peter and Hal R. Varian, "How Much Information", 2003. Retrieved from http://sims.berkeley.edu/how-much-info-2003 on January 2, 2004.

12. OCLC. "WorldCat facts and statistics" http://www.oclc.org/worldcat/statistics/default.htm; institutions: http://www.oclc.org/about/history/default.htm

13. Kyrillidou, Martha and Mark Young. ARL Library Trends. http://www.arl.org/stats/arstat/03pub/03intro.html

14. Article reference trends

15. Cress, Ann. "The Latest Wave: With Floating Collections Libraries Stretch Materials Budgets, Respond Swiftly to Patrons, and Drive Down Delivery Costs." Library Journal. Oct. 1, 2004. Vol. 129. Issue 16. p. 48.

16 http://mobilelilbrary.cdacnoida.com/index.html

17. http://mobilelilbrary.cdacnoida.com/index.html

18. DeGraf, Brad. Koman, Richard. "Uganda Digital Bookmobile Project: Final Evaluation Report." November 15, 2004. http://www.anywherebooks.org/FinalReport/pdf

19. Wittenberg, Kate. "Librarians as Publishers: a new role in scholarly communication." Searcher. Nov./Dec. 2004. Vol. 12, Issue 10.

20. "Library Catalogue of Brown University." The Christian Review. December 1843. P.500.

21. Howland, Edward. "Public Libraries and Their Management." Lippincott's Magazine of Popular Literature and Science. July 1871. p. 77.

22. Kiedel, George C. "French Libraries.: A Review of Bibliotheques: Essai ssur le development des bibliotheques publiques et de la librarie dans les deux mondes." Modern Language Notes, Vol. 25, No. 5. (May 1910), pp. 154-155.

Jean Arthur Creff
Director of NATO Library Headquater

A brief exercice on MARC 21

For this presentation, I have used a very good document from the Library of Congress: Understanding MARC Bibliographic : Machine-Readable Cataloging, written by Betty Furrie.

This excellent ressource is available on the Library of Congress website at : http://www.loc.gov/marc/umb/

To get more technical informations, one can go to :
http://www.loc.gov/marc/

Let us just look at the example I used during the lecture.
This is the ISBD record, with the accesses:
Eco, Umberto
Omari, Donika. Transl.
Il nome della rosa

Emri i trëndafilit / Umberto Eco ; e përktheu nga origjinali Donika Omari. - Prishtinë : Biblioteka Koha Ditore (Shttypur në Itali), 2005. - 475 p. ; couv. ill, 21 cm. - (Biblioteka Koha Ditore Shekulli XX, 1)

Titulli i origjinalit : Il nome della rosa
ISBN 84-9789-845-1

All the data elements that we have in this record must be used in the MARC record.

Accesses

The primary author access data go to 1XX fields :

100 1# $a Eco, Umberto
The secondary author access to a 7XX field :

700 1# $a Omari, Donika
The tag number varies. For a corporate author, it is either 110 for a primary author or 710 for a secondary one.

After the tag numbers, there may be indicators. For the 100 field, only the first indicator is used : it may have three values :

0 means that it is a forename

1 that it is a surname

3 that it is a family name, for example Borgia

We also have indicators. For the the field 100, they are :

$a Personal name

$b Numeration

$c Titles and other words associated with a name

$q Fuller form of name

$d Dates associated with a name (generally, year of birth)

For the original title, one uses :

240 13 $a Il nome della rosa $l Albanian

The first indicator may have two values :

0 not printed or displayed
1 printed or displayed

The second one deals with nonfiling characters, from 0 to 9, which numbers the nonfiling characters present (initial articles and spaces)

The description

Now we can deal with the description of the book :

The 245 tag is used for the title information (title and responsibility) :

245 10 $a Emri i trëndafilit $c Umberto Eco ; e përktheu nga origjinali Donika Omari.

As you can see, in this case, we use two subfields. The $a is used for the title, whereas the $c is used for the statement of responsibility.

There are other subtitles, like the $b for the subtitle.
There are also indicators. The first one is used for the indexation of the title, whereas the second one deals with the nonfilling characters.

After that, we have to deal with the field of the publisher :

260 ## $a Prishtinë $b Biblioteka Koha Ditore $e Shttypur në Itali $c 2005
And with the collation, that is to say the physical description of the book :

300 ## $a 475 p. $b couv. Ill $c 21 cm.
and finally with the series :

440 #0 $a Biblioteka Koha Ditore Shekulli XX $v 1

If one use this 440 tag, there will be an added entry for the title of the series. If one do not want an entry to be added (because there is already a record for the series in the catalogue), one can use the tag 490.

Then, we just have a note giving the original title :

500 ## Titulli i origjinalit : Il nome della rosa

As a matter of fact, this field is not used for the indexing which is done through the tag 240.

To conclude the description, there is the ISBN :
020 ## $a ISBN 84-9789-845-1

According to the way the library system, the librarien can write the word ISBN or compute his machine so that 020 $a gives ISBN in the display.

The record now looks this way :

020 ## $a ISBN 84-9789-845-1

100 1# $a Eco, Umberto

240 13 $a Il nome della rosa $l Albanian

245 10 $a Emri i trëndafilit $c Umberto Eco ; e përktheu nga origjinali Donika Omari.

260 ## $a Prishtinë $b Biblioteka Koha Ditore $e Shttypur në Itali $c 2005

300 ## $a 475 p. $b couv. Ill $c 21 cm.

440 #0 $a Biblioteka Koha Ditore Shekulli XX $v 1

500 ## Titulli i origjinalit : Il nome della rosa

700 1# $a Omari, Donika

Now, a machine can read and process it.

Of course, there are records far more complex, but the method remains always the same. Whatsoever, it is important and better to have a knowledge of ISBD or AACR before working in MARC, in order to be able to define the data elements.

Taher Khalifa
Zëvendësdrejtor i Bibliotekës së Aleksandrisë

Biblioteka e Aleksandrisë

Biblioteka e lashtë e Aleksandrisë u themelua nga Ptolemeu I (Sutter) në vitin 288 p.e.s. dhe ishte një vend takimesh i mendjeve më të ndritura të kohës. Mblidhte materiale aq me kujdes, saqë mendjet e ndritura të kohës uleshin dhe diskutonin në Tempullin e Muzave dhe në Muze, duke u bërë qendra e parë hulumtuese në botë. Biblioteka zgjeronte aktivitetet e saj për ta përfshirë gjithë dijen e botës antike dhe kishte 700.000 dokumente në papirus. Ajo tërhoqi ithtarë të shkrimeve, intelektualë shkencorë dhe studiues. Të përmendim disa prej tyre:

- Arsiteku (Aristech)-i pari pohonte se toka sillet rreth diellit;
- Hiparku (Hipparchus)-i pari që mati vitet diellore (gjashtë minutë e gjysmë);
- Eratosteni (Eratosthenes)-i pari që mati perimetrin e tokës;
- Euklidi (Euclid)-i shkroi elementet e gjeometrisë;
- Arkimedi (Archimedes)-matematicien i madh i botës së lashtë dhe
- Kalimaku (Callimachues)-poet, i pari që shkroi një katalog librash të klasifikuar sipas lëndës dhe autorit.

Biblioteka e lashtë e Aleksandrisë ishte e hapur për të gjitha qytetërimet. Përpjekje sistematike bëheshin për t'i mbledhur veprat më të mira nga mbarë bota dhe secila nga anijet që kalonte andej, ndalej dhe literatura e saj kopjohej, si për shembull: Dhjata e Vjetër, e cila u përkthye për herë të parë nga hebraishtja në greqishte. Në arritjen e një universaliteti të saj, ishte një përzierje e të gjitha qytetërimeve, që në shekujt e parë të ekzistimit të saj, si dhe ishte një përzierje e të gjitha qytetërimeve dhe e të gjitha gjuhëve. Megjithatë, gjuha greke dominonte. Ndërsa, si rezultat, roli, mendimi dhe filozofia greke mbizotëronin, duke i vënë bazat e qytetërimit helen, për të cilin Aleksandria me bibliotekën e saj të madhe u bë kryeqytet intelektual. Biblioteka e lashtë, siç besojnë shumë njerëz, nuk qe shkatërruar nga pushtimi arab. Ajo kishte filluar të shkatërrohej shumë më herët prej vrimave të shkaktuara nga zjarri dhe prej prishjeve nga periudhat më të gjata kohore. Flakët e para e morën gjatë luftërave të Aleksandrisë, kur Jul Cezari e dogji flotën egjiptiane, në vitin 48 p.e.s. Biblioteka kaloi edhe nëpër kohë të tjera fatale gjatë trazirave të Perandorisë Romake, ku qyteti i Aleksandrisë u pushtua, disa herë, nga shumë ushtri romake, ndërsa tërë rrethi mbretëror, ku ndodhej edhe Biblioteka e vjetër dhe Muzeu, u shkatërrua. Pas djegies së Bibliotekës Mbretërore, në vitin 391 të erës sonë pasoi edhe djegia e bibliotekës publike simotër. Kështu që, epoka e studiuesve të Aleksandrisë mori fund pas 7 shekujsh.

Më lejoni të ndalem edhe pak, për ta lidhur pak rolin e Bibliotekës së Vjetër me atë të Bibliotekës së Re, që njihet me emrin Biblioteka e Aleksandrisë. Kjo Bibliotekë është një përpjekje e madhe egjiptiane, me karakter të gjerë ndërkombëtar. Këtu dua të ndalem dhe të theksoj, se si dy profesorë egjiptianë të Universitetit të Aleksandrisë dhanë idenë e thjeshtë të ringjalljes së një ëndrre të kahershme, që u bë realitet, do të thotë, ringjalljen e Bibliotekës së Aleksandrisë. Kjo ide, menjëherë u përkrah nga zonja Suzzane Mubarak, kryetare e Bordit Ekzekutiv. Ky koncept u përkrah, po ashtu nga UNESCO-ja dhe projekti u vu në një konkurrencë ndërkombëtare, ku u fitua nga Shtëpia e mirënjohur Arkitekturale e Norvegjisë "Sohnetta Group", ose në mënyrën modeste të njohur si "Kapela e borës".

Struktura

Edhe pse ndoshta unë nuk jam personi i duhur që të flasë për arkitekturën e ndërtesës, megjithatë, do të përpiqem t'i prek disa prej karakteristikave të saj kryesore, të një arkitekture të shkëlqyeshme, e cila qëndron pranë vendit të mrekullueshëm të portit të lashtë mbretëror të Aleksandrisë, në lindje të saj, me fytyrë kah deti nga ana veriore, duke lënë Universitetin e Aleksandrisë në anën e saj jugore. Ndërtesa e re dhe e bukur, me mure prej graniti, të mbuluara me shkronja të alfabeteve të botës, njihet sot si gurthemel i Aleksandrisë së Re. Një Bibliotekë me kapacitet prej 4 milionë librash, tre muzeve, pesë instituteve kërkimore, disa galerive të arteve, një sallë me kupola drejt qiellit, në formë planeti dhe qendër e konferencave, që ka 3000 ulëse.

Forma

Ky kompleks i madh ka forma dhe veçori të ndryshme. Forma disku diellor që del nga ujërat e detit, një disk diellor i pakompletuar, që përsëri simbolizon dijen, por që në formën e saj komplete, pasi që, në të vërtetë, dija nuk është komplete, do të thotë, nuk ka fund, duke lënë hapësirë gjithmonë për të mësuar dhe për t'i përparuar njohuritë.

Salla me kupolë, me formën e hënës, qendra e konferencave me format e saj piramidale, uji që sillet përreth tërë kompleksit, duke paraqitur në këtë mënyrë detin e Aleksandrisë, me ngjyrën e tij të gjelbër e të kaltër në të mbylltë, e mos të flasim për kompleksin e madh të mureve të granitit nga Azia, nga Egjipti i Epërm, me shkrimet me alfabete të ndryshme botërore, që, padyshim, është një vend i bukur dhe frymëzues për shumë popuj të botës. Nuk duhet harruar edhe urën që lidh pjesën e sipërme të Aleksandrisë, bibliotekën dhe botën e jashtme përtej detit.

Synimet e Bibliotekës së Re të Aleksandrisë

Ashtu siç ishte edhe Biblioteka e lashtë e Aleksandrisë, një kapitull madhështor në histori, qytet ky me një histori të gjallë, që ka frymëzuar krijuesit e mëdhenj nga Callinachus të Lowrence Durrel, edhe sot, Biblioteka e Re e

Aleksandrisë shndrit në fjalët e zonjës Suzanne Mubarak, kryetare e Bordit Ekzekutiv, si "Dritare e botës në Egjipt".
Kjo bibliotekë është bërë "Dritare e botës në Egjipt", por edhe dritare e Egjiptit në botë, një instrument për arritjen e sfidave digjitale dhe qendër për dialog ndërmjet popujve të botës dhe qytetërimeve. Në të vërtetë, një vazhdimësi e qytetërimeve dhe në asnjë mënyrë konflikti i tyre.
Tamam, ashtu si Biblioteka e lashtë, që ishte bibliotekë e të gjitha qytetërimeve dhe e të gjitha gjuhëve, Biblioteka e Re do të kërkojë të bëhet një qendër ndërkombëtare dhe të shkëlqejë në disa fusha të përzgjedhura, duke u përqendruar në koleksione ose në organizimin e seminareve dhe dialogëve, ndërsa në këtë drejtim i kemi identifikuar katër tema kryesore:

1. Shkencë (me theks të veçantë në etikën e shkencës dhe të teknologjisë);
2. Shkencat humanitare (me theks të veçantë në studimet e reja dhe studimet historike);
3. Art dhe kulturë (me theks të veçantë në dialogun ndërkulturor dhe kritikë);
4. Zhvillim (me theks të veçantë në ujin dhe gjinitë).

Biblioteka e Aleksandrisë beson fuqishëm se përpjekjet e saj do të bëhen në bashkëpunim me shumë institucione të dijes nga bota, ose në mënyrë të vazhdueshme, ose duke organizuar ngjarje të veçanta, si: seminare, konferenca dhe ekspozita. Krahas këtyre lidhje të rëndësishme, do të krijohen edhe lidhje të mëdha ndërmjet shoqërisë egjiptiane dhe botës.
Për ta përfunduar, zonja dhe zotërinj, më lejoni të citoj fjalët e kryetares znj. Suzanne Mubarak, e cila udhëhoqi kauzën e Biblioteca Alexandrina-s dhe projektin për drejtimet e zhvillimit të saj. Ajo thotë: "Ne tani po kalojmë nga faza e ndërtimit të Bibliotekës në veprimtarinë e vërtetë në fushat e dijes, të shkencës, të kulturës dhe të artit. Bashkohuni me ne dhe ndihmona në rrugën tonë, që ta bëjmë Bibliotekën e Re të Aleksandrisë një tempull të shkencës dhe të dijes, qendër të dialogut ndërmjet popujve dhe kombeve, qendër të shkëlqyeshme për hulumtim dhe dokumentim, si dhe burim të krenarisë për Egjiptin dhe botën.

Etleva DOMI
Zëvendësdrejtoreshë e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë

Bibliotekat shqiptare në epokën e informacionit dhe teknologjive të reja

Meqenëse temat kryesore të këtij sesioni janë rreth informatizimit dhe rolit të bibliotekave në epokën e informacionit, ligjërata ime do të fokusohet në sistemin bibliotekar të Republikës së Shqipërisë në përgjithësi, si dhe të Bibliotekës Kombëtare në veçanti, pasi *së pari*, BK ka përparuar shumë në implementimin e teknologjive të reja në shërbimet bibliotekare dhe, *së dyti*, bibliotekat e tjera janë në fillim të këtij procesi.
Gjithnjë më vjen ndërmend shprehja e filozofit grek Demosten, që ”mundësitë e vogla janë shpesh fillimi i nismave të mëdha”. Tani, në shekullin XXI, 2000 vjet më vonë, ne ende shfrytëzojmë këto “mundësi të vogla” për ta ndërtuar ndërmarrjen e madhe të përdorimit të dijes së përbashkët të njerëzimit. E vetmja rrugë është që të përpiqemi për t’i përdorur, gjithnjë e më shumë, teknologjitë e reja, në të gjithë sistemin bibliotekar, në mënyrë që të ndërtojmë fillimisht ndërmarrjen e madhe – që është rrjeti bibliotekar shqiptar dhe, më vonë, themelin e bibliotekës virtuale digjitale. Kjo kërkon mjaft punë.
Ndryshimet ekonomike e politike në Shqipëri, në fillim të viteve’90-të, patën

ndikimin e tyre si në shoqërinë shqiptare, ashtu edhe në sistemin kombëtar bibliotekar. Implementimi i teknologjive të reja në biblioteka, gati 10 vjet më parë, shënoi një revolucion të informacionit me ndikime të ndjeshme në jetën e përditshme. Zhvillimi i Internetit në Shqipëri mundësoi, teknikisht, shpërndarjen e gjerë të informacionit. Në vendin tonë, veçanërisht gjenerata e re, pati e vijon të ketë mjaft interes për Internetin. Shtrirja e Internetit, shpejtësia e zhvillimit teknologjik e informacionit, ka çuar drejt një konceptimi të ri të rolit të bibliotekës bashkëkohore në shoqërinë moderne.

Meqenëse informacioni, sa vjen e bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, roli i bibliotekave shqiptare ka filluar të ndryshojë, nga qendra të shpërndarjes vetëm të materialeve bibliotekare, në qendra të informacionit. Në shekullin XXI teknologjia ka ndryshuar shumë qasjen në informacion: tanimë është plotësisht e mundshme të merret informacion drejtpërsëdrejti nga shtëpia ose nga ku punon. Megjithatë, edhe bibliotekat shqiptare tanimë konsiderohen, gjithnjë e më shumë, si qendra të mëdha informacioni, ku ky i fundit mund të merret nga çdokush. Bibliotekarët bëjnë kujdes në faktin që nuk është e mjaftueshme vetëm që t'i mundësojmë përdoruesve informacion. Por, gjëja më e rëndësishme është krijimi i kushteve, që përdoruesit të jenë të aftë, që të mund ta menaxhojnë sasinë gjigande të informacionit në epokën e re. Bibliotekarët shqiptarë më shumë se kurrë kanë shtyrë përpara shpejtësinë e përhapjes së dijes dhe të qasjes në informacion, duke përdorur, gjithnjë e më shumë teknologjitë e reja. Ata përpiqen që të gjejnë qasje, gjithnjë e më të përshtatshme në burimet e pallogaritshme, të pamatshme, që ato mbajnë në të vërtetë. Bibliotekat shqiptare po përdorin teknologjitë e Internetit që t'i japin shtysë shërbimeve të reja. Po kuptohet, gjithnjë e më shumë, se Interneti demokratizon informacionin, duke u lejuar të gjithë përdoruesve barazi në qasje. Megjithëse, sot, mjaft njerëz kanë mundësi qasjeje në Internet, edhe nga banesa e tyre nëpërmjet një kompanie Interneti në Shqipëri, ata vijnë në bibliotekë që të mësojnë si të gjejnë informacionin në burimet e shumta "Online" (sepse përdoruesit nuk mund të gjejnë këtë lloj ndihme, vetë në Internet). Bibliotekat shqiptare janë të sigurta që biblioteka dhe Interneti kanë nevojë të lidhen nëpërmjet "hyperlinkeve" të tyre që janë e vetmja rrugë, që mund t'i lejojë përdoruesit, që të kalojnë nga ngjarjet, që kanë ndodhur shumë shekuj më parë, në ato të ditëve të sotme. Ata mund të lexojnë artikuj nga revista ose gazeta të botuara në një kontinent tjetër, vetëm pak orë më

parë, dhe janë të vetëdijshëm se informacioni, i cili përshkon këto milje, që të mbërrijë në ekranin e tyre në çdo moment, realizohet vetëm nëpërmjet përdorimit të Internetit. Kjo është, pikërisht, fuqia e teknologjisë. Vitet e fundit, lënda e teknologjisë së informacionit është përfshirë edhe në programet e shkollës së bibliotekonomisë dhe të arsimimit të vijueshëm bibliotekar. Mentaliteti i bibliotekarëve ka ndryshuar. Ato e kanë kuptuar që në shoqërinë e informacionit, roli i tyre është të sigurojnë burime dhe të garantojnë qasje të barabartë në informacion, për të gjithë përdoruesit dhe në bazë të nevojave të tyre. "Qasja e lirë në informacion" garantohet nga "Ligji për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë", miratuar në vitin 2000. Meqenëse, aktualisht njerëzit për informacion i drejtohen, gjithnjë e më shumë, qendrave të Internetit, më shumë sesa bibliotekave, bibliotekarët po përpiqen që t'iu tregojnë përdoruesve të tyre, që ato nuk kanë lidhje vetëm me librat, por edhe me dhënien e informacionit.

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, si qendra e vetme profesionale në vend, që udhëheq gjithë sistemin bibliotekar kombëtar, ka përparuar mjaft në implementimin e teknologjive të reja në shërbimet bibliotekare. Ndërkohë, që bibliotekat e tjera janë në fillim të këtij procesi. Roli i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë në epokën e re është të vijojë traditën e madhe të bibliotekonomisë - barazinë e qasjes në informacion për të gjithë; ruajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare; përhapjen e burimeve të informacionit - me dinamizmin e ndryshimeve të vijueshme teknologjike të mjedisit të rrjetit botëror. BK është aktualisht qendër për zhvillimet e reja teknologjike për të gjitha bibliotekat e vendit. Duke vlerësuar ndryshimet e teknologjive të reja dhe rolin e tyre në jetën tonë të përditshme, ajo ndihmon të gjitha bibliotekat e tjera.

Biblioteka Kombëtare

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë është një nga institucionet pioniere të Shqipërisë që zbatoi teknologjitë e reja në vendin tonë. Në vitin 1990 filloi interesimi për kompjuterizimin e BK-së. Është për t'u nënvizuar fakti, që fillimet e përdorimit të Internetit dhe ndërtimit të rrjeteve në Shqipëri, fillojnë që prej vitit 1998. Kompjuterët e parë që u instaluan në BK në vitin 1990, ndonëse me të dhëna mjaft të thjeshta, shërbyen për krijimin e bazës së të

dhënave, fillimisht në dBase IV dhe më vonë në CD/ISIS. Në vitin 1994 në BK u instalua programi CDS/ISIS, siguruar falas nga UNESCO dhe filloi katalogimi në një sistem të automatizuar të hyrjeve të reja (libra). Ky vit shënon fillimet e krijimit të skedarit elektronik. Në vitin 1998 u krijua rrjeti i BK dhe CDS/ISIS u instalua në rrjet. Që prej 1999 përdoret sistemi i integruar bibliotekar ADLiB (Windows NT). (Aktualisht ka 32 përdorues të lidhur ne rrjet). Kompjuterizimi i bibliotekës kërkoi edhe riorganizim të disa proceseve të punës, madje edhe të vetë strukturës së bibliotekës. Përderisa biblioteka ishte e aftë të kryente funksione të reja dhe të siguronte shërbime të reja (OPAC-un, qasjen në Internet), disa procese pune manuale u eliminuan (regjistrimi i përdoruesve, përgatitja me dorë e skedave për përgatitjen e bibliografive kombëtare vijuese a retrospektive etj.). Fillimisht, u zbatua moduli i katalogimit. Aktualisht, duke synuar përshpejtimin e automatizimit të bibliotekës, pas trajnimit të stafit, ka filluar gjithashtu edhe përdorimi i modulit të pasurimit dhe ai i serialeve (periodikut). Vijon puna për modulin e qarkullimit. Aktualisht, BKSH-ja ka të lidhur në rrjet 48 kompjuterë, ndërkohë që rrjeti është i shtrirë për 65 përdorues.

Katalogu i automatizuar shfrytëzohet vetëm brenda mjediseve të BK-së. Përdoruesi ka vetëm 5 kompjuterë, nga ku mund të kryejë kërkime për bazën e të dhënave në BK. Aktualisht, meqenëse qasja në katalogun elektronik është e kufizuar, kataloguesit ende vijojnë integrimin e skedave në skedarët tradicionalë. Ndonëse është përgatitur, ende nuk është mundësuar krijimi Website-it të BK-së, nga ku baza e të dhënave mund të ishte e shfrytëzueshme nëpërmjet Internetit edhe jashtë ndërtesës.

Baza e të dhënave përfshin të gjitha hyrjet e reja, që prej vitit 1995 (192.096 regjistrime); numërohen 27.181 regjistrime për librin, 164.442 regjistrime për artikujt e periodikut shqiptar dhe 473 disertacione. Përdoruesi mund të kërkojë në të nëpërmjet OPAC-ut. Ai mund të marrë informacion, duke kërkuar nëpërmjet autorit, titullit, lëndës, botuesit, vitit të botimit, emrave gjeografikë, emrave të personave etj. Operatorët boleanë, tronkimet janë gjithashtu të mundshme. Përdoruesi mund të gjejë të dhëna bibliografike dhe artikuj për shkencat shoqërore edhe nëpërmjet CD-ROM-eve; ai mund të marrë informacion jo vetëm nga baza e të dhënave të BK-së, por edhe nëpërmjet bazave të ndryshme të të dhënave të ofruara nga Interneti.

Interneti ofrohet vetëm në 4 poste për përdoruesit. Ai ka filluar të përdoret

gjerësisht për zhvillimin e fondeve dhe huazimin bibliotekar ndërkombëtar. Tanimë ka ndryshuar krejt procesi i pasurimit në rrugën tradicionale. Dikur, informacioni vilej nga katalogë të ndryshëm si: “Books in print“, “Livres disponibles“, revista, gazeta, bibliografi etj.; pas përzgjedhjes së materialeve bibliotekare kryhej porosia. Tani, gjithçka funksionon ndryshe. Porosia kryhet drejtpëdrejt nëpërmjet Internetit, çka ndikon në pasurimin e vijueshëm e të shpejtë të koleksioneve të bibliotekës. Interneti ka krijuar lehtësi të madhe pasi huazimi i materialeve bibliotekare realizohet drejtpërdrejt nëpërmjet tij, duke iu nënshtruar të gjitha rregullave ndërkombëtare të huazimit ndërbibliotekar.

Konvertimi retrospektiv ka filluar në vitin 2002 me botimet e karakterit Albano-Ballkanologjik, që kanë hyrë në BK, pas vitit 1989. Deri tani janë hedhur 10.000 regjistrime. Meqenëse, pjesa më e madhe e skedave të skedarit tradicional janë të shkruara me dorë dhe një pjesë e vogël janë të shtypura, si edhe me futjen e klasifikimit lëndor, pas vitit 1998, rruga e vetme për ta realizuar konvertimin retrospektiv ishte rishtypja e tyre.

Bibliotekat publike

Edhe shërbimi në bibliotekat publike ka filluar të informatizohet. Një pjesë e tyre janë pajisur me kompjuterë dhe përdorin variantin e fundit të CDS/ISIS. Ato kanë filluar t’i hedhin hapat e para në përdorimin e Internetit dhe në krijimin e bazës së të dhënave - 7 nga 34 i kanë këto mundësi. Niveli i pamjaftueshëm i implementimit të teknologjive të reja përcaktohet nga faktorë të jashtëm si: kufizimi i fondeve për pajisje kompjuterike dhe për ta paguar Internetin, domosdoshmëria e zgjerimit të rrjetit për të siguruar poste pune për përdoruesit, moszhvillimi i infrastrukturës së telekomunikacionit etj. Veç funksioneve të traditës, bibliotekat publike kanë filluar të luajnë role të reja dhe të ofrojnë shërbime informimi për të gjithë komunitetin. Ato po luajnë rol të madh në menaxhimin e fluksit të informacionit. Nëpërmjet përdorimit të teknologjive të përparuara të informacionit dhe të komunikimit, ato synojnë ofrimin e shërbimeve, sa më efektive për përdoruesin dhe synojnë të luajnë rolin e ndërmjetësit midis tyre dhe burimeve të informacionit. Bibliotekat publike, që nuk kanë Internet, e si rrjedhojë, që nuk kanë as qasje në burimet elektronike, informacionin e marrin nëpërmjet CD-ROM/ DVD-ve.

Bibliotekat universitare

Bibliotekat universitare janë në kushte më të mira. Të përfshira në projekte evropiane, ato kanë pasur mundësi pajisjesh, si me kompjuterë, ashtu edhe "softe" bibliotekare, çfarë ka mundësuar aftësimin e tyre, si në përdorimin e pajisjeve, ashtu edhe të informacionit ose të burimeve të ndryshme. Bibliotekat i kanë përmirësuar shërbimet e tyre, si për studentët, ashtu edhe për stafin e tyre akademik. Shumica e bibliotekave universitare (15 nga 24) janë të automatizuara dhe ofrojnë Internet për përdoruesit e tyre. Disa prej tyre përdorin CDI/ISIS-in e disa AVECT-in. Ato kanë filluar të krijojnë bazën e tyre të të dhënave. Ndonëse, ende nuk ekziston një rrjet ndërmjet bibliotekave universitare, aktualisht po punohet për ngritjen e tij. Shërbimet, përfshirë edhe Internetin, janë pa pagesë.

Bibliotekat e veçanta

Zhvillimi i teknologjisë së informacionit ka krijuar, tanimë, një mjedis që parashtron si sfida të panjohura më parë, ashtu edhe shanse, edhe për bibliotekat e veçanta. Ka filluar informatizimi i tyre. Ato ofrojnë shërbim të specializuar për specialistët. Duke kuptuar rolin e tyre në epokën e re, ato po kuptojnë, gjithnjë e më shumë, rëndësinë e bashkëpunimit e të këmbimit të informacionit ndërmjet tyre. Bibliotekat e Akademisë së Shkencave po punojë për ngritjen e rrjetit të bibliotekave të institucioneve shkencore. Ato kanë filluar edhe konvertimin retrospektiv dhe 10 nga 32 kanë krijuar bazën e të dhënave, kurse vetëm 2 ofrojnë Internet.

Roli i bibliotekave në të ardhmen

Në epokën e kibernetikës, bibliotekarët, si pjesëtarë në lëvizjen drejt një infrastrukture të informacionit elektronik, duhet të udhëhiqen kurdoherë nga thënia e Umberto Eco-s "Biblioteka mund të ndryshojë zotin" dhe e Jorge Luis Borges "Dy sekretet e mëdha të qytetërimit janë: burimi i bibliotekës dhe i kohës".
Duke qenë një situatë e tillë, kur bibliotekat kryesore po bëjnë përpjekjet për të informatizuar shërbimet e përdoruesve dhe për t'i krijuar katalogët e tyre

elektronikë, objektivat kryesore në një të ardhme, jo të largët, duhet të jenë: krijimi i rrjetit kombëtar i bibliotekave dhe trajnimi i vijueshëm i stafit të bibliotekave.
Vetëm nëpërmjet ngritjes së sistemeve të përbashkëta, të marrjes së informacionit nëpërmjet Internetit dhe strukturës kombëtare të informacionit, elementët e nevojshëm (themelorë) të një "library without walls" (biblioteka pa mure) do të mund tanimë të vendosen.
Shoqëria e lirë dhe demokratike ka lindur në kulturën librore dhe pa të kultura kurrë nuk mund mbijetojë. Nëse bibliotekarët shndërrohen nga shpërndarës të informacionit në menaxhues të dijes, dija kurrë nuk do të mund të zëvendësohet nga fluksi i informacionit. Prandaj, është mjaft i rëndësishëm integrimi i një bote të re i dijes elektronike në kulturën librore tradicionale.



Prof. dr. Jahja DRANÇOLLI
Fakulteti Filozofik

Kosovari Martin Segoni - biograf i parë i Skënderbeut

Kur mbahet në mend fakti se, sot, veprojnë më shumë studiues sesa në të gjitha kohët e shkuara, përgjithësisht, dhe mund të udhëtohet shumë më shpejt për të fituar pasqyrë më të qartë për përmbajtjet e thesareve arkivore e bibliotekare, prapëseprapë, zbulimi i burimeve të reja në ditët e sotme është gjë e rrallë. Një zbulim më rëndësi, që hedh dritë edhe për jetën dhe bëmat e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, për të cilin është folur më se një herë, paraqet vepra monumentale e bizantologut italian *Agostino Pertusi*. Ky studiues në Ambrozianë të Milanos i zbuloi dorëshkrimet e *Martin Segonit*, një autor i shekullit XV, i cili mbante titullin e Ipeshkëvit të Ulqinit dhe kishte origjinë nga Novobërda (Artana) e Kosovës[1]. Njoftimet e para për Martin Segonin ndërlidhen me rekonstruimin e teksteve të tij, tradita e të cilave është tejet e komplikuar, që për ekspertët medievistë do të ishte fushë interesante studimi edhe sot e gjithë ditën[2].

Sikur theksonte edhe vetë zbuluesi i dorëshkrimeve, A. Pertusi, humanisti ynë, Martin Segoni qe i humbur e i harruar, por jo edhe shkrimtar i panjohur. E citonin në veprat e tyre historianët dhe shkrimtarët më të mëdhenj humanistë, si: *M. A. Sabeliko, M. Beçikemi, P. Jovius, M. Orbini* etj. Vepra jokomplete e Segonit, pjesërisht është e ruajtur në latinishten origjinale, diçka i përkthyer në italishte, i ruajtur vetëm nga historiani italian S. Razzi në Kotorr më 1589. Disa vepra të tij na kanë mbetur të njohura vetëm sipas titujve. Nga dorëshkrimet e ruajtura dihet fare pak për jetën e Martin Segonit. Tërthorazi nga disa dokumente raguzane dhe venedikase, mësohet se Segoni ishte nga Novobërda dhe ishte ipeshkëv i Ulqinit. Mirëpo, në ballina të teksteve origjinale latine, për të thuhet: *natione Catharensis* (kombësia kotorrase) *ex Novomontio aliter Novabardo* (Novobërda, vendlindja e tij). Në parathënien e S. Razzi-t, për Segonin, ndërkaq shkruante vetëm *gentilhuomo di Cataro* (bujar i Kotorrit). Është interesante të theksojmë këtu, se lidhjet e Skënderbeut me Novobërdën mund të ndiqen sipas dokumenteve të shumta. Mirëpo, një njoftim provon se Papa Kaliksti III, në vitin 1457, argjipeshkëvit të Tivarit për t'u bërë shok i Skënderbeut në kryqëzatë (i cili në këtë kohë planifikonte të kalonte në Zetë), në pranverë të vitit 1457, i ofronte kishën katedrale të Shën Nikollës në Novobërdë. Këtej, Novobërda edhe pse në atë kohë ishte nën juridiksionin e Ipeshkëvisë së Kotorrit, shpallet si dioqezë e Argjipeshkvisë së Tivarit - *"in ecclesia sancti Nicolai de Novomonte Antibarensis diocesis"*.

Ajo që tërheq më tepër vëmendjen këtu, është se njoftimet nga dorëshkrimet zbulojnë vetëm fillimin dhe fundin e rrugëtimit të jetës së Segonit. Fillimi ndërlidhet me Novobërdën, ku lindi në shtëpinë e t'et, Gjon Segonit, dhe fundi me Ulqinin, këtu, gjatë viteve 1482-1485 (para muajit tetor), në të vërtetë, edhe pse për një kohë të shkurtër, rezidoi në Ipeshkëvinë e Ulqinit. Duke bërë hulumtime arkivore në arkiva të Padovës, për shqiptarët, në Universitetin e Padovës, ne kemi pasur rast, që të ndeshim në njoftime që shpiejnë në veprimtarinë e Segonit gjatë viteve 1474-1475 në Padovë. Në universitetin e kësaj qendreje të madhe të kohës, kishte mbaruar studimet, ndërsa në shkurt të vitit 1475 kishte mbrojtur doktoratën nga e drejta kanonike. Që në atë kohë mbante lidhje me vendlindjen - Novobërdën. Këtu, gjatë këtyre viteve, e ndeshim, në cilësi të kanonikut të kishës *Shën Mëri* apo *kishës sase* (*Santa Maria in Nouamonte*). Më pak të njohura i kemi lidhjet e Martin Segonit me Kotorrin. Një familje nga Segonët, e ndeshim në Kotorr në gjysmën e parë të shekullit XVI. Ka të ngjarë se këtu kishin ardhur pas pushtimit të Novobërdës nga osmanët më 1455. Aq më tepër, kjo dëshmi provohet nga kërkimet tona në arkiva të Kotorrit, ku nuk kemi ndeshur në

asnjë njoftim për ekzistimin e familjes Segoni në Kotorr para shekullit XVI. Mbiemri karakteristik, si dhe besimi katolik i Martin Segonit, janë prova të sigurta për origjinën arbërore dhe lidhjet e tij me arbërit e Novobërdës, gjatë shekujve XIV-XV. Kur është fjala për përcaktimin e përkatësisë etnike të tij, çdo herë, duhet mbajtur në mend edhe faktin se Martin Segoni pjesën më të madhe të teksteve të tij ia kishte kushtuar historisë arbërore dhe shkroi biografinë e parë kushtuar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Ajo që tërheq më tepër vëmendjen këtu, është se origjina arbërore e Martin Segonit nuk është mohuar as nga historianët medievistë të Akademisë së Shkencave të Beogradit.

Në origjinalin latinisht, janë ruajtur këto shkrime të Segonit: *Traktati mbi mbrojtjen e Otrantit dhe rregullimi ushtarak i Turkut dhe origjina e tij* (këtu Segoni bën fjalë edhe për rrugët e Ballkanit, si: rruga që shpie për në Kosovë, të cilën humanisti e quan Dardani; rruga Egnatia, që nga Durrësi dhe Apollonia shpie për në Lindje; përshkruan, gjithashtu edhe trevat e Arbërisë Veriore dhe Jugore); më pastaj, shkrimet historiko gjeografike *mbi rrugët nga të cilat duhet sulmuar turqit* (nga viti 1522 u ribotua disa herë, por në emër të austriakut Feliks Petançi); *mbi tokat dhe regjionet nëpër të cilat turqit mund të sulmojnë* dhe *mbi trevat e Dalmacisë prej të cilave barbarët ndërmarrin sulme në vende gjermane*. Që të dy këto tekste janë ruajtur në fondin e Razzi-t, të përkthyera italisht. Po në këtë gjuhë është ruajtur edhe biografia e shkurtër kushtuar Fatosit tonë me titull: *Narrazzioni di Giorgio Castriotto, da i Turchi nella lingua loro chiamato Scander beg, cioe Alesandro Magno* (*Tregim mbi Gjergj Kastriotin, nga turqit, në gjuhën e tyre, i quajtur Skander Beg, domethënë Aleksandër i Madh*). Përveç këtij "Tregimi" të shkurtër kushtuar Fatosit tonë, Martin Segoni ka lënë edhe shkrime të tjera, në të cilat ndeshim fragmente mbi Skënderbeun e familjen e tij, mbi Arbërinë e kohës së tij, si dhe skica jetëshkrimore për historinë e heroit të kohës së tij.

Novobërda, vendlindja, ku u krijua Segoni, në shekullin XV zotëronte një ambient me kulturë të moçme qytetare. Nga ky qytet dolën autorë, si: Dhimitër Kantakuzeni, Kostadin Filozofi, Vladisav Gramatiku, të cilët dinin të lexonin në origjinal autorët grekë e latinë, "madje dinin të shkruanin në latinishte të bukur librushkat e tyre". Këtu jetoi dhe veproi, një kohë, shkrimtari dhe historiani i madh bizantin Jan Kantakuzeni. Segoni mori këtu dituri humaniste. Interesimin për historinë dhe gjeografinë e vendeve ballkanike,

humanisti kosovar e barti me vete në Itali, ku padyshim, do ta ngritë edhe nivelin e diturive të gjuhës latine dhe të shkencave klasike, të cilat u shprehën fuqimisht në traktatet e tij të njohura.

Lexuesit të sotëm, padyshim, më tepër do t'i kishin interesuar shkrimet e Martin Segonit kushtuar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Segoni kishte prirje, që në një vend në shkrime të tij, ndonjë çështje, së pari, të trajtonte ca më shkurtër, dhe më pastaj, në një vend tjetër, të trajtonte ca më gjërësisht po atë çështje. Kështu, në shkrimin *Mbi origjinën e turqve*, ai i qaset shkurtazi Skënderbeut, dhe më pastaj, Fatosit tonë ia kushton një tekst ca më të gjatë. Duke u nisur nga kjo logjikë, "Tregimi" kushuar Skënderbeut është shkruar diku gjatë viteve 1481-1485, meqë deri në vitet 1481/82, Segoni i kishte shkruar të gjitha veprat, ku përmendet më parë Skënderbeu. "Tregimi" i Segonit kushtuar Skënderbeut, i cili ruhet sot në Bibliotekën Kombëtare në Firencë, kishte parë dritën fill pas rënies së Krujës dhe Shkodrës (1478/79) dhe pas disfatës turke në Otranto (1481), pra diçka më shumë se dhjetë vjet pas vdekjes së heroit. Atëbotë, humanisti ynë rezidonte në Ipeshkvinë e Ulqinit, qytet ky ende i pashkelur nga turqit, si dhe seli pranë "teatrit të operacioneve" më të bujshme të Skënderbeut.

Nga gjithë ajo që u tha më sipër, del se Martin Segoni paskësh shkruar "Tregimin" për Skënderbeut pothuaj një çerek shekulli para veprës monumentale kushtuar Fatosit tonë nga Marin Barleci. Çështje kjo, e cila nga studiuesit nuk është kontestuar deri në ditët e sotme. Mirëpo, duhet potencuar se teksti, për të cilin po bëjmë fjalë, është shumë më i shkurtër sesa teksti i Barlecit. Në këtë kontekst, e quaj me vend, të shtrohet pyetja se sa ka pasur njohuri Barleci për shkrimet e Segonit. Derisa janë të njohura lidhjet e Marin Beçikemit me Segonin, lidhjet e tilla nuk janë të njohura ndërmjet Segonit dhe Barlecit. Humanisti shkodran, pavarësisht se i ka njohur apo jo shkrimet e Segonit, nuk e përmend atë në asnjë vepër të tij. Por, në kohën kur shkroi Barleci, jeta dhe bëmat e Skënderbeut, në mesin e arbërve, por edhe te të huajt ishin të njohura. Edhe pse nuk dihet aq sa ishte ndikuar Barleci nga "Tregimi" i Segonit, një çështje është e sigurt, se edhe Segoni edhe Barleci shkruan histori të vertetë, histori që përjetësoi, jo vetëm jetën e bëmat e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, por nëpërmjet tij u përjetësua edhe Shqipëria.

Pjesë të zgjedhura nga *Narrazione di Giorgio Castriotto, dai Turchi nella lingua loro chiamato Scander Beg, cioe Alessandro Magno* (*Tregim mbi Gjergj*

Kastriotin, nga Turqit, në gjuhën e tyre i quajtur Skanderb Beg, domethënë Aleksandër i Madh): “Lindi Gjergj Kastrioti nga Gjoni, zot i Arbërisë [...]. I cili zot, Gjoni, duke mos mundur t’u qëndronte armëve turke, pati paqen nga Murati me disa kushte, njëra prej të cilave ishte që ai t’i jepte djemtë e tij peng, e në mes tyre Skënderbeun. I cili, i rritur në oborrin e turkut dhe i mësuar në kulturën turke, pati kaq përfitim sa, që nëntëmbdhjetë vjeç (Barleci e jep 18 vjeç, ndërkaq Frëngu 19 vjeç), qe bërë sanxhak [...]. Dhe duke pasur një pamje mbretërore, u simpatizua shumë nga Murati [...]. Kështu, Murati thoshte plotë gojën, publikisht, se ai ishte krahu i tij, syri i tij i djathtë dhe mbrojtësi i pashoq i shtetit të tij”. “I erdhi, ndërkaq të atit, Gjonit, për të vdekur, ushtritë turke pushtuan atë mbretëri, gjë për të cilën Skënderbeu u qa (por) qe ngushtuar nga Murati, duke i dhënë shpresë se së shpejti do ta vendosë në fron personin e tij. Po, duke mos bërë gjë më tej, bile duke bërë (Murati) që të vëllëzërit e tij të vdisnin me helm, ai (Skënderbeu), me shkathtësi dhe me shkresa të falsifikuara vajti në Arbëri. E bë zot i disa fortesave kryesore. Dhe pastaj, pasi u mblodhën në kuvend popujt e provincës në fjalë e të gjithë Maqedonisë (trojet këndej e andej Drinit), qe njohur prej tyre princ i ligjshëm e thirrur mbret [...]” (me sa duket Segoni qe i pari prej historianëve që pohon se, Skënderbeu mbante titullin mbret. Deri vonë, për titullin mbret të Skënderbeut i referoheshin *Lavardenit*, 1576).

“Mbasi Mehmeti zhduku perandorinë e Trebizontit dhe atë të Kostadinopojës, provoi të zhdukte Krujën, po, duke u mbrojtur, Gjergj Skënderbeu arriti ta bënte të kotë çdo përpjekje të tij”.

“Më vonë, qe thirrur nga Piu II në Itali, për ta bërë të përgjithshëm në ndërmarrjen që shenjtëria e tij mendonte kundër turqve. Po duke ndërhyrë vdekja e Pontefecit në fjalë, tjetërkush nuk vazhdoi”.

“Ndërkaq, duke u kthyer në Arbëri, dhe ndërsa në Lezhë, mbi lumin Drin, po konsultohej me proveditorin venedikas rreth çështjeve të luftës, e rroku një ethe ngjitëse (dhe) kaloi në jetën më të mirë, në vitin e Zotit tonë një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë, në moshën gjashtëdhjetë e tre [...]”. (Segoni e jep saktë datën: sipas kalendarit venedikas i bie viti 1468; kështu bën edhe Frëngu; Barleci dhe Muzaka, ndërkaq, jepin vitin 1466, d.m.th. 1467).

“Qe qarë vdekja e këtij kalorësi të madh jo vetëm nga tërë Greqia, po njëkohësisht nga tërë princërit e Evropës, si dhe nga turqit vetë, të cilët, pas vdekjes së tij, duke u bërë zotër të gjithë Arbërisë dhe duke gjetur në kishën e Shënkollit, katedrale e qytetit të Lezhës, trupin e tij, devotshmërisht e nderuan me respekt të madh. Dhe, sipas supersticionit të tyre, nxorën eshtrat fatlume nga varri, duke besuar secili se do të gjendej i sigurt në betejë, po të kishte lidhur me vete një pjesë, sado të vogël, është të një kapiteni kaq të pathyeshëm”.

---

1. *Agostino Pertusi, Martino Segono di Novo brdo vescovo di Dulcigno, Istituto Storico Italiano per il Medio Evo, Studi storici-fasc. 128-130, Roma 1981, pp. 372.*

2. *Opusculum reverendi domini, Domini Martini Segonis natione Catharensis origine autem serviani ex Novomontio aliter Novobardo dicto Dei gratia episcopi Olchinensis, Ad Beatissimum Sixtum IV Romanum Pontificem. Brenda këtij dorëshkrimi nën shifrën VIII. ruhet teksti i shkurtër kushtuar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, i cili sot ruhet në Bibliotekën Kombëtare në Firence: Narazione di Giorgio Castriotto, da i Turchi nella lingua loro chimato Scander beg, cioè Alessando Magno (?), shiko, Flor. Bibl. Nat. Conv.Soppr. G 7 1003, a. 1598, ff. 32r-33v.*

Prof. dr. Ymer JAKA
Instituti Albanologjik i Prishtinës

Çështje të trajtimit të epokës së Skënderbeut në letërsitë evropiane

Viti, tashmë i largët, 1968, kur u shënua 500-vjetori i vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, kaloi i tëri me shenjën e këtij përvjetori, me manifestime të shumta, ndër të cilat janë edhe konferencat shkencore ndërkombëtare në Tiranë, në Prishtinë e në Palermo, kushtuar këtij përvjetori, punimet e të cilave panë dritën në shumë vëllime, madje, ato të Konferencës së Dytë të Studimeve Albanologjike të Tiranës, të përkthyera edhe në një gjuhë të huaj, në frëngjishte. Ishte ky rast, që të thelloheshin studimet për këtë epokë të shkëlqyeshme të historisë sonë, kur shqiptarët, të udhëhequr nga Skënderbeu, u bënë aktorë të historisë së përbotshme, meqë ata jo vetëm se gjatë një çerek shekulli i zmbrapsën sulmet e pareshtura të fuqisë më të madhe ushtarake dhe politike të asaj kohe dhe e mbrojtën lirinë dhe pavarësinë e tyre, por u bënë edhe ledh i pakapërcyeshëm i depërtimit osman drejt Evropës. Pra, edhe mburojë e qytetërimit evropian. Madje, në një kohë, kur në krye të Perandorisë Osmane ishin dy ndër sulltanët e saj më të mëdhenj, Murati II dhe Mehmeti II, atëherë kur as bedenet e Kostandinopojës nuk ia dolën t'u bënin ballë sulmeve të ushtrive osmane, kur Perandoria Bizantine u zhduk nga faqja e dheut.

Këto fakte e shpjegojnë jehonën e fuqishme, që bëri kjo epokë e historisë sonë në historiografitë dhe në letërsitë evropiane, që nga shekulli XVI deri në ditët tona. Numri i rreth 1 000 veprave të regjistruara për bibliografinë e Skënderbeut, të shkruara dhe të botuara në më shumë se 20 gjuhë, është dëshmia më e gjallë e kësaj jehone.

Përvjetori i vdekjes së Skënderbeut u dha një shtysë studimeve të epokës së heroit tonë kombëtar dhe të personalitetit të tij, jo vetëm nga studiuesit shqiptarë, por edhe nga ata të huaj.

Ndërkaq, derisa në disa fusha, në atë të historiografisë, posaçërisht, edhe para këtij përvjetori kishin parë dritën shumë studime dhe ishin trajtuar shumë aspekte të kësaj epoke të historisë sonë, në fushën e studimit të jehonës së saj, në letërsitë evropiane, nuk kishte vajtur shumë larg.

Ndonëse, që para më shumë se një shekulli, Faik Konica, në revistën e tij *Albania*, shkruante se Skënderbeu ynë e kishte frymëzuar njërin ndër lirikët më të mëdhenj të letërsisë franceze, Pjer dë Ronsarin[1], si edhe një bashkëkohës të këtij poeti, njërin ndër prozatorët më të shquar francezë, Mishel dë Montenjin[2], para vitit 1968, sa na është e njohur, vetëm dy vështrime panë dritën për trajtimin e Skënderbeut, në letërsinë botërore. Ai i B.B.Ashkëmit, me titullin *Shënime për trajtimin e temës së Skënderbeut*[3] dhe punimi i Aleks Budës *Gjergj Kastrioti në letërsinë botërore*[4].

Kjo gjendje, i dha dorë Androkli Kostallarit, që në studimin e tij *Skënderbeu në letërsinë botërore*, të paraqitur në Konferencën e Dytë të Studimeve Albanologjike në Tiranë, në vitin 1968, të shkruante:

«Studimet rreth problemit të pasqyrimit të Skënderbeut dhe të epokës së tij në letërsinë botërore, të cilat kanë filluar që në shekullin e kaluar, ndodhen akoma në hapat e para. Një pjesë e madhe e veprave që njihen nuk janë bërë ende objekt analizash të thelluara, as të vështruara në vetvete, as në plan të krahasuar, ndërsa punimet përgjithësuese, sintetizuese, mungojnë fare. [...] Kështu mund të themi pa e tepëruar se sot në fushën e studimeve skënderbejane problemi "Gjergj Kastrioti dhe letërsia botërore" është një nga më të rëndësishmit

[1] Shih *Një vjershë e Ronsard-it permi shqiptarët, Albania*, 1, 1900, f. 44-46.
[2] Shih *Albania*, 6, 1898, f. 79.
[3] B. B. Ashcom, *Notes on the development of the Scanderbeg theme, Comparative Literature*, V, 1953, Eugene, Oregon, U.S.A., f. 16-29.
[4] Aleks Buda, *Gjergj Kastrioti në letërsinë botërore, Drita,* 15.I.1961.

e më aktualët»[5].

Dihet se historia, që nga kohët më të lashta, i ka shërbyer si mbështetje letërsisë. Si ilustrim të këtij pohimi po e përmendim *Iliadën* e Homerit, si edhe disa nga veprat e Shekspirit. Edhe sot e kësaj dite nuk është i vogël numri i shkrimtarëve të cilët mbështeten në histori për lëndën e veprave të tyre. Kuptohet, historia atyre u shërben si pikënisje për përsiatje të ndryshme mbi njeriun dhe botën. Madje, shpesh nga e kaluara nxirren mësime për të sotmen dhe të ardhmen. Dihet se shkrimtari nuk është historian, ai nuk është rob i fakteve, të kaluarën shpesh e ka si pikënisje për t'i dhënë krahë imagjinatës së tij. Nuk janë të pakta veprat letrare me tematikë historike, të cilat e ringjallin një epokë me një spektër të gjerë ngjyrash flakëruese, që na e bëjnë më të afërt dhe më joshëse atë botë, sesa faktet e thata të dokumenteve të arkivave, të cilat i gjejmë në studimet historike. Historiani është i detyruar t'u përmbahet të dhënave që ka në dorë lidhur me epokën për të cilën shkruan, ndërsa shkrimtari atë epokë e trajton nga pikëvështrime të tij subjektive, duke i hapur shtigje imagjinatës së tij dhe duke shpaluar shtresa, gjurmët e të cilave shpesh janë tretur në humbësirat e kohës.

Për këtë arsye, shumë personalitete të shquara historike, ndër të cilat po i përmendim Aleksandrin e Madh, Zhanë d'Arkun e Napoleon Bonapartën, i njohim më mirë nga një varg i gjatë veprash letrare ose prodhimesh kinematografike, kryeprotagonistë të të cilave janë ata, sesa nëpërmjet veprash historike. Edhe Skënderbeu ynë, me numrin e madh të veprave historike dhe letrare kryeprotagonist i të cilave u bë, dëshmon se hyn në radhën e personaliteteve të shquara botërore. Mirëpo, deri më sot, pasqyrimin e personalitetit dhe të epokës së tij e njohim kryesisht nga studimet historike. Pra, nëpërmjet krijimtarisë diskursive, e shumë më pak nëpërmjet asaj imagjinative, pra nëpërmjet veprave letrare dhe artistike, frymëzim i të cilave ai u bë, sidomos i veprave të shkruara dhe të botuara në një varg gjuhësh të huaja.

Arsyetimin e mundshëm, se nuk kemi pasur njohuri për veprat e autorëve të huaj, në kumtesën tonë po kufizohemi në letërsitë evropiane, meqë jashtë Evropës të rrallë janë autorët e veprave letrare të frymëzuara nga Skënderbeu, e hedhin poshtë disa bibliografi në të cilat është regjistruar një numër i këtyre

[5] Androkli Kostallari, *Figura e Skënderbeut në letërsinë botërore, Konferenca e dytë e studimeve albanologjike*, Tiranë, 1969, vëll. I, f. 371-394. - Teksti i cituar gjendet në f. 371-372.

veprave, çfarë është bibliografia e veprave kushtuar ekskluzivisht Gjergj Kastriotit, e botuar në Paris në vitin 1881[6], si edhe bibliografitë për Shqipërinë dhe shqiptarët, të botuara në vitin 1912[7] dhe në vitin 1934[8], dy vëllimet e bibliografisë *Albanica I* [9] dhe *Albanica II* [10] dhe në fund bibliografia *Gjergj Kastrioti Skënderbeu,* botim i Bibliotekës Kombëtare të Tiranës, vëllimi i parë i të cilës, për periudhën 1454-1835, pa dritën në vitin 1997[11].

Sido që të jetë, si thamë, një shtysë pasqyrimit të epokës dhe të personalitetit të Skënderbeut iu dha në vitin 1968, në tubimet shkencore kushtuar 500-vjetorit të vdekjes së tij. Me këtë rast u botuan kumtesa edhe për Skënderbeun si frymëzues veprash, gjinish të ndryshme letrare, të autorëve shqiptarë dhe të huaj. Kështu, sa u përket letërsive të huaja, në konferencat shkencore, me rastin e këtij përvjetori panë dritën kumtesa për jehonën e epokës së Skënderbeut në letërsitë: angleze[12], franceze[13], italiane[14] dhe suedeze[15]. Ndërsa, më përpara ishte botuar një studim për pasqyrimin e heroit tonë në letërsitë ruse dhe ukrainase[16]. Nga ana tjetër u botuan edhe studime për vepra të veçanta, çfarë është poema e poetit maqedonas Grigor Prliçev *Skenderbeg*[17], ajo e poetit hungarez Miklosh

[6] Georges Petrovitch, *Scanderbeg (Georges Castriota). Essai de bibliographie raisonnée*..., Paris, 1881.

[7] Émile Legrand, Henri Gûys, *Bibliographie albanaise*..., Paris, 1912.

[8] Jean Kersopoulos, *Série des bibliographies françaises sur les nations balkaniques. Nr.1. Albanie. Ouvrages et articles parus de 1555 à 1934*, Athènes, 1934.

[9] *Albanica*. Tiranë, 1965.- Kjo bibliografi, e ripunuar dhe e plotësuar, u ribotua në vitin 1998: *Albanica I*, Tiranë, 1998.

[10] *Albanica II*, Tiranë, 1987.

[11] Kasem Biçoku, Jup Kastrati, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Bibliografi, 1454-1835*, Tiranë, 1997.

[12] Skënder Luarasi, *Skënderbeu në letërsinë angleze*, *Konferenca e dytë e studimeve albanologjike*, Tiranë, 1969, vëll. I, f. 431-438.

[13] Nonda Bulka, *Skënderbeu dhe letërsia frënge*, *po aty*, f. 439-443.

[14] Henrik Lacaj, *Skënderbeu në letërsinë italiane, po aty*, f. 445-453.

[15] Kosovë Rexha-Bala, *Skenderbegu në letërsin suedeze, Shêjzat*, XII, 1968, f. 196-211.

[16] P. M. Popov, *Albania v rosijskij ta ukrainskij literaturah XV-XX st.*, Kiiv, 1959.

[17] Vladimir Georgiev, *Figura e Skënderbeut në poezinë e Grigor Përliçevit, Konferenca e dytë e studimeve albanologjike*, Tiranë, 1969, vëll. I, f. 425-429 dhe Olivera Nasteva, *Skenderbeg kaj Grigor Prlicev*, *Simpoziumi për Skënderbeun*, Prishtinë, 1969, f. 361-367.

Fazekas Bogati *Historia në gjashtë pjesë e bëmave trimërore të të madhit Gjergj Kastrioti*[18], ndërsa Vinçenc Malaj botoi një vështrim për një autor me prejardhje malaziase, Stefano Zanoviqin, i cili mëtonte se ishte pasardhës i Kastriotëve dhe për veprën e tij *Le grand Castrioto d'Albanie*[19], si edhe për dy opera me kryepersonazh Skënderbeun, për operën e kompozitorit italian në zë, Antonio Vivaldit, të shfaqur në Teatrin Pergola të Firences[20] dhe për operën e kompozitorëve francezë, Rëbel e Frankër, të shfaqur në Operën e Parisit[21].

Mirëpo, duhet thënë se kumtesat për pasqyrimin e heroit tonë në letërsitë e ndryshme evropiane, të kumtuara në tubimet shkencore, u botuan në atë vëllim, që ishin kumtuar në ato tubime, pa u zgjeruar dhe përpunuar. Dihet se punimet e kumtuara në tubime shkencore rëndom paraqiten të përmbledhura, ndërsa në botimet e tyre ato zgjerohen dhe përpunohen. Kështu, nuk ndodhi me këto kumtesa. Prandaj, ato lënë për të dëshiruar. Një veprim i këtillë, ndërkaq mund të shpjegohet edhe me faktin se këto punime nuk ishin rezultat i një pune sistematike dhe të përkushtuar studimit të jehonës së epokës dhe të personalitetit të Skënderbeut në këto letërsi. Ato ishin më shumë punë rasti, të përgatitura për konferencat shkencore të asaj kohe. Pra, vështrime të shkurtëra të kësaj tematike. Kështu, në kumtesën e Skënder Luarasit *Skënderbeu në letërsinë angleze*, brenda shtatë faqesh trajtohen veprat e 8 autorëve; brenda 4 faqesh të kumtesës së Nonda Bulkës *Skënderbeu dhe letërsia frënge* trajtohen veprat e 9 autorëve; Henrik Lacaj, në kumtesën e tij *Skënderbeu në letërsinë italiane* brenda 6 faqesh bën fjalë për veprat e 10 autorëve. Në një vëllim, kaq të kufizuar të këtyre punimeve, mund të jepen vetëm disa njohuri themelore për autorët dhe veprat e tyre, ndërsa për ndonjë zbërthim më të gjerë as që mund të bëhet fjalë. Duhet të thuhet, me këtë rast, se edhe numri i autorëve për të cilët bëhet fjalë në këto punime është i kufizuar. Madje, një numër jo i vogël autorësh të këtyre letërsive, në hapësirën e kufizuar të këtyre kumtesave, nuk kanë mundur të gjenin vend.

[18] György Daniel, *Vepra e parë letraro-artistike hungareze mbi Skënderbeun, Konferenca e dytë e studimeve albanologjike,* Tiranë, 1969, vëll. I, f. 421-423.

[19] V. Malaj, *Stefano Zanovich, un sedicente erede di Skanderbeg, Shêjzat*, 4-6, 1968, f. 184-195.

[20] V. Malaj, *L'opera «Scanderbeg» dell'Abate Vivaldi, po aty*, 1-3, 1968, f. 40-43.

[21] *V. Malaj, Un opera musicale francese del Settecento su Scanderbeg, po aty*, 7-12, f. 273-281.

Nga ana tjetër, shumë letërsi të tjera, çfarë ishin veprat e botuara, që i referohen Skënderbeut, në gjuhët: latine, spanjolle, portugeze dhe polake, u lanë në heshtje të plotë. Dhe, edhe sot e kësaj dite, i njohim vetëm titujt e tyre.

Me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit, nga gjuhët e huaja, u përkthyen dhe u botuan në gjuhën shqipe, disa vepra që i referohen heroit tonë. Ne kemi të dhëna për botimin e romanit *Skënderbeu* të autorit italian Antonio Zonkada, për romanin *Konstandini dhe Morsinia* të autorit anglez Xhejms Lludllou dhe për dramën *Skënderbeu ose Liri dhe Dashuri* të bashkëkombësit të tij, Tomas Uinkopit, për veprat e dy autorëve francezë, novelën *Skënderbeu* të autorit Zhan Bomar dhe për dramën *Skënderbeu ose Heroi shqiptar* e autorit Rogasien Fores, si edhe për poemën *Skënderbeu* e autorit maqedonas Grigor Prliçev dhe për romanin *Balada ballkanike* e shkrimtarit serb M. Jankoviq.

Mirëpo, nga studimet e botuara për pasqyrimin e Gjergj Kastriotit në letërsitë evropiane, si edhe nga veprat e përkthyera të këtyre letërsive, mund të kemi një pasqyrë të mangët për jehonën e epokës së Skënderbeut në këto letërsi. Ndërsa, pas shënimit të 500-vjetorit të vdekjes së heroit tonë, në këtë fushë nuk është bërë shumë punë. Përjashtim këtu bëjnë dy letërsi, letërsia e re greke dhe ajo frënge, pas botimit të monografisë së Titos Johalasit *Skënderbeu në historiografinë dhe letërsinë e re greke*[22] dhe të monografisë së autorit të kësaj kumtese *Skënderbeu në letërsinë frënge*[23].

Ndërkaq, punë për t'u bërë, në këtë fushë, ka ngelur mjaft. Duke lënë mënjanë letërsitë, që u bënë objekt trajtimi në tubimet shkencore të vitit 1968, të cilat, si thamë, u shqyrtuan mjaft përciptas, për letërsitë në gjuhë të tjera, të cilat deri tani u lanë në heshtje, gjetëm mjaft vepra që presin dorën e studiuesve. Kështu, duke u mbështetur vetëm në vëllimin e parë të bibliografisë *Gjergj Kastrioti Skënderbeu*, të botuar në Tiranë në vitin 1997, për periudhën e viteve 1454-1835, për letërsinë në gjuhën latine regjistruam se janë shkruar 6 vepra poetike, ndër të cilat pesë sosh janë botuar, ndërsa njëra ruhet në dorëshkrim[24] dhe gjashtë

[22] Titu Johalas, *O Georgios Kastriotes – Skenterbeis is tin neollenikin istoriografian qe logotehnian*, Thessaloniki, 1975.

[23] YmerJaka, *Skënderbeu në letërsinë frënge*, Prishtinë, 1990.

vepra dramatike, të gjitha anonime, ndër të cilat ajo e fundit është vënë në skenë[25]; për letërsinë gjermane regjistruam një vepër poetike,[26] dy vepra dramatike[27] dhe një roman[28]; për gjuhën spanjolle regjistruam katër vepra dramatike, ndër të cilat dy sosh nuk u botuan[29]; për gjuhën polake regjistruam një vepër poetike[30] dhe një roman[31], të frymëzuara nga Skënderbeu.

Edhe letërsitë e tjera evropiane, të cilat u trajtuan në kumtesat e vitit 1968, do të thotë letërsitë: angleze, italiane, ruse, ukrainase dhe suedeze, meritojnë trajtimin e duhur, meqë, siç u tha, në ato kumtesa vetëm sa janë prekur.

Është e udhës të theksohet se një pjesë e madhe e veprave letrare me temën skëndrebegiane kanë dalë nga pena e autorëve minorë. Pra, janë me vlera modeste artistike, mirëpo kjo nuk do të thotë se ato nuk duhet të bëhen objekt studimi. Madje, studimet e këtyre veprave janë me interes si për kulturën tonë, meqë ato kanë si subjekt një epokë të rëndësishme dhe një personalitet

[24] H. Bolonius, *Huic libeljo est titulus Scander*, dorëshkrim; J. J. Pontanus, *Carmina*, *Tumuli*, 1531; J. Kockert, *Scanderbegus id est carmen...*, Lubacae, 1643; J. De Bussieres, *Scanderbegus*, Lugduni, 1656.- Kjo vepër pati edhe gjashtë ribotime; G. Dondinus, *Selecta Heroum...*, Monachii, 1669; F. Seitz, *Novem fortitudinis exemple heroico carmine descripta*, Graeci, 1670.

[25] *Chelmscianae Lunae ad victoriosum ensem [...] Scenicé in Georgio Castrioto...*, p. v., 1685; *Athleta Christi*, p. v., p. d.; *Publica Sarmatiae felicitas In Scanderbego Albaniae Principe*, p. v., 1714; *Victoria in fuga, sive Castriottus a Turcis ad patriam et regnum gloriose rediens...*, Graecii, 1718; *Neo Alexander Amore Patriae [...] Georg Castriot, Scanderbeg genannt...*, Regensburg, 1727; *Scanderbegi Victoria in pedibus*, p. v., 1756.

[26] F. Krug Von Nidda, *Scanderbeg Heroisches Gedicht in zehn Gesängen*, Leizig, 1823.

[27] K. Sondershausen, *Scander-beg. Drama in drei Aufzügen*, Altenburg, 1821; K. Sondershausen, *Larissa, Oder der Schwur. Drama in vier Aufzügen*, Altenburg, 1821.

[28] J. A. C. Hildebrandt, *Fürst Scanderbeg der Ubüberwindliche...*, Quedlinburg und Leipzig, 1828.

[29] L. Velez de Guevara, *El Principe Escanderbey, Comedia famosa*, p. v., 1634; L. Velez de Guevara, *El Principe Esclavo*, p. v., p. d.; J. P. de Montalban, *Auto famoso sacramental del principe esclavo Escanderbec*, pjesë teatrale e pabotuar, e shfaqur më 1629; Melgarejo, *Escanderbey*, p. d., dorëshkrim.- Për këto vepra bën fjalë shkurtimisht A. Kostallari, *Figura e Skënderbeut...*, *Konferenca e dytë e studimeve albanologjike*, f. 386.

[30] F. Kamienski, *Woyny Greckie z Porta Ottomanska dzielnoscia Jerzego Kastryota xiazecia Albanskiego przezwanego Skanderbek...*, Winie, 1773.

[31] Theodor Tomasz Je□, *O Byt*, p.v, p.d.

të dorës së parë të historisë sonë, por mund të jenë me interes edhe për letërsitë të cilave u përkasin, meqë trajtojnë një tematikë të caktuar.

Nga ana tjetër, një numër i madh poezish në gjuhët: latine, angleze, spanjolle, franceze, gjermane, portugeze, polake, kroate dhe serbe janë botuar si shtojca në një varg veprash të ndryshme, historike dhe letrare[32]. Këto poezi, ndër të cilat një vend të spikatur zë soneti, mund të përmblidhen në një antologji, të përkthyera në gjuhën shqipe, besoj, jo pa interes për lexuesit tanë, si edhe për kritikën tonë letrare. Përmbledhje kjo, e cila më thotë mendja se do të hapte shteg për zbërthime të ndryshme të kësaj prodhimtarie poetike, si edhe për evolucionin e frymëzimit nga Skënderbeu të poetëve të vendeve dhe të periudhave të ndryshme kohore.

[32] M. Becichemus, *Opera. Brixiae, Angelus Britanicus*, p. v., 1503-1504; M. Barletius, *Historia de Vita et Gestis Scanderbegi Epirotarum Principis*, Rome, 1508-10; J. J. Pontanus, *Carmina, Tumuli,* p. v., 1531; P. Iovio, *Pavli Oivii Novocomensis EpiscopiNucerini Elogia virorum bellica ...*, Basileae, 1561; J. De Lavardin, *Histoire de Georges Castriote surnommé* Scanderbeg..., Paris, 1576. – Kjo vepër pati edhe pesë ribotime ; D. Franco, *Gli illustri et gloriosi gesti, et vittoriose imprese, fatte contra Turchi, Dal Sig. D. Giorgio Castriotto, detto Scanderbeg, Prencipo d'Epirro...*, Vinegia, 1584; *Epicedion*, Krakow, 1585; J. J. Boissardus, *Vitae et Icones Sultanorum Turcicorum*, Francoforti, 1596; Melgarejo, *Escanderbey*, p. v., p. d.; D. Custos, *Artium heroicum, Caesarum, regum...*, Augustae, 1600; Th. Funccius, *Scanderbeg...*, Magdeburgk, 1606; R. Knolles, *The generall historie of the Turkes...*, London, 1621; G. G. Ricci, *Diporti di Parnaso, Rime e Prose...*, Roma, 1635; F. Blancus, *Georgius Castriottus Epirensis vulgò Scanderbegh...*, Venetiis, 1636; G. Dondinus, *Selecta Heroum Spectacula in Amphitheatro Fortidinis...*, p. v., 1669; P. Damaschino, *La spada d'Orione...*, Roma, 1680; P. Bogdanus, *Cuneus Prophetarum...*, Patavii, 1685; L. de Meneses, *Exemplar de virtudes morales en la vida de Jorge Castrioto, Llamado Scanderbeg...*, Lisbosa, 1688; *The Mourning Court; or a tributs of tearshfor the death of [...] Prince George...*, London, 1708; A. Zaniboni, *Le valorose azioni del principe Scanderbech...*, Bologna, 1730; J. A. Guer, *Mœurs et usages des Turcs...*, Paris, 1747; A. Cacich, *Razgovor ugodni naroda slovinskoga...*, Mleczi, 1756; *Kalendar, ili Uregjeno Prikazanje Nediljah i Svetkovinah...*, Budim, 1766; S. Zannowich, *La poésie et la philosophie d'un Turc...*, Albanopolis, 1779; M. K. Oginski, *Powieści historyezne y moralne napisane Wierszem przez obywatela Slonimskiego*, Warszawa, 1782; S. Zanowich, *Œuvres choisies du Prince Castriotto d'Albanie...*, p. v., 1782; S. Zannowich, *Stiepan-Annibale d'Albanie à Frédéric-Guillaume de Prusse...*, St. Pétersburg, 1783; G. G. Byron, *Childe Harold's Pilgrimage*, London, 1812; G. Baila, *Compendio dell'Istoria di Giorgio Castriotto sopranominato Scanderbeg, Principe dell'Albania...*, Napoli, 1820; J. S. Popovi?, □ivot i Vite□ka vojevanja slavnoga kneza Epirskoga Djordja Kastriota Skanderbega..., Budim, 1828; A. Papadopulo-Vretò, *Correzioni ed aggiunte alla Prefazione del Compendio dell'Istoria di Giorgio Castriotto sopranominato Scanderbeg...*, Greppet, Corfù, 1829.

Në vargun e gjatë të veprave letrare me kryepersonazh Skënderbeun, një vend të posaçëm zënë veprat dramatike. Në vëllimin e parë të bibliografisë *Gjergj Kastrioti Skënderbeu* gjetëm 24 vepra të kësaj gjinie, drama, tragjedi dhe librete operash, ndër të cilat 9 sosh, me më shumë ose me më pak sukses, u vunë në skenë. Disa, ndër këto vepra, të vëna në skenë, dështuan që në premierën e tyre, derisa disa të tjera, çfarë janë operat, patën mjaft sukses. Kështu, opera *Scanderbeg* e kompozitorit italian Antonio Vivaldit, libretin e të cilës e shkroi Antonio Salvi, u shfaq tetëmbëdhjetë herë radhazi në teatrin La Feniçe të Firencës në vitin 1718, ndërsa opera *Scanderberg* e kompozitorëve të njohur francezë në kohën e tyre Rebel e Frankër, sipas libretit të Udar dë la Motit, autor shumë i njohur në kohën e tij dhe anëtar i Akademisë Franceze, u shfaq 33 herë radhazi në Operën e Parisit në vitin 1735 dhe u rivu në skenë në Fontenëblo, në vitin 1763, në manifestimet për nder të mbretit Luigjit XV. U bënë përpjekje që kjo operë të vihej sërish në skenë në vitet 1765-1766, si edhe në vitet 1777 dhe 1783, por këto përpjekje dështuan.
Studimi i krijimtarisë dramatike të frymëzuar nga Skënderbeu, vlerat artistike të veprave të kësaj gjinie, vënia e tyre në skenë, sukseset ose dështimet e vënies së tyre në skenë, regjisorët, skenografët dhe kostumografët e tyre, japin dorë për shumë zbërthime në këtë fushë.
Studimi dhe analiza e partiturave të ruajtura të operave të Vivaldit dhe të Rebelit e Frankërit, me kryepersonazh Skënderbeun, është punë për muzikologët. Sipas njohurive që kemi, deri tani është botuar vetëm një studim për pjesët e ruajtura të partiturave të operës së Vivaldit[33].

[33] Shih Ennio Stipçeviq, *Opera «Scanderbeg» e Antonio Vivaldit*, në gazetën *Rilindja*, 24.VI. – 6.VII. 1984. Në studimin e tij për këtë operë E. Stipçeviq bën fjalë edhe për libretin e saj dhe autorin e tij.- Para botimit të këtij studimi, me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, si shënuam më sipër, Vinçenc Malaj, botoi një studim për këtë operë, shih Vincenzo Malaj *L'opera "Scanderbeg" dell' Abate Vivaldi, Shêjzat*, 1-3, 1968, f. 40-43, në të cilin bën fjalë për autorin e libretit, kompozitorin dhe vënien e kësaj opere në skenë, pa hyrë në analizën artistike të pjesëve të ruajtura të partiturave, ashtu si vepron edhe në studimin e tij për operën e kompozitorëve francezë Rëbel e Francœur, shih Vincenzo Malaj, *Un'opera musicale francese del Settecento su Scanderbeg, Shêjzat,* 7-12, 1968, f. 273-281. Për operën e Rëbelit e Frankërit janë botuar edhe studime të tjera, shih Frédéric Robert, *Një opera mbi Skënderbeun e Rebelit dhe Frankërit, Nëndori,* 9, 1960, f. 143-149 dhe *po ai, Scanderbeg le héros national albanais dans un opéra de R. Francœur, Recherches sur la musique française classique*, Paris, 1963, f. 171-178; shih edhe Ymer Jaka, *Skënderbeu në një operë frënge,* në *Skënderbeu në letërsinë frënge*, Prishtinë, 1990, f. 229-266.- Mirëpo në këto studime bëhet fjalë për libretin e operës, kompozitorët, vëniet e operës në skenë, aktorët e shfaqjeve, skenografitë dhe kostumet, ndërsa partiturat e saj, të ruajtura në bibliotekën e Operës së Parisit të pallatit Garnier dhe në Bibliotekën Nacionale të Parisit, sipas njohurive që kemi, deri tani nuk janë bërë objekt analizash muzikologjike.

Nga ana tjetër, jo vetëm veprat e shumta historike, por edhe ato letrare të autorëve të huaj, mund të jenë ndihmesë për studimin e kësaj epoke të historisë sonë.
Kështu, poeti italian i shekullit XVI, Baldazar Skarameli, i cili në vitin 1585 e botoi përmbledhjen e poezive me titullin *Dy këngë të poemës heroike për Skënderbeun*[34], vë në dukje se në vitin 1583, duke udhëtuar me anije nga Kreta për në Veneci, i zuri furtuna dhe udhëtarët e saj zbritën në tokën shqiptare, ku u pritën me bujari. Ai shkruan se këtu, si edhe gjatë udhëtimit nëpër Maqedoni, Tesali e Greqi, e gjeti të gjallë kujtimin e luftërave dhe të betejave fitimtare të Skënderbeut, më shumë se një shekull pas vdekjes së tij. Është kjo një dëshmi interesante për vazhdimësinë e ruajtjes së kujtimit të heroit tonë kombëtar dhe të kësaj epoke të historisë sonë, jo vetëm te bashkëkombësit e heroit, por edhe te fqinjtë tanë.
Nga sa u tha më sipër, del se detyrat që i shtronte këtu e 37 vjet më parë, Androkli Kostallari për studimet në fushën e pasqyrimit të Skënderbeut në letërsinë botërore, sidomos ajo e hartimit të «monografive të veçanta, të ndërtuara sipas kriterit kronologjik, historiko-gjeografik, tematik ose gjinijor»[35] u realizuan në një masë të vogël, të kufizuara në monografitë mbi Gjergj Kastriotin në letërsitë franceze dhe greke.
E nisëm këtë kumtesë, duke kujtuar manifestimet për 500-vjetorin e vdekjes së Skënderbeut, meqë sivjet jemi në 600-vjetorin e lindjes së tij, përvjetor ky shumë më i rëndësishëm se ai i vitit 1968. Mirëpo, fitohet përshtypja se jemi më pak të organizuar se këtu e tridhjetë e shtatë vjet më parë, meqë sivjet na bëhet, se deri tani, kur po mbahet ky sesion në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, kur kaluan gati katër muajt e motmotit të pagëzuar «Viti i Skënderbeut», nuk kemi bërë aq sa duhet për kremtimin e këtij përvjetori. Është e vërtetë se në mediat tona, kohë pas kohe, është bërë fjalë për këtë përvjetor, aty-këtu është botuar edhe ndonjë punim për heroin tonë kombëtar. Një dëshmi, që i kushtohet këtij përvjetori, është edhe sesioni i sotëm në kuadër të manifestimit «Java e Bibliotekës në Kosovë», por puna e bërë deri tani, lë përshtypjen se institucionet tona kulturore, deri tani, nuk janë

[34] *Baldasar Scaramelli, Dui canti del poema heroico di Scanderbeg...*, Carmagnola, 1585, f. 57-59.- Të dhënat për këtë vepër i kemi marrë nga bibliografia e K. Biçokut dhe J. Kastratit, *Gjergj Kastrioti Sënderbeu, I,* Tiranë, 1997, f. 128.
[35] A. Kostallari, *punimi i përmendur*, f. 372.

organizuar aq sa duhet në këtë fushë.
Ndërkohë, pas mbajtjes së «Javës së Bibliotekës në Kosovë», para se ta përgatitja për botim versionin e zgjeruar të kumtesës së lexuar në sesionin kushtuar 600-vjetorit të lindjes së Skënderbeut në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, patëm rastin të ishim të pranishëm në Konferencën Shkencore të mbajtur në Tiranë më 18 maj 2005, me rastin e 600-vjetorit të lindjes së heroit tonë kombëtar, të titulluar *Gjergj Kastrioti Skënderbeu në historinë e shqiptarëve*, organizator i së cilës ishte Departamenti i Historisë i Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë i Universitetit të Tiranës. Në këtë konferencë u lexuan 20 kumtesa, ndër të cilat vetëm dy sosh ishin të autorëve nga Kosova, vetëm këta dy autorë ishin ftuar, ndërsa nuk ishte i pranishëm askush nga trojet e tjera shqiptare, Maqedonia dhe Mali i Zi. Vetëm një autor në programin e kësaj konference ishte nga bota e jashtme. Prandaj, në të vërtetë, ishte kjo një konferencë kombëtare. Duhet shtuar, me këtë rast, se në fund të kësaj konference u zhvilluan fare pak diskutime, më shumë me karakter polemik dhe pa ndonjë përmbajtje me interes, të cilat rëndom janë pjesë e rëndësishme e tubimeve të këtilla shkencore.
Gjatë muajit nëntor, të këtij viti, janë paraparë të mbahen tri tubime shkencore kushtuar 600-vjetorit të lindjes së Skënderbeut, në Tiranë, në Prishtinë dhe në Shkup. Në Shkup, me këtë rast, do të ngrihet edhe një përmendore e Skënderbeut. Arkivi i Kosovës me rastin e mbajtjes së simpoziumit në Prishtinë do ta organizojë një ekspozitë dokumentesh për Skënderbeun. Ndërkaq, prej 1 deri më 3 dhjetor 2005, Universiteti i Napolit organizon simpoziumin ndërkombëtar me temën *Skënderbeu në historiografi dhe letërsi*. Duket se do të jetë ky i vetmi tubim ndërkombëtar, për këtë përvjetor, ndërsa sa kemi parë nga programet e parapara për tubimet, që do të mbahen në Tiranë, në Prishtinë dhe në Shkup, në këshillat organizuese figurojnë vetëm emra shkencëtarësh vendorë, kurse pjesëmarrja e shkencëtarëve të huaj, ka të ngjarë, se do të jetë pak a shumë simbolike.
Duhet të shtojmë këtu, se ndër veprimtaritë e zhvilluara deri tani, për kremtimin e 600-vjetorit të lindjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, janë edhe dy ekspozita të arteve pamore me temën skënderbejane, të hapura në Galeritë e Arteve në Tiranë dhe në Prishtinë, pas konkurseve të shpallura nga këto galeri për punime me këtë temë, në të cilat u ekspozuan punime të përzgjedhura nga këto konkurse.

Sido që të jetë, veprimtaritë e zhvilluara deri tani, si edhe ato që janë paraparë të zhvillohen nga fundi i këtij viti, e mbështesin përshtypjen e theksuar në fillim të kësaj kumtese, se ky përvjetor mund të ngelë në hijen e atij të vitit 1968. Posaçërisht, në fushën e sjelljes së ndihmesave të reja shkencore për këtë epokë të rëndësishme të historisë sonë dhe për figurën e Gjergj Kastriotit. Kështu, pra, punët e bëra deri tani, si edhe përgatitjet e deritanishme për manifestimet e ardhshme, na japin dorë të druajmë se emërtimi «Viti i Skënderbeut», i paralajmëruar në fillim të këtij viti, vështirë se do t'i ketë ato përmasa çfarë na linte të shpresonim.
Mbase, dikush mendon se studimet skënderbejane i kemi shteruar dhe nuk kemi ç'të sjellim të re në këtë fushë. Ne nuk mendojmë kështu, na thotë mendja se ka edhe shumë punë për t'u bërë në të gjithë lëmenjtë e këtyre studimeve. Sa për ilustrim, dëshmuam se me punën e bërë, deri tani, në studimin e pasqyrimit të epokës dhe të personalitetit të Skënderbeut në letërsitë evropiane nuk mund të themi se ka vend për kënaqësi.
Në fund e shohim të udhës të pohojmë se detyrat në këtë fushë nuk mund të përmbushen me nisma individuale, këto studime duhet të bëhen pjesë e projekteve të institucioneve tona shkencore, në bashkëpunim eventual edhe me ato të vendeve, ku panë dritën veprat, në të cilat bëhet fjalë për Gjergj Kastriotin. Madje, këto projekte duhet të jenë shumëdisiplinore, ngase kjo epokë e historisë sonë duhet të ndriçohet nga aspekte të ndryshme, për të cilat duhet të angazhohen ekipe specialistësh përkatës, si edhe duhet të sigurohen mjete të konsiderueshme materiale për hulumtime në biblioteka dhe arkiva të ndryshme.
I shpreh miradi Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, që në *Javën e Bibliotekës në Kosovë*, të këtij viti, një seancë ia kushtoi përvjetorit të lindjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe kështu u bë e mundshme që, ndër të tjera, të vihen në pah edhe detyrat që na presin për ta larë borxhin, që kemi ndaj personalitetit më madhështor të kombit tonë.

Dr. Rexhep Munishi
Instituti Albanologjik i Prishtinës

Studimi i krijimtarisë muzikore kushtuar Skënderbeut

Interesimi për të hulumtuar burime, të dhëna dhe për t'i grumbulluar ato, e më pas, edhe për t'i publikuar për krijimtarinë muzikore, që i është kushtuar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut (1406-1468), është i vazhdueshëm dhe i shfaqur nga studiues e profesionistë profilesh të ndryshme. Natyrisht, më theksueshëm është dashur të jetë nga ata të muzikës. Mirëpo, nuk mjafton vetëm interesimi, por duhet edhe qasje tjetër. Në këtë kontekst, në evidencimin e krijimtarisë muzikore, llojesh të ndryshme, është bërë një punë, të themi elementare, me dobi të madhe për shkencat muzikore. Sado që krijimet muzikore kushtuar figurës së Skënderbeut kanë shenja të kenë qenë të para disa shekujve, të dhëna të grumbulluara, në një vend, nuk ka pasur deri vonë dhe ende nuk ka në masë të dëshiruar. Një falënderim të madh, shkenca e muzikologjisë, por edhe ajo e albanologjisë, ia ka borxh studiuesit tonë të mirënjohur Ramadan Sokoli (1920-), i cili me librin e tij Figura e Skënderbeut në Muzikë ("8 Nëntori", Tiranë, 1978) arriti t'u ofrojë, të interesuarve, të dhëna e fakte, për gati të gjitha krijimet muzikore, që iu kushtuan Skënderbeut. Natyrisht, nuk përjashtohet mundësia të ketë edhe ndonjë

vepër tjetër muzikore, të krijuar, për të cilën nuk ka arritur të ketë njohuri R. Sokoli, por fatkeqësisht asnjëri hulumtues i muzikës, pas tij, nuk shkoi më larg për të ofruar më shumë dëshmi. Të dhënat e grumbulluara të këtij autori, më pas janë bartur, parafrazuar, përfolur nëpër shkrime, libra të historisë së muzikës etj. Me disa paraqitje shkrimore ka kontribuar edhe Engjëll Berisha (Shih E. B. Studime dhe vështrime për muzikën, ASHAK, Prishtinë, 2004, f. 64-68), me të dhënat e ofruara për krijimtarinë e bërë në Kosovë, ku plotëson ato që ishin të njohura nga R. Sokoli.

Kronologji e krijimtarisë muzikore për Skënderbeun

Mundësitë për ta bërë objekt studimi krijimtarinë muzikore që i kushtohet Skënderbeut janë të shumta. Kjo krijimtari është e shtrirë në kohë, në sasi e në cilësi të ndryshme, dhe se për të mund të dalin studime e studime fushash që i takojnë muzikës. Në vazhdim, shkurtazi do të shohim sasinë e kësaj krijimtarie. Me këtë rast, ne shfrytëzuam dy referencat e dy autorëve të sipërpërmendur dhe një shkrim nga Admirina Peçi (Gazeta "Panorama", Tiranë, 26 tetor 2003), mbi të cilat mbështesim shkrimin tonë.

Pas vdekjes së Skënderbeut, personaliteti i tij ishte bërë i njohur në tërë Evropën dhe për të shkruhej e flitej, figura e tij paraqitet në shumë anë dhe ajo ka tentime edhe të përvetësohet. Për të thuren legjenda, emri i tij përfshihet nëpër histori, po edhe bëhet objekt frymëzimi në krijimtarinë artistike. Për të fillojnë të shkruhen edhe vepra muzikore. Muzikologjia shqiptare ka arritur të mbledhë të dhëna e të argumentojë, se, që në shekullin XVIII shkruhet njëra nga format më të mëdha skenike, opera, që për motiv dhe për personazh qendror ka pikërisht Skënderbeun. Kështu, kompozitori i njohur italian Antonio Vivaldi (1677-1741) në libretin e Antonio Salvit kompozon operën "Scanderbeg"- Drama per musica, e cila për herë të parë shfaqet më 22 korrik 1718 në Firencë. Siç e kanë të ditur muzikologët, një pjesë e operës ka humbur dhe kanë ngelur të ruajtura vetëm rreth 60 faqe, me katër arie dhe dy recitime. Gati, po në atë kohë, në Bolonjë të Italisë botohet libreti në tri akte për operën "Trimëritë e princit Skenderbe, ngadhnjyesit mbi sulltan Muratin" e Anton Xaniboni, e cila shënohet si operë komike, por jo e tipit të operës, por e tipit dramatik, (konstatim i R. Sokolit). Një operë me titull "Skanderbeg" është shfaqur më 27 tetor në vitit 1735, në

teatrin e Versajës. Me atë rast, vepra u shfaq 35 herë rresht (R. Sokoli e shënon 33 herë, f. 41 vërejtja jonë). Libretist ishte Antuan Hudar d'la Mot, anëtar i Akademisë franceze dhe Zhan de la Serre, kurse muzikën e kompozuan Fransua Rebel dhe Fransua Franker, që ishin atëherë një çift i njohur dhe shumë i suksesshëm. Pas tridhjetë vjetësh, kjo operë shfaqet edhe në Paris. Tani, me uvertyrë dhe me valle të ripunuara (shih Admirina Peçi, gazeta "Panorama" dhe R. Sokoli, Op. cit. f. 41). E shënojmë këtu, se pas 258 vjetësh Opera e Antonio Vivalidit do të shfaqet në Tiranë. Kori Femëror dhe Orkestra e Harqeve e Akademisë së Arteve në Tiranë nën drejtimin e dirigjentit Milto Vako, për herë të parë, më 19 dhjetor 2003 do t'ua bëjë të njohur muzikëdashësve operën "Scanderbeg" të këtij kompozitori italian. Për autorët shqiptarë, Skënderbeu, relativisht vonë u bë objekt frymëzimi, për të cilin do të krijohen vepra muzikore. Historia e muzikës shënon një emër interesant për ta hulumtuar. Fjala është për Vladimir Gjergj Kastriotin Skënderbeun (1820-1879), kompozitor, i cili jetoi në Rusi. Mendohet se ai ishte njëri nga pasardhësit e Skënderbeut, trimit tonë legjendar, dhe ka indikacione se mund të ketë lënë ndonjë vepër muzikore për atdheun, e ndoshta edhe për vetë Skënderbeun. Harallamb Kristo Koçi i dalë në Amerikë, i kthyer në Shqipëri, e që më pas shkoi në Rusi, supozohet se mund të ketë një operë kushtuar Skënderbeut, por është e shënuar se ka kompozuar marshe e pjesë të ndryshme rreth trimërisë së tij. Është plotësisht e njohur një poemë e tij heroike "Vdekja e Skënderbeut" (R. Sokoli, 47). Përveç këngëve popullore, të bartura gojë më gojë, krijimtarinë artistike muzikore kushtuar Gj. K. Skënderbeut e nisë Martin Gjoka, me një vepër, që sot e kësaj dite shkakton diskutime rreth përkufizimit gjinor të "simfonisë": "Dy lule mbi varr të Skënderbeut", të filluar më 1918 dhe të kryer më 1922. Është e njohur se F. S. Noli ka kompozuar poemën simfonike "Scanderbeg", i mbështetur dhe i inspiruar nga teksti i poetit Henri Llongfello. Krijimtari muzikore më intensive dhe diç më sasiore do të arrihet pas Luftës së Dytë Botërore. Është shumë interesant, se pjesa më e madhe e veprave muzikore, që i kushtohen Skënderbeut janë shkruar me porosi ose me konkurs me rastin e 530 vjetorit të vdekjes së tij (më 1968). Në kuadër të kësaj krijimtarie prijnë katër vepra të mëdha skenike, siç është opera. Opera e parë është kompozuar nga Prenk Jakova (1919-1969…): "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" në libret të Llazar Siliqit e shfaqur më 17.01.1968 në skenën TOB-it në

Tiranë. Po në atë vit dhe bile pak ditë më parë, (9.01.1968), Trupa e amatorëve të Shtëpisë së Kulturës "Aleksandër Moisiu" shfaq edhe operën "Bijtë e Skënderbeut" të kompozitorit Abdullah Grimci. Opera tjetër, kushtuar trimit tonë, është "Fundi i Golemëve" në libret të Kolë Jakovës, kompozuar nga Nikolla Zoraqi. Avni Mula, po ashtu, ka kompozuar operën "Legjenda krutane", në libret të L. Gurakuqit, për të cilën nuk gjetëm shënimin se është shfaqur ndonjëherë.

Në fondin e veprave orkestrale, që i kushtohen Skënderbeut, përveç atyre që i përmendëm të M. Gjokës e F. Nolit, duhet shënuar këtu poemën dramatike simfonike "Skënderbeu", të kompozitorit Fahri Beqiri, dhe muzikë filmi nga Çesk Zadeja. Nuk është numër i madh, as i krijimeve vokale ose vokale me shoqërime instrumentale. Përmendim këtu këngën korale "Nën Skënderben", për solist dhe kor të autorit Karaman Osmanli; pastaj "Vdekja e Skënderbeut", për kor të përzier nga Konstantin Trako; "Kthimi Skënderbeut në Krujë" e harmonizuar nga R. Sokoli me shoqërim të pianos; këngë për kor të përzier "Gjergj Kastrioti" nga Nikolla Zoraqi në tekst të Luan Qafzezit dhe "Këngë e luftëtarëve të Krujës", kompozuar nga Çesk Zadeja. Nga kremtimi i 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut dhe gjatë viteve '70-të, edhe kompozitorë shqiptarë nga Kosova, kompozuan këngë korale në përkushtimin të kësaj figure: Esat Rizvanoilli, "Fjala e Skënderbeut" për kor, recitator dhe grup instrumental me tekst të Rrahman Dedajt; Lorenc Antoni, "Skënderbeu ngadhnjimtar"- teksti i Enver Gjerqekut; Zeqirja Ballata, "Doli Skënderbeu"- teksti, Rrahman Dedaj, dhe Mark Kaçinari, "Bijt e Shqipës" në tekst të Rifat Kukajt, kantatë e vogël, pa përcjellje instrumentale (E. Berisha, f. 65).

Lëndë e bollshme për studime etnomuzikolgjike e muzikologjike

Studiuesit e etnomuzikologjisë mund të kenë lëndë të bollshme për të bërë studime mbi krijimtarinë muzikore popullore, që i është kushtuar Skënderbeut. Besohet se ka material, relativisht të mjaftueshëm, për të bërë përmbledhje e më pas edhe studime të kësaj krijimtarie gojore. Kështu, nga institucionet shkencore, si në Institutin e Kulturës Popullore, në Institutin Albanologjik të Prishtinës, po edhe nga incizimet e konservuara në Radio Tiranë, Radio Shkodër, Radio Prishtinë etj., do të mund të sigurohej material i dobishëm, jo vetëm për një studim, po edhe për më shumë studime. Shumë

këngë janë kënduar dhe janë bartur nga gjenerata në gjeneratë në të gjitha hapësirat shqiptare. Këto këngë mund të jenë kënduar njëzëshme, po edhe shumëzërëshe, mund të jenë interpretuar me shoqërime instrumentesh, nga më të ndryshmet, i kanë kënduar këngëtarët e të gjitha moshave e gjinive. Studimet etnomuzikologjike do të përfshinin fazën hulumtuese për të konstatuar sasinë e këngëve të mbledhura, të shënuara me nota. Dhe, natyrisht, një hulumtim rreth gjendjes aktuale të të kënduarit të këtyre këngëve, kushtuar Skënderbeut. Dimensioni etnomuzikologjik i kësaj krijimtarie do të përfshihej, duke analizuar komponentët melopoetikë të këtyre këngëve, për nga forma, sistemet ritmike, radhët tonale (shkallët) dhe elemente të tjera, që do të ishin karakteristike për këto këngë. Përmes analizës së tyre do të vëreheshin afërsitë, po edhe dallimet e mundshme mes kësaj krijimtarie dhe llojeve të tjera të krijimtarisë muzikore popullore. Krijimtaria muzikore popullore, që i kushtohet Skënderbeut, mund të trajtohej edhe nga dimensione fushash të tjera, si ajo sociologjike e etnopsikologjike.

Në planin e studimeve muzikologjike është realizuar faza e parë e kësaj disipline shkencore, që nënkupton mbledhjen dhe evidentimin e të dhënave rreth krijimtarisë që i është kushtuar Skënderbeut. Me rastin e shfaqjes së veprave skenike, koncerteve me vepra të ndryshme, janë shprehur mendime të rastit, të karakterit kryesisht gazetaresk- informativ. Deri tani nuk dimë për ndonjë botim të veçantë, më të thelluar studimor, që i kushtohet krijimtarisë muzikore, kushtuar Skënderbeut (përveç librit të R. Sokolit). Nga gjashtë operat (tri nga autorë të huaj dhe tri të tjera nga autorë shqiptarë), sipas shënimeve muzikologjike, vetëm për operën e Vivaldit është bërë një studim serioz shkencor i muzikologut të njohur arbëresh nga Zara, Ennio Stip?evi? (në fillim të viteve '80-të). Prandaj, me një angazhim, mund të bëheshin studime të këtyre operave, qoftë të veçanta, ose për të gjitha. Për atë numër të këngëve korale, që janë shkruar nga disa autorë shqiptarë, në distancë kohore jo shumë të largëta, por në stile të ndryshme të krijimit, do të ishte me interes të bëhen studime të veçanta kushtuar kësaj krijimtarie. Veprat orkestrale si ajo e M. Gjokës: "Dy lule mbi varrin e Skënderbeut" dhe poema dramatike e Fahri Beqirit, nuk janë bërë gati asnjëherë objekt i ndonjë studimi serioz analitik në tërësi, por vetëm parcialisht.

Përkundër vullnetit, respektit e konsideratës, që mund të ishte e pranishme te secili kompozitor, për një njeri të madh të historisë sonë, siç ishte Gjergj

Kastrioti-Skënderbeu, krijimtaria muzikore kushtuar atij, nuk është numerikisht e kënaqshme dhe aq sa e ka merituar përkushtimi për të. Nga kronologjia e krijimtarisë fitohet përshtypje se pas vitit jubilar 1968 gati asnjërit kompozitor, më, nuk i bie ndërmend se ishte dikur Gjergj Kastrioti-Skënderbeu. Tani, këtu shtrohet edhe pyetja, se sa janë interpretuar këto vepra jashtë viteve jubilare. Me ndonjë hulumtim këmbëngulës do të verifikohej interpretimi i veprës konkrete: sa herë është luajtur ajo, nga kush, ku, me çfarë rasti, a është incizuar etj. Po ashtu, do të ishte me interes të shihej masa e interesimit të studiuesve shqiptarë (ose eventualisht të huaj), që këto vepra të bëhen objekt i analizave gjithëpërfshirëse të studimeve muzikore. Vlera dhe vlerësimi kritik e objektiv i kësaj krijimtarie muzikore, kushtuar këtij personaliteti të madh të historisë shqiptare, duhet parë dhe duhet shtruar në mënyrë më studimore. Nga studiuesit kërkohet gjykim objektiv rreth kësaj krijimtarie, sepse nga fondi i tërësishëm krijues fitohet përshtypje se nuk del ndonjë vepër e madhe që do t'i kalonte kufijtë e përmasave të hapësirës kulturore shqiptare. Faktet muzikore janë dhënë, në mënyrë që veprat të vlerësohen në kontekstin kohor të krijimit dhe në atë të bartur deri më sot, por sa janë të mëdha (jo për nga forma, por për nga vlera) dhe të qëndrueshme ato vepra, duhet gjykuar studiuesit, sepse siç thotë, P. H. Lang "…Për ne veprat e mëdha janë të mëdha për faktin se nuk u vdes aktualiteti, e jo për moshën e saj dhe jo për atë, që ishin krijuar para 100 vjetëve, por që ekzistojnë edhe pas 100 vjetësh" (I. Supicic, f. 41).

Tani, kur i kthehemi kësaj krijimtarie muzikore, që i kushtohet Skënderbeut, po edhe asaj në përgjithësi shqiptare, jemi të detyruar ta kemi në mendje një të kaluar me ngarkesa ideologjike, gjë që, ka ndikuar edhe në vlerën e saj me parametra universal.

Temën që e shtruam vetvetiu, hap probleme të natyrës tjetër, që kërkon rishikim, rivlerësim të nismave muzikologjike shqiptare dhe mungesën e studimeve më të thelluara në fusha e disiplina të tjera hulumtuese shkencore muzikore. E themi kështu, sepse duhet të jetë e qartë, se muzikologjia shqiptare ende gjendet në fazën e regjistrimit dhe të përshkrimit të krijimtarisë muzikore dhe ky është një fakt i dobishëm dhe i rëndësishëm, por, njëkohësisht edhe relativisht brengosës për shkencën muzikore shqiptare. Për të mos e lënë peshën e krijimtarisë muzikore shqiptare vetëm në rëndësinë historike të paraqitjes dhe në vlerësimin e vazhdueshëm, vetëm nga

dimensioni moral e patriotik, kërkohen studime të thelluara, të shumanshme, për ta dëshmuar edhe vlerën artistike muzikore, që e kanë këto vepra dhe krijimtaria jonë muzikore në përgjithësi. Ky konstatim, sado që mund të duket i ashpër dhe i dhembshëm, është një realitet, që duhet të tërheqë vëmendjen, se rrethit kulturor shqiptar i nevojiten ngritje kuadrosh, profilesh nga më të ndryshme, në fushën hulumtuese shkencore të muzikës. Kërkohen specializantë të avancuar në muzikologji, në estetikë të muzikës, sociologë të muzikës, analitikë të aftë për të gjykuar e vlerësuar me profesionalizëm, të gjitha llojet e krijimtarisë muzikore shqiptare.

Shyqri NIMANI
Fakulteti i Arteve

Skënderbeu në artet pamore

(Me rastin e 600-vjetorit të lindjes së Skënderbeut)

"Nuk ka njeri në botë, i cili të mos dijë trimëritë që keni bërë dhe që të mos ju lavdërojë deri në qiell si një kryembrojtës të vërtetë dhe si një luftëtar bujar të krishtërimit."

Papa Kalisti III, (1457)

Figura e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut ka tërhequr vëmendjen, duke u bërë frymëzim i amshueshëm, jo vetëm të historianëve e letrarëve, por edhe të muzikantëve e të artistëve figurativë shqiptarë e të huaj. Për këtë shëmbëlltyrë të lavdishme, të dalë nga gjiri i popullit të lashtë dhe fisnik shqiptar, janë shkruar qindra vepra letrare në gjini dhe lloje të ndryshme, në gjuhët më të rëndësishme botërore. Heroizmi i popullit shqiptar, në krye me Skënderbeun, në kundërvënie fuqisë më të madhe të kohës, kishte tërhequr përkrahjen, simpatinë dhe shpresën e Evropës së shekullit XV. Skënderbeu, me udhëheqjen e luftës së popullit shqiptar, për 25 vjet me radhë, do të bëhet figura qendrore e heroizmit dhe e rezistencës së vazhdueshme, plot, njëshekullore (1380-1479) e popullit shqiptar kundër pushtuesve osmanë.

Skënderbeu në kështjella dhe në muze evropiane

Fatbardhësisht, në fushën e arteve figurative kemi në disponim shumë vizione artistike, që paraqesin figurën madhështore të të famshmit Gjergj Kastrioti-Skënderbeu. Portretin më të hershëm, që e njohim deri më sot, i cili ruhet në Galerinë Ufici të Firencës (Itali) mendohet se është pikturuar sipas një vizatimi të bërë drejtpërdrejt nga piktori i shquar italian, Xhentile Belini (Gentile Bellini, 1429-1507, i cili e ka bërë edhe portretin e Mehmetit II në Stamboll), me rastin e udhëtimit të Skënderbeut në Itali, më 1466. Këtë pikturë, të punuar me ngjyra vaji, sipas disa njohurive më të reja (1983), e ka punuar piktori italian i shekullit XV-XVI Kristofan Altisimo (Christofano dell' Altissimo), sipas të cilit shembull janë krijuar shumë realizime të mëvonshme. Portreti i Skënderbeut në këtë pikturë jepet në profil, në moshë të pleqërisë, me tipare të theksuara: flokë dhe mjekër të gjatë e të thinjur, sy të gjallë dhe hundë shqiponjë. Në pjesën e epërme të portretit, në shtrirje horizontale, është shkruar teksti me shkronja subtile me serife në versal: GEORGIUS SCANDERBEK. Autori i pikturës vërtet ka arritur ta realizojë një portret autentik piktural të figurës markante të Skënderbeut.

Portrete të Skënderbeut, me vizione të ndryshme, gjenden edhe në muze të njohura, siç është ai i Historisë së Artit në Vjenë, ku ruhet një portret i hershëm me ngjyra vaji. Një pikturë e viteve 1500 ndodhet në kolegjin italo-shqiptar të Kozencës në Itali. Po ashtu, në Fermo të Italisë, në sallën e Bashkisë së qytetit, është pikturuar një portret që i takon shekullit XVIII. Portrete dhe tablo të tjera gjenden edhe në pronësi private. Një portret me pamje të veçantë të Skënderbeut, i punuar me ngjyra vaji, nga shekulli XV ose XVI, gjendet në një familje të Parisit. Në këtë portret, që paraqitet deri në gjysmë të trupit në kostume bujare evroperëndimore të kohës, Skënderbeu paraqitet me libër në dorë, ku nën të qëndron teksti në frëngjisht: Gjergj Kastrioti i quajtur Skënderbej, princ i Epirit dhe i Shqipërisë, sundoi në vitet e zotit 1437 dhe ndërroi jetë në vitin 1467. Trupi i tij pushon në qytetin e Lezhës në Shqipëri. (Viti i vdekjes është dhënë gabimisht). Një kompozicion piktural, në shtrirje horizontale, gjendet në familjen arbëreshe Skiroi në Sicili, që titullohet: "Dasma e Skënderbeut". Kjo tablo, për nga motivi që trajton, është e veçantë, sepse ka atmosferë solemne të gërshetuar me një lirizëm poetiko-piktural. Në të dominojnë, në mesin e një mori figurash,

shëmbëllesat e Skënderbeut dhe të nuses së tij, Donikës.

Në Borgar (Beauregard) të Francës, në një kështjellë të shekujve XVI-XVII, gjendet një portret i Skënderbeut në vistrën e gjatë të mbi 360 portreteve të figurave më të shquara të botës gjatë shekujve. Në një kështjellë tjetër, në atë Bytca, afër qytetit Zhilina në Çekosllovaki, kemi një portret, gjithashtu, të veçantë të Skënderbeut: përmasat e figurës janë mbinatyrore, tiparet e fytyrës dhe kostumet janë të një trajtimi personal piktural në teknikën e pikturës monumentale.

Zbulime të reja

Ndonëse, deri më sot janë evidencuar mbi 150 vepra artistike, të fushave të ndryshme, të arteve figurative të autorëve të ndryshëm, hulumtimet vazhdojnë më tutje. Unë tash do të përqendrohem në trajtimin e dy portreteve të Skënderbeut, të cilat janë pak ose aspak të njohura për opinionin shkencor, ose për atë të gjerë shqiptar, por edhe të huaj. Për një portret të Skënderbeut, të punuar nga Ivan Meshtroviq, kisha dëgjuar që moti. Për këtë qëllim kam shfletuar shumë libra e monografi mbi Mashtroviqin, për ta parë atë vizatim, por më kot. Nuk ishte botuar në asnjërën prej tyre. Udhëtova dy herë për në Split, por nuk kreva punë. Herën e tretë, ia dola të siguroj fotografinë e këtij punimi. Autori i tij, Ivan Meshtroviq (1883-1962), është skulptori më i madh kroat dhe njëri ndër më të mëdhenjtë e këtij shekulli në nivel botëror. Opusi skulptural i tij përbëhet nga një gërshetim specifik me elemente të secesionit bashkëkohor, të ekspresivitetit gotik dhe të religjiozitetit mistik. Këtë vizatim të Skënderbeut, të punuar me laps në letër, të përmasave të vogla, Meshtroviqi e krijoi në moshën djaloshare. Vizatimi nuk mban datën e krijimit. Mund të supozohet se ai, këtë portret, e ka bërë kur ishte bari në Otavice, ku kishte kaluar në mënyrë idilike fëmijërinë dhe rininë e hershme. Ky vizion figurativ i portretit të Skënderbeut nuk është invencë personale e Meshtroviqit, por përshkrim i drejtpërdrejtë i një gravure të vjetër. Meshtroviqi i ri duhet të ketë qenë i magjepsur nga heroizmi i Skënderbeut, nga njëra anë, si dhe nga bukuria artistike e gravurës markante të Kastriotit, nga ana tjetër. Siç dihet, figura madhështore e Skënderbeut, si simbol i lirisë, një kohë të gjatë ishte bërë shembull kombëtar në mbarë Evropën. Përgjigjja, pyetjes, se nga i ra në dorë Meshtroviqit gravura e bukur e Skënderbeut, prej

të cilës e bëri këtë vizatim, mbase mund të gjendet në këtë drejtim: më 1743 edhe në Zagreb botohet libri i njohur i Marin Barletit Historia de vita et gestis Scanderbegi, Epirotarum principis (Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut, princit të epirotëve). Dihet mirë, se të shumta janë përkthimet e veprës së Barletit në gjuhët kryesore të Evropës, të shoqëruara me gravura të ndryshme, të cilat e ilustronin tekstin. Një libër të tillë duhet ta ketë parë Meshtroviqi i ri. Në këtë vizatim, Meshtroviqi e përshkruan Skënderbeun në profilin e njohur, me shikim në të majtë, me përkrenare në kokë, mbi të cilën gjendet koka e dhisë me brirët e thepisur. Në pjesën e poshtme të figurës, horizontalisht, me shkrim subtil kaligrafik e ka shënuar emrin e trimit: Jure Kaštrioti? Skenderbeg (në këtë rast kroatizimi i emrit dëshmon për popullaritetin e Kastriotit të lavdishëm si simbol liridashës dhe i popujve të robëruar të Ballkanit). Vizatimi është i nënshkruar dy herë. Një herë në pjesën e epërme të krahut të djathtë - Meštrovi? dhe herën tjetër në pjesën e poshtme, në këndin e djathtë të vizatimit, diagonalisht - Ivan Meštrovi?.

Për një portret tjetër të Skënderbeut, gjithashtu, kisha dëgjuar që moti. Fjala është për portretin e Skënderbeut, të pikturuar në muret e brendshme të Kishës Katolike Shqiptare në Prizren. Pra, në murin e brendshëm të fasadës së kishës, mbi nivelin e ballkonit, në lartësi prej nja pesë metrash, gjenden dy portretet e aleatëve të famshëm kundër pushtuesve osmanë, Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe Janosh Huniadit. Potretet janë pikturuar në teknikën e pikturës murale (afresk). Kompozicionet përbëhen nga dy pjesë integrale, përmasash të njëjta, vizuale dhe tipografike, në lartësi prej 200 dhe në gjerësi prej 90 centimetrash. Në pjesën e epërme të kompozicionit jepet fytyra e Skënderbeut në en face, që paraqet raritet, me mustaqe dhe mjekër të gjatë - ta bardhë, me përkrenaren e

njohur mbi të cilën shquhen brirët e thepisur të dhisë. Portreti është pikturuar me intencë të qartë, për të dhënë iluzionin e dimensionit të tretë skulpturor të një busti të vendosur në kishë. Andaj, me një trajtim të tillë të plasticitetit është krijuar atmosferë e dëshiruar, e cila në shikim të parë lë përshtypje thuajse kemi të bëjmë me vepër skulpturore, e jo pikturale. Përse është vepruar kështu, tash për tash, vetëm mund të supozojmë. (Mbase ka munguar një mjeshtër i skulpturës?). Duke patur këtë intencë, piktori është detyruar që edhe mbarështrimin piktural ta bëjë monokromatik: paleta koloristike përbëhet prej vetëm katër tonesh të ndjeshme, dy të përhitura dhe

dy të ullinjta të ngrohta (si dhe me theksimin e të bardhës neutrale). Autori i është përmbajtur me konsekuencë fenomenit të dritës dhe të hijes dhe e ka arritur iluzionin e kushtëzuar. Në pjesën e poshtme të bustit gjendet nënshkrimi i autorit me shkronja të bardha - Sim Kowiss. Siç shihet, shkronja e parë dhe e katërt e emrit janë të shkruara në versal (të mëdha), ndërsa të tjerat në kurent (të vogla). Çështja e autorit të pikturës mbetet të qartësohet në një studim të posaçëm në të ardhmen. Në pjesën e poshtme të kompozicionit qëndron teksti me shkronja kapitale:

GEORGIUS KASTRIOTA
PRIMUS PRINCEPS
ALBANIAE
1443-1467

(Po cekim se viti i vdekjes nuk është i saktë).

Në anën tjetër, gjendet portreti i Janosh Huniadit, në ikonografi përkatëse hungareze, i paraqitur në mënyrë identike në tretman si ai i Skënderbeut. Përjashtim bën vetëm burimi i rrezeve të dritës, të cilat vijnë në drejtim të kundërt nga ato të Skënderbeut. Në pjesën e poshtme të kompozicionit qëndron teksti me shkronja kapitale:

JOANNES DE HUNYAD
GUBERNATOR ET DUX
HUNGARIAE
PUNGAVIT CUM KASTRIOTA
KONTRA TURCOS IN KOSOWO
1456.

Në këtë mbishkrim, sipas njohurive historike, kemi të bëjmë me dy çështje: a) teksti njofton se Huniadi (Joannes de Hunyad, 1407-1456) luftoi me Skënderbeun kundër turqve në Kosovë. Fjala është për fushatën ushtarake të Huniadit në vjeshtën e vitit 1448, i cili u drejtua për në Kosovë për t'u bashkuar me forcat shqiptare, nën komandën e Skënderbeut. Mirëpo, rrethimi osman i Sfetigradit dhe tradhtia e despotit serb Gjuragj Brankoviqit,

bëri që të vonohen forcat shqiptare. Më 18 tetor të vitit 1448, ushtria hungareze pësoi disfatë afër Prishtinës.

Mediumi i grafikës së librit

Që nga botimet e para të autorëve shqiptarë (Anonimi i Tivarit, 1480, Marin Barleti, 1508) dhe të autorëve të huaj (Jacques de Lavardin, 1576, ose Benjamin Disrael, 1833), duke filluar nga shekulli XV e deri në ditët tona, janë krijuar një mori grafikash, të cilat kanë shërbyer si ilustrime të teksteve të librave të shumtë. Në mesin e këtyre autorëve shquhen Jost Aman, Jorg Bre, Robert Vogan, Tobias Stimer, Domeniko Kusto, Andrea Bianki, Blanshet, Albreht Dyrer e shumë të tjerë. Piktori dhe grafisti gjerman Jost Aman (Jost Amman, 1539-1591), i njohur si një nga artistët më të frytshëm të kohës së vet, veprat e të cilit gjenden në muzetë e kalibrit të Luvrit të Parisit dhe të Albertinës së Vjenës, e përjetësoi rrethimin e Krujës dhe betejat heroike shqiptare në gravurat e tij mesjetare. Artisti zviceran, Tobia Stimer (Tobias Stimmer, 1539-1584), në mesin e vargonit të figurave të shquara botërore, ka vendosur edhe vizionin e tij grafik të Skënderbeut. Ky portret është botuar në përkthimin gjermanisht të veprës së Paolo Jovit (Paulus Iovius, 1483-1552)"Lëvdime për burrat e shquar" (Elogia Virorum bellica virtute illustrate, Venedik, 1561. Gjithashtu, edhe piktori e grafisti anglez, Robert Vogan (1600-1678), në ciklin e tij të punuar në teknikën e bakërgdhendjes, në të cilën përfshihen portretet e njerëzve më të shquar të historisë botërore, ka gdhendur edhe portretin e Skënderbeut. Në këtë album të veçantë, të botuar më 1622, jepen shënime për secilën figurë. Gravura e Skënderbeut shoqërohet me shënime biografike prej 12 faqesh. Piktori dhe grafisti gjerman, Jorg Breu (Jourg Breu, 1510-1547), ka krijuar pesëmbëdhjetë gravura me tematikë nga rezistenca shqiptare kundër pushtimit osman. Këto gravura janë përdorur si ilustrime të botimit gjermanisht (1533) të Historisë së Skënderbeut të Barletit.

Një portret të Skënderbeut të gdhendur në metal, sipas revistës Djalëria të Vjenës e vitit 1922, e ka krijuar mjeshtri i madh gjerman, Alberht Dyrer (Albreht Dürer, 1471-1528). Revista në fjalë boton gravurën të përcjellë me shënimin Skënderbeu mbas origjinalit prej Dürerit.

Konkursi i dështuar ndërkombëtar

Si pasojë e synimeve të kahmotshme, për ta ngritur një monument madhështor të Skënderbeut, u iniciua në Mbretërinë e Shqipërisë më 1937, shpallja e një konkursi ndërkombëtar. Në këtë periudhë, të rëndë politike, kulturore dhe ekonomike, në të cilën gjendej shteti dhe populli shqiptar, konkursi në fjalë nuk mund të siguronte ndonjë sukses të dukshëm të autorëve shqiptarë. Pjesëmarrja e skulptorëve vendës ishte numerikisht shumë e vogël. Në konkurs morën pjesë autorë nga Franca, nga Hungaria, nga Bullgaria, nga Italia, nga Austria, nga Jugosllavia etj. Fitoi projekti (boceti) i skulptorit kroat Antun Augustinçiq (1900-1979), i cili nuk u realizua. E drejta për realizim iu dha skulptorit italian, Romano Romanelit, projekti i të cilit u realizua disa vjet më vonë në Romë.

Skënderbeu në pikturën e ikonografëve shqiptarë

Përfytyrimi i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut arriti të ringjallet dhe të bëhet subjekt kryesor në artin e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, duke u përçuar deri në ditët tona pa ndërprerje. Tash, mund të themi pa kurrfarë dyshimi, se nuk ka artist figurativ shqiptar, që së paku njëherë të mos e ketë trajtuar si subjekt piktural, skulptural ose grafik (por edhe në artet aplikative) figurën e Skënderbeut.

Portreti më i hershëm (që dihet deri më sot), i një piktori ikonograf shqiptar, është vepra e Jorgji Panaritit Portreti i Skënderbeut (1883), i cili një kohë kishte qëndruar në Malin e Shenjtë (në Athos) të Greqisë. Disa vjet më vonë, më 1889, një piktor tjetër, ikonograf, korçari Anastas Nikolla Ballamaçi, punoi portretin Skënderbeu në kalë.

Përfytyrimin e Skënderbeut në kalë Ballamaçi e paraqet me tipare të veta origjinale, me veshje dhe pajime luftarake: me fustanellë, jelek, kallca e stoli të tjera të qëndisura rëndë, me një skufje të kuqe të butë në kokë. Një piktor tjetër, ikonograf, Vangjel Zengo (1875-1941), i ka kushtuar heroit tonë vetëm një tablo me titull Skënderbeu në betejë (1933), që paraqet një kompozicion tipik konvencional me aksion dinamik luftarak. Disa portrete të Skënderbeut, të trajtuara me ngrohtësi pikturale, i ka bërë edhe piktori, ikonograf, dhe patriot Theohar Gjini, veprimtaria e të cilit është e lidhur me fillimin e shekullit XX.

Skënderbeu në pikturën e re shqiptare

Figura e Skënderbeut ka qenë (është dhe do të jetë) subjekt i pashmangshëm i të gjithë krijuesve shqiptarë, i të gjitha kohëve dhe i të gjitha hapësirave shqiptare, si në trojet etnike, ashtu edhe në diasporë. Mburrja me një figurë, aq madhështore, është plotësisht e arsyeshme. Me të, po ta kishin, do të mburreshin me të drejtë të gjithë popujt e botës. Janë shumë artistë shqiptarë, të njohur e të panjohur, me vepra të ruajtura ose të humbura, që së paku një herë ta kenë portretuar Skënderbeun. Spiro Xega (1876-1953), për shembull, si piktor, autodidakt, që ishte, mik i Naim Frashërit, bashkëluftëtar i Çerçiz Topullit dhe luftëtar për Shpalljen e Pavarësisë, kishte pikturuar një cikël të tërë, prej tetë tablosh, kushtuar Skënderbeut, herë në kalë, e herë në këmbë, duke filluar nga viti 1913: Skënderbeu (kjo pikturë është botuar në kalendarin e ZËRIT për vitin 1992), Skënderbeu triumfon në fushën e Domosdovës, Skënderbeu pret delegatët e Sulltan Muratit etj. Edhe piktori shqiptar (arvanit) nga Greqia, Niko Egonopuli (1910-1985) është inspiruar nga figura e Skënderbeut.

Periudhë e frytshme dhe mjaft cilësore, në trajtimin e mirëfilltë artistik të figurës së Skënderbeut, është koha pas Luftës së Dytë Botërore, sidomos pas daljes së gjeneratës së re profesionale në skenën artistike. Spektri i temave është i gjerë. Disiplinat dhe teknikat pikturale janë të llojllojshme. Vistri i autorëve është i gjatë - Guri Madhi (1922-1988); Dorëzimi i armëve (1957), kompozicion në shtrirje horizontale, me të tërhequra të vrullshme të brushës, me gamë të ngrohtë koloristike, me dimensione të thella planesh; Sali Shijaku (1933-): Artileria e Skënderbeut (1968), metaforë e shkëlqyer pikturale, në të cilën shquhet vëllimi i trajtës, dinamika e lëvizjes, temperamenti ekspresiv dhe invenca e shtjellimit të temës; Jakup Keraj (1934-): Kuvendi i Lezhës (1968), tablo në të cilën shquhet një vistër portretesh në lëvizje të llojllojshme, pikturuar me poteza të gjerë; Kuvendi i Lezhës është subjekt piktural edhe i piktorit Josif Droboniku; Dhimitraq Trebicka (1936-): Në Kështjellën e Krujës (1976), vizioni i një këndvështrimi lirik të një mjedis epik; Skënder Kamberi (1939-): Betimi i Vrana Kontit (1968), kompozicioni me thurje të bukur figurash në vargon horizontal, me ikonografi mesjetare të modifikuar; dhe vepra tjetër e S. Kamberit: Në Vjenë sikur pashë Skënderbenë, pikturë me atmosferë nostalgjike, në të cilën dominon e vendosur në vitrinë qelqi shpata dhe përkrenarja autentike e Skënderbeut që ruhet në muzeun vjenez. Një vizion tjetër, të suksesshëm, të Kuvendit të Lezhës, të kësaj Besëlidhjeje të Madhe Shqiptare të vitit 1444, e ka dhënë edhe piktori i mirënjohur Zef Shoshi (1939-).

Në pikturën monumentale shquhen veprat e Naxhi Bakallit, Bashkim Ahmetit, Niko Progrit, Fatmir Haxhiut, Muhamet Deliut etj., që gjenden në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë dhe në Muzeun Gj. K. Skënderbeu në Krujë.

Këtë vit, me rastin e 600-vjetorit të lindjes së Skënderbeut, 1405-2005, në Tiranë, në Prishtinë dhe në vise të tjera shqiptare do të kremtohet në mënyrë madhështore: me vepra të reja në fushat shkencore dhe artistike.

Skënderbeu në skulpturën e re shqiptare

Duke filluar nga Murad Toptani (1866-1918) e deri në ditët tona, janë tre krijues shqiptarë, të cilët me përkushtim afatgjatë dhe kalitje të mirëfilltë artistike janë shquar posaçërisht në trajtimin e figurës së Skënderbeut. Është trinomi frytdhënës, i përbërë nga mjeshtrit e skulpturës Odhise Paskali, Janaq Paço dhe Andrea Mano. Odhise Paskali (1903-1985) krijoi Bustin e Skënderbeut (Kukës 1939), i cili me të drejtë mban primatin e krijimit më të bukur të portretit të Skënderbeut, që është realizuar deri më sot. Për më tepër, si kryevepër e skulptorit tonë të mirënjohur, ky bust madhështor shëmbëllen vizionin më të pranueshëm nga të gjithë, që tashmë është bërë përfytyrim autentik i Skënderbeut. Nga ana tjetër, skulptori Janaq Paço (1914-1991), ishte krijues që i kushtoi pjesën më të madhe të veprimtarisë së vet krijimit të një përmendoreje të denjë të Skënderbeut. Pas dhjeta vjetësh punësh të pandërprera, ai arriti që më 28 nëntor të vitit 1959 të përfundojë vizionin e tij të Skënderbeut në kalë, monument ky që u vendos në mjedisin autentik skënderbegian pranë maleve kreshnike të Krujës së lavdishme. (Ky monument, si replikë skulpturale, u vendos rishtas edhe në Prishtinë). Një përmendore tjetër, që e krijuan së bashku O. Paskali, J. Paço dhe A. Mano pas një pune të gjatë prej dhjeta vjetësh, që u ngrit më 1968 në Sheshin Skënderbe në Tiranë, shëmbëllen përmendore solemne, e cila u përurua në kuadër të veprimtarive për 500-vjetorin e vdekjes së Skënderbeut. Ndërsa, Janaq Paçoja, në koautorësi me Genc Hajdarin (1947-), krijoi

edhe veprën e vet, të tretë, të madhe kushtuar kryetrimit, që u vendos në Muzeun Historik Gjergj Kastrioti-Skënderbeu (Krujë, 1982) me emërtimin Skënderbeu dhe luftëtarët e vet.

Literatura:

1. Altissimo, Kristofano Del: "Skënderbeu", vaj në pëlhurë, shek. XV-XVI, Galeria Ufici, Firencë;
2. Paskali, Odhise: Skënderbeu (1937);
3. Paskali, Odhise: Skënderbeu, Kukës, 1939;
4. Paço, Janaq: Skënderbeu, Krujë, 1959;
5. Paskali, Paço, Mano: Skënderbeu, Tiranë, 1968;
6. Kisha Katolike Shqiptare në Prizren;
7. Kowiss, Sim: Skënderbeu;
8. Kowiss, Sim: Huniadi;
9. Meshtroviq, Ivan: Skënderbeu;
10. Muzeu Kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, Krujë;
11. Përkrenarja, emblema dhe vula e Skënderbeut;
12. Skënderbeu dhe Karli i Madh, nga vëllimi i Lorenzo Ignacio Thiulen: Dialoghi nel regno de' morti:Dialogho primo fra Giorgio Castrioto, altimenti detto Scandergeg, re d'Albania, e d'Epiro, e l'imperatore romano Carlo Magno, botuar në Romë më 1832 në pesë pjesë;
13. Portreti i Skënderbeut, pikturë anonime nga fundi i shek. XVII;
14. Skënderbeu me shpatën dhe përkrenarën e tij, gravurë nga Armamentarium Heroicum, Wien, 1601;
15. Thomai, Thoma: Skënderbeu në sulm;
16. Romanelli, R.: Monumenti i Skënderbeut, Sheshi Albania, Romë;
17. Kodra, Ibrahim: Skënderbeu.

Mr. Avni SPAHIU

Koleksioni fonografik me fjalimet e Nolit: ligjërimi nolian

Sivjet shënohen disa jubile që lidhen me personalitete dhe ngjarje të rëndësishme kombëtare. Ky vit shënon edhe 35-vjetorin e vdekjes së Fan S. Nolit, një ndër figurat më të shquara, figurë erudite e shekullit XX te shqiptarët. Me emrin e tij lidhet një epokë e tërë e historisë së shqiptarëve, që nga Rilindja e vonë Kombëtare e deri te shpallja e shtetit shqiptar dhe ndërtimi i tij deri në Luftën e Dytë Botërore...
Fan Noli lindi dhe krijoi jashtë atdheut të tij. Ai qëndroi në Shqipëri vetëm për një kohë të shkurtër, në vitet '20, kur edhe u zgjodh deputet i Parlamentit të Shqipërisë, pastaj edhe kryeministër i saj. Kryesisht jetoi në Shtetet e Bashkuara, ku zhvilloi një aktivitet shumëdimensional si: klerik (themeloi Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare), poet, përkthyes, politikan, diplomat, kritik letrar, historian, muzikant...

Amerika

Më 1905, Fan Noli u vendos së pari në Xhejmstaun të Nju Jorkut. Një vit më vonë (kah fundi i vitit 1906) ai vajti në Boston.

Në vitin 1982, me rastin e njëqindvjetorit të lindjes së Theofan Stilian Nolit, Arçdioqeza Ortodokse Shqiptare në Boston bëri lirimin e një koleksioni fonografik të disa fjalimeve politike, letrare, patriotike dhe liturgjike të Fan Nolit mbajtur në raste dhe solemnitete të ndryshme në Boston, kryesisht gjatë viteve '60. Pjesa më e madhe e këtyre fjalimeve ose ligjëratave në gjuhën shqipe dhe atë angleze kanë të bëjnë me politikën shqiptare, letërsinë, biografinë e Nolit, muzikën, historinë e kishës ortodokse në Amerikë, me përkthimet letrare dhe kishtare, si dhe me veprimtarinë e tij e të veprimtarëve të tjerë shqiptarë në kolonitë e shqiptarëve të Amerikës. Fan Nolin, këtë orator të dëgjuar, e mbajnë në mend, ata që e kanë njohur si një folës skofiar nëpër ndeja, takime e kuvendime të ndryshme, në mesin e shqiptarëve të Amerikës, gjatë ligjërimeve të tij në Boston e gjetkë. Si dhe, në shkrimet e tij, si një ligjërues i shkëlqyer në fjalimet e tij politike dhe kulturore, si dhe në polemikat me kundërshtarët. Ai kultivonte një pleqërim të larmishëm dhe të pasur, me mesele e shprehje, që i gjente në të folmen e gjerë popullore. Madje, edhe në gjuhën angleze...

1. Anglisht... CD

Si shquarje qendrore në këtë koleksion fonografik është ligjërimi i Nolit për çështje të kulturës, për letërsinë dhe poezinë, në veçanti. Në këtë koleksion fonografik është karakteristike mënyra e ligjërimit të Nolit: në shqip përplot anekdota, të folur konciz e të rrjedhshëm, por edhe lakonik e të përshkuar me anekdotat dhe të folurit popullor; mirëpo edhe në anglisht, me një leksik të pasur dhe përplot ilustrime nga kultura e botës angleze.
Noli jep këshilla të shumta për shkrimtarët e ardhshëm, kurse shembujt e panumërt, që i nxjerr nga historia e civilizimit njerëzor, flasin sa për thellësinë dhe erudicionin intelektual të tij, aq dhe për adhurimin që kishte për njerëz të mëdhenj dhe artistë të shquar, që ka dhënë njerëzimi, gjatë epokave të zhvillimit të tij. Në të gjitha këto ligjërime ka edhe të dhëna për biografinë dhe karakterin e tij si intelektual, politikan, krijues dhe si njeri.
Ligjërata e parë, ashtu si dhe ajo e dyta, rreth temës së gjerë të krijimit letrar dhe artistik është bërë në gjuhën angleze. Noli, me këtë rast, flet para një auditori në Boston, me gjasë në vitin 1962.

CD 2: Anekdotat

Duke nisur ligjërimin e tij të parë mbi letërsinë, Noli flet për rrethanat që bëjnë krijuesin dhe për faktorët që ndikojnë në krijimin, a në bërjen e një shkrimtari. Si shembull, ai merr Ipolit Tenin, shkollarin frëng të shekullit XIX, i cili në një libër mbi artin, rreshtonte tre faktorë që ndikojnë në punën e një krijuesi: frymëzimin, tregun dhe vlerësimin. "Shkrimtari do të shfrytëzojë për vete çdo gjë që ka përreth. Çdo gjë që e frymëzon", thekson Noli. Për triumfin e artit mbi konvencionet dhe kanonet e kohës, Noli flet edhe për piktorin e famshëm spanjoll, Francisko Gojan. Pastaj, ai merr shembullin e Betovenit, i cili ishte ithtar i Revolucionit francez. Është e qartë nga dëgjimi i kësaj ligjërate, të stërmbushur me shembuj nga historia e civilizimit dhe kulturës botërore, se Noli kishte një konsideratë të lartë për epokën e Renesansës evropiane. Siç shihet, edhe nga shembuj të tjerë gjatë jetës së tij, Noli mahnitej gjithnjë me shembujt e krijimtarisë dhe gjenialitetit artistik të kësaj periudhe të pasur dhe të ndritshme kulturore. Më tutje, në ligjëratë, ai shpalon disa prej kujtimeve të veta rreth preokupimit të tij me letërsinë dhe gazetarinë.
Pasi vë në pah faktorët që e bëjnë shkrimtarin, Noli shpjegon përvojën dhe frymëzimin vetanak si shkrimtar. Frymëzimin, thotë Noli, e gjeta aty ku e gjetën të gjithë pionierët e tjerë të Rilindjes shqiptare. Këtu, ai jep edhe pikëpamjen e vet ndaj kësaj periudhe të rëndësishme historike. Duke vazhduar ligjëratën mbi faktorët që krijojnë shkrimtarin, Noli shpjegon mënyrën se si filloi të merrej me shkrime dhe ku filloi së pari.
Për angazhimin e vet publicistik, Noli flet më vonë, kur shpalon kujtimet, me rastin e ardhjes së tij të parë në Shtetet e Bashkuara. Shkrimin e parë gazetaresk e bëri pasi iu bashkua Sotir Pecit në Boston, për ta botuar e redaktuar gazetën "Kombi". Në shumë raste, Noli ka theksuar se mësues i tij i mirëfilltë i të shkruarit shqip kishte qenë Faik Konica, ligjërues dhe njohës i shkëlqyer i gjuhës, si dhe luftëtar i normëzimit të gjuhës së shkruar shqipe. Në pjesën e dytë të ligjëratës së tij mbi letërsinë, për frymëzimin dhe punën letrare, Noli u jep shembuj shkrimtarëve të ardhshëm nga procesi i të krijuarit artistik dhe nga lindja e personalitetit krijues. "Këshilla më e mirë që mund t'u japë është kjo: të shkruani diçka mbi gjërat që keni përjetuar vetë. Madje, librat më të mirë, që janë shkruar ndonjëherë, janë pak a shumë

librat autobiografikë. Shembulli më i mirë është Servantesi, i cili kaloi tërë jetën duke shkruar sonete dhe drama, që nuk i lexon askush dhe sot qëndrojnë të varrosura nëpër bibliotekat spanjolle. Dhe pastaj, në moshën e tij të shtyrë, kur ishte në burg dhe s'dinte ç'të bënte, ai shkroi 'Don Kishotin' e u bë i famshëm brenda natës. Pasi e botoi një vëllim të gjerë për Don Kishotin, ai e përshkruan veten në të, sepse edhe ai udhëtoi, porsi Don Kishoti, në gjendje kundërshtore me idetë e tij. Publiku kërkonte një libër tjetër për të njëjtin njeri, për Don Kishotin, dhe ai shkroi vëllimin e dytë. Dhe, kritikët nuk mund të pajtohen mes tyre, se cili vëllim është më i mirë sesa tjetri. Që të dyja janë kryevepra të shkëlqyera", pohon Noli.

Një shembull tjetër i të shkruarit autobiografik për Fan Nolin ishte Shekspiri. Sipas tij, ky dramaturg i madh anglez pandehte se do të bëhej i famshëm duke shkruar sonete, të cilat sot nuk i lexon askush. Edhe ai u bë i famshëm me drama, prej të cilave nuk priste ndonjë lavd dhe domethënien e të cilave edhe sot e kësaj dite kritikët vështirë e shpjegojnë. Një kritik arti danez, thekson Noli, duke diskutuar biografinë e Shekspirit, bën këtë vërejtje: "Dëgjoj njerëz në të djathtë e në të mëngjër që ankohen se nuk dinë mjaft për jetën e Shekspirit. Unë, thjesht, nuk marr vesh ankesat e tyre. Shekspiri na dha aq shumë tragjedi dhe komedi dhe të gjithë heronjtë e tyre flasin për të".

Në poezinë evropiane, ai gjen pastaj përplot shembuj të vjershave autobiografike. "Vjershat më të bukura janë ato autobiografike", thotë Noli, duke marrë si shembull vjershat e poetit francez Feliks Arver, që në letërsinë franceze njihet me një vjershë që e shkroi për veten me titull: "Shpirti im ka fshehtësinë e vet", e cila është një përshkrim i dashurisë së tij të pafat. Edhe vjershat e poetit të madh amerikan, Edgar Alan Poe, Noli i quante vjersha "autobiografike", disa prej të cilave ai i shqipëroi dhe me njërën prej tyre, "Korbin", arriti kulmin e suksesit të tij, si përkthyes letrar. Ja, pra, kështilla e parë e Fan Nolit, për ata që duan të shkruajnë: shkruani - thotë - autobiografinë tuaj, por pa fshehur gjë, pranoni të gjitha mëkatet.

Diplomacia

Theofan Stilian Noli si diplomat anonte nga diplomacia e paqes dhe jo ajo e luftës. Siç thoshte, arsyeja duhet t'i udhëheqë raportet ndërmjet vendeve dhe

shteteve. Ky qëndrim mund të shpjegojë, deri diku, edhe disa nga veprimet konkrete të Nolit, gjatë karrierës së tij politike-diplomatike. Ai, që vetë mposhtte kundërshtarët, vetëm me penë e politikë, që ishte mishërim i demokracisë perëndimore në Ballkanin e sunduar nga regjime jodemokratike dhe që mbante leksione për demokracinë në sesionet e Lidhjes së Kombeve, natyrisht, nuk mund të ishte për "ideologjinë e jataganit", siç e quan ai diplomacinë e mbështetur në forcë dhe të drejtën e më të fortit. Në këtë aspekt, Fan Noli përkujtonte Konstantinin e Madh, të cilin e quante dishepull të madh të paqes. Këtë personalitet të krishterimit, për të cilin Noli thoshte se ishte shqiptar, e konsideronte si shembullin më të mirë të mësimit të tij dhe nga diplomacia e ardhshme shqiptare shpresonte: "Nëse nuk lindim më konstantinë të tjerë, atëherë atij duhet t'i japim ushtarë".

Fan Noli kishte mendimin dhe vizionin e tij ndaj zgjidhjes së çështjes shqiptare në po këtë aspekt dhe në ndërkombëtarizimin e çështjes si refleksion i afrimit dhe ndërthurjes së problemeve botërore.

Ai konsideronte se në marrëdhëniet ndërkombëtare kishte dy shkolla dhe dy kategori: ajo e "biçakçinjve" dhe ajo e "kalemxhinjve", ose, siç thoshte, "në njërën anë lufta e në tjetrën paqja". Sipas tij, nuk ka zgjidhje tjetër pos asaj të paqes, nga që "shkolla e biçakut" çon drejt luftës dhe shkatërrimit "dhe në një luftë të re nuk do të mbetej njeri i gjallë". Mjerimi më i madh për Nolin ishte lufta, të cilën duhet evituar, duke u udhëhequr nga parimi i "kalemit" dhe i paqes. Nga kjo pikënisje, fjalimet e Nolit në Lidhjen e Kombeve bënin jehonë të madhe, madje, ironikisht, mu para se bota të binte në një luftë të madhe shkatërruese. Predikimi i Nolit, pasqyrim i bindjeve të tij të krishtera, ishte një predikim kundër luftës dhe kundër përdorimit të forcës në skenën ndërkombëtare, një predikim ky, aq i nevojshëm për kohën e Nolit, sa aktual edhe sot.

Fan Noli dhe Faik Konica

Disa prej vjershave dhe prozave satirike më të njohura të letërsisë shqipe, të cilat i shkroi Fan Noli, kanë në thumb njërin prej intelektualëve më në zë të Rilindjes Kombëtare, aq të damkosur nga pesëdhjetë vjetët e shkuara, aq të sulmuar për shkak të disa veseve që i mvisheshin, me të drejtë e të padrejtë karakterit të tij, rreptësisë ndaj rivalëve të tij politikë, të përshkruar si mega-

loman, mendimeve të tij politike kundërshtore, por edhe aq të lavdëruar dhe të çmuar për njohuritë e thella intelektuale që kishte, erudicionin e thellë dhe kulturën e tij të gjerë, Faik Konicën. Për relacionet ndërmjet Fan Nolit dhe Faik Konicës, dy figurat kryesore të Rilindjes së vonë Kombëtare, të komunitetit shqiptar të Amerikës dhe të gjithë botës shqiptare të kohës, të cilët qenë bashkëpunëtorë të ngushtë, por shpesh edhe kundërshtarë politikë e polemizues, është shkruar shumë. Por, duke lënë mënjanë polemikat, që shënojnë vetëm një kapitull në marrëdhëniet e këtyre dy intelektualëve të mëdhenj, relacionet midis tyre kishin dimensione të shumëfishta, të përshkuara me një tolerancë dhe miqësi të vazhdueshme.

CD-Faiku dhe Noli

Për fund, kemi zgjedhur dhe një fragment tjetër të Nolit, që përshkruan një periudhë të rëndësishme dhe tejet të rëndë të shtetit shqiptar, me një qasje të lehtë dhe humoristike, derisa ishte kryeministër i Shqipërisë - një qasje, që, mbase, do t'i duhej edhe sot politikës shqiptare...

Mustafa Ferizi

Shfrytëzimi estetik i Miradije Ramiqit

Në ekspozitën e Miradije Ramiqit, piktura dhe poezia sikur janë "huhu" në kryengritje. Kurse, ajo me penë e me penel në dorë, mundohet t'i qetësojë dhe t'i pajtojë ndër vete, pikërisht ashtu siç tentoi t'i pajtojë poeti i lashtë Horaci, përmes parimit të tij estetik "ut pictura poesis".

Në këtë tentativë, Miradija krijon dyzimin e ideve poetike me ato plastike, pavarësisht se poezinë e ka pasion, kurse pikturën pasion dhe vokacion. Se piktura ka shumëçka të përbashkët me poezinë, por edhe me muzikën, provojnë edhe këto imazhet e pikturave në të cilat, njësoj si në "Boleron" e Ravelit, nuk dihet ku gjendet fillimi as mbarimi.

Aty diku në fillim të mbarimit, midis dhembjes dhe së bukurës, tenton piktorja jonë Miradije Ramiqi, të shënojë të paktën një ngjarje të jetës, të historisë sonë, ose një fragment sado të vogël, të peizazhit të saj shpirtëror. Cikli i pikturave "Arketipat ilire" është sprova e parë e Miradije Ramiqit, për sfidat e shumta që di t'i kurdisë piktura, njësoj si jeta. Erdhi pastaj një kohë e egër e llahtarshme, katandisëse, kur rruga me vija u shndërrua në rrugëtim tragjik, që shpinte vetëm në një drejtim: në drejtim të djegies së plotë e të qenies sonë, anekënd meridianëve të botës. Për këtë tragjikë flasin figurat që ngjasojnë silueta e fantazma, nga Lugina e Bllacës, a më mirë të thuhet nga Lugina e vdekjes, nga se në Bllacë, kurrgjë nuk ishte më afër dhe më reale se vdekja. Pasoi koha në të cilën zumë të frymojmë të lirë. Dhe, në këtë kohë autorja krijon cikli

"Shpirtëzimi fluid", që i përgjigjet plotësisht shpirtit të saj brufullues, që vazhdimisht lëvizë e rrjedhë, siç rrjedhin rrëke ngjyrat në tablotë e saj, të liruara krejtësisht nga pesha e materies, nga narracioni dhe plani tematik. Ky, pra, është shtegtimi kreativ i piktores/poetes Miradije Ramiqi, e cila artin e kupton si katarsë shpirtërore, kurse ngjyra e komunikon si Lasgushi me vargjet poetike me zjarr e përmes zjarrit.

Prof. Fatmir Krypa

Vizioni i qartë grafik

Valdete Vuçitërna radhitet ndër femrat e rralla në Kosovë, që merret me këtë veprimtari të artit pamor. E vetëdijshme për ndërlikueshmërinë që sjellin teknikat e grafikës në procesin teknik, ajo me këmbëngulësi, gjithnjë e më tepër, ndërton në vete një siguri për t'u ballafaquar me veprat artistike.

Pas mbarimit të studimeve pasuniversitare, ajo ndjehet më e vetëdijshme se grafika do të jetë pasion i saj jetësor, nga nuk do të ketë kthim pas. Gjithnjë e motivuar me krijimin e veprave të reja, që sjellin suksese të padiskutueshme nëpër ekspozitat në vendin dhe jashtë, ajo sot prezantohet me një ekspozitë, e cila pasqyron një opus me vokacione artistike. Grafika e Valdetes është e sajuar me një koncept të qartë që pasqyron realitetin e një etnosi kosovar me një imagjinatë kreative. "Medaljonet" dhe "Portretet" janë përkushtimi i saj më kompaktibil me realitetin individual. "Diptiku" dhe "Dialogu" shprehin vendosmëri për ta shfaqur personalitetin dhe për ta çuar përpara grafikën e saj drejt tendencave të reja, të cilat tashmë frymojnë në mbarë botën. Ajo mundohet dhe ia del, ka vullnet dhe njohuri për t'i bërë ballë sfidave të reja artistike, që e presin në të ardhmen. Nëse vështrohet me kujdes grafika e Valdete Vuçitërnës, ajo është e konceptuar me një teksturë shumë të pasur dhe ka një orientim individual. Aty nuk kemi gjëra të

rastit, çdo gjë është e ndërtuar me një qëllim të caktuar. Ajo e studion, çdo detaj, dhe e pasuron me forma specifike domethënëse. Kontrast, dritëhijet në grafikat e saj janë të preferuara, dukuri kjo që e përcjell tërë opusin grafik në këtë ekspozitë. Autorja, në mënyrë diskrete, futet në disa probleme dramatike, duke i shprehur edhe emocionet e veta ndaj botës së artit që kultivon. Padyshim se në këto shqetësime ka një besnikëri ndaj grafikës që e sublimon me ëndërrimet intime përmbajtjesore asociative.

Këto grafika, pothuajse të gjitha kanë një emërues të përbashkët, ato janë të realizuara në teknikën e akuatintës me ngjyrë. Përveç toneve me ngjyrë të zezë dhe të hirit, këto grafika i formëson edhe tekstura e nduarnduarshme e përcjell edhe me një bakërshkrim të lehtë. Ngjyrimi herë-herë zë vend dominues në grafikat e Valdete Vuçitërnës, por në disa raste, ai është vetëm një segment përcjellës në tërësinë kompozicionale të grafikës. Ngjyra e kaltër, kafe dhe okër, janë ato ngjyra që sensibilizojnë idenë artistike në grafikë.

Padyshim, gjurmët që lë në grafikën e saj, Valdete Vuçitërna do të jetë një shkas më tepër që ajo të thelloj sensibilitetin individual artistik në të ardhmen.

Bedri GASHI
Shef i Departamentit për Hulumtimin dhe Zhvillimin e Veprimtarisë Bibliotekare në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës

Bibliotekat e Kosovës në kontekstin e kohërave

Zanafilla dhe zhvillimi i bibliotekave zbret përherë në kureshtjen e kohëve moderne. Informacionet për to na vijnë të shkëputura dhe të shpërndara nëpër kohë. Që nga mijëvjeçarët e kaluar, bibliotekat kanë bartur fuqishëm kujtesën e shkruar të njerëzimit. Cili do të ishte njerëzimi i sotëm pa biblioteka? Kjo është e paimagjinueshme nga perspektiva e sotme. Dilemat, gjithnjë, përcjellin edhe artikulime kundërthënëse për pozicionime të tilla teorike. A do të dukej bota e shpifur në përmbajtje dhe e perceptuar jashtë koncepteve njerëzore? Duket enigmatike kjo e dhënë përfytyruese, por një gjë mund të thuhet se bibliotekat kanë qenë gjithnjë ushqyese të magjishme, matëse të peshave krijuese e zhvilluese në relacionet botërore. Bibliotekat, përherë, kanë qenë në shënjestër të regjimeve pushtuese dhe janë shkatërruar, e bashkë me to edhe vlerat e tyre. Këtë fat e kanë pësuar e bibliotekat e Kosovës dhe jo vetëm në këtë shekull.

Hyrje kronologjike

Në kuptimin etimologjik fjala bibliotekë vjen nga gjuha greke: biblion-libër, theke-arkë, raft, dollap. Biblioteka e parë është formuar në antikitet. Ajo ka qenë biblioteka e Asurbanipalit te sumerët e Babilonisë në Sirinë e sotme (668-626 para Krishtit), ndërsa biblioteka më e shquar ishte ajo e Aleksandrisë (288-247 para Krishtit). Ndërkaq, Franca ishte ndër vendet e para evropiane e botërore, e cila kishte fituar statusin e kombit. Ajo filloi t'i mbledhë botimet kombëtare në vitin 1537. Bibliotekat e tjera evropiane, me karakter kombëtar, janë formuar në shekullin XVIII. Në kontinentin amerikan biblioteka e parë (Biblioteka e Kongresit) është themeluar në vitin 1800.

Bibliotekat në Shqipëri datojnë nga shekulli IV p.e.r. Që atëherë njihen bibliotekat e Apolonisë dhe Durrësit (Dyrrahium) në shekullin I para Krishtit, si dhe biblioteka e Finiqit në shekullin II-III. Në mesjetë, bibliotekat e Shqipërisë vepronin në institucionet fetare, në të cilat ruheshin kodikë, dorëshkrime të rralla dhe vepra të klasikëve grekë e latinë. Bibliotekat e Gjirokastrës, e Filiatit dhe e Himarës përmenden në shekullin XIII-XVI, ndërsa në shekullin XVIII njihen bibliotekat e Voskopojës, e Korçës, e Vithkuqit dhe e Selasforit. Dhjetë vjet pas pavarësisë së Shqipërisë, më 1922, është themeluar Biblioteka Kombëtare e Tiranës. Në vitin 1985 Shqipëria numëronte rreth 4000 biblioteka të të pesë tipave kryesorë me një fond prej 12 milionë njësish bibliotekare.

Duke shfletuar burimet për themelimin e bibliotekave në botë, por edhe të atyre në Shqipëri, koha e shfaqjes së bibliotekave në Kosovë duket të jetë e vonë. Shënimet për themelimin, trashëgiminë e shkruar, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e bibliotekave në Kosovë janë të pakta. Për to duhet kërkuar dhe hulumtuar edhe më tej, në mënyrë që të verifikohen drejt dëshmitë dhe faktet për to.

Si fakte të dokumentuara, mund të merren të dhënat për fillimet e para të krijimit të bibliotekave në Kosovë - shekulli XVI. Atëbotë bibliotekat janë njësuar me individë (bibliotekat familjare) dhe me institucione fetare (bibliotekat fetare). Këto biblioteka kryenin misionin e tipit publik. Themeluesit e tyre do t'i quaja misionarë të vetmuar dhe të pasionuar pas teksteve, dorëshkrimeve dhe librave, në shekujt e sundimeve osmane dhe sllave. Ky përfundim përforcohet edhe më shumë duke u bazuar në rrethanat e zhvillimit historik të Kosovës, që nga shekulli XV e këndej.

Burimet e hershme flasin për ekzistimin e bibliotekave në Kosovë si "Vakufname" e Suzi Qelebiut, në vitin 1513, i cili në një dokument shkruan: *"...Pas vdekjes sime, këto libra i mbikëqyr imami i xhamisë dhe ai do t'ua japë të interesuarve, qofshin ata nxënës apo qytetarë, me evidencë, duke u kujdesur që të mos humbin dhe mos të dëmtohen..."*. Sipas shënimeve, fondi i Qelebiut ishte medresian, por kishte edhe tituj nga fusha e mistikës, filozofisë etj. Edhe autori i njohur i letërsisë së vjetër shqipe, Pjetër Bogdani, e më vonë edhe Pjetër Mazrreku, Shtjefën Gjeçovi e shumë të tjerë, përhapën librin shqip në viset e Kosovës.

Origjina e bibliotekave në Kosovë duhet të jetë vazhdimësi e një tradite të mëhershme sesa shekulli XVI, që evidentohet në dëshmitë e gjetura. Ky mendim mund të përforcohet me zhvillimin e hershëm të bibliotekave në Shqipëri. Kosova shpesh është administruar, shkëputur trungut etnik, por ndikimet dhe traditat kombëtare janë bartur dhe janë kultivuar në mënyrë unike. Sido që të jetë, veprimtaria e mirëfilltë e bibliotekave tona nis në gjysmën e dytë të shekullit XX. Hapjes së bibliotekave u kanë paraprirë rrethanat arsimore, si dhe kushtëzimet e faktorëve administrativë e politikë. Bibliotekat si institucione të tipit publik janë themeluar në vitet '40. Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës është themeluar në vitin 1944, në Prizren. Tipat i bibliotekave familjare e publike janë shkatërruar masivisht, sidomos, në dy shekujt e fundit.

Shënimet periodike e monografike flasin për shkatërrimin e mijëra bibliotekave private e publike ndërmjet viteve 1878-1914, 1914-1945 dhe 1990-1999. Në shtypin periodik të kohës gjejmë edhe këtë të dhënë: *"Kështu, sipas të dhënave arkivore e historike nga viti 1878 deri më 1914, në trojet shqiptare nga pushtuesit janë shkatërruar rreth 8 450 biblioteka private, të cilat përmbanin fonde tejet të pasura me vlera kombëtare, historike, kulturore, fetare etj"* .

Bibliotekat e Kosovës filluan të mëkëmben përkohësisht pas Luftës së Dytë Botërore, por janë detyruar dhunshëm ta ndërpresin veprimtarinë nga regjimi serb në fillim të viteve '90. Kjo ka zgjatur rreth 10 vjet, pra deri më 1999. Në vitin 1990 fillon një kapitull i rëndë për kulturën dhe segmentet e tjera të jetës në Kosovë. Ky kapitull i dhunshëm do të zhbëhet me dëbimin e regjimit serb nga Kosova më 1999, me ç'rast rinisë një etapë tjetër i zhvillimit të sistemit kombëtar të bibliotekave në Kosovë.

Tri etapa veprimtarie

Si pasojë e pushtimit klasik të Kosovës, institucionet bibliotekare nuk kanë trashëguar vazhdimësi të natyrshme menaxhimi. Zënia e hapit në përputhje me parimet e demokracisë dhe të lirive njerëzore ka munguar dhe në plotësi asnjëherë nuk kemi gëzuar të drejtën e qeverisjes së plotë të rrjetit bibliotekar. Mungesa e vetadministrimit të bibliotekave reflekton edhe në ditët e sotme dhe se kjo zbrazësi e përgjithshme kërkon kohë, kuadro dhe mjete për t'u sanuar në disa faza kohore. E kaluara ka krijuar përmasa negative të zhvillimit, ndërsa e ardhmja shënon përmasat e shpresave pozitive.

Metodat antidemokratike dhe antiprofesionale që kanë mbizotëruar, ndër vite, në institucionet bibliotekare janë metodat destruktive të pasurimit të fondeve, pa respektuar tipin e bibliotekës; përzgjedhja e kuadrove të paduhura dhe mohimi i mundësisë së përcjelljes dhe qasjes së komuniteteve në komunikim e në edukim, segregacioni etnik etj. Përmasat e zhvillimit kohor të bibliotekave kosovare krijojnë faqe të tëra kundërthënieje. Ato, kryesisht, mund të klasifikohen në dy dimensione përpjekjesh: dimensioni i organizuar institucional i regjimit serb për shkatërrimin e bibliotekave dhe dimensioni i sotëm mëkëmbës për bibliotekat. Këto përmasa janë të pabarabarta, sepse e para ka qenë vetëmbrojtëse për shqiptarët, ndërsa e dyta mund të krijojë hapësirë të gjerë të strukturimit pozitiv.

Për dimensionin e organizuar institucional të regjimit serb për shkatërrimin e bibliotekave kemi ç'të themi mjaft, sepse fati i bibliotekave dhe i institucioneve të tjera kulturore në Kosovë, në esencë, ishte determinuar nga doktrinat e gabuara akademike të regjimit serb, duke mohuar ngulitjen, kulturën, trashëgiminë dhe etninë e tjetrit.

Duke mos i copëzuar etapat e zhvillimit në nënnjësi a nënetapa, mund të themi se veprimtaria bibliotekare në Kosovë ka kaluar nëpër tri shtrirje kohore të ndryshme: etapa e diskriminimit të koleksioneve të Albanikës (1944-1989), etapa e shkatërrimit të bibliotekave (1990-1999) dhe etapa e përpjekjeve për mëkëmbjen e bibliotekave (1999-2005).

Etapa e diskriminimit të koleksioneve të Albanikës (1944-1989)

Kjo etapë fillon pas Luftës së Dytë Botërore dhe përmbyllet më 1989, vit ky kur edhe u përmbys pozita kushtetuese e Kosovës nga regjimi i

Millosheviqit. Në këtë etapë manifestohen përpjekjet për ndërtimin e një rrjeti modest të bibliotekave publike në Kosovë nën tensionet e mëdha etnike në ish-Jugosllavi. Edhe në këtë shtrirje kohore ishin evidente shumë fakte që i kanë dëmtuar bibliotekat tona. Këtu do të veçoja pengesat e mëdha për sigurimin e ekzemplarit kombëtar nga fusha e Albanikës, e cila përfshin botimet serike, monografike dhe materiale të tjera, të shtypura dhe audiovizuale, që merren me studimin e historisë së shqiptarëve, kulturës, gjuhës shqipe, letërsisë, pra, përgjithësisht, tërësisë së studimeve për shqiptarët nga të huajt dhe nga shqiptarët, si dhe zhvillimin e politikës anatemuese për literaturën shqipe. Dëmtimi më i rëndë në pasurimin me botimet e kësaj fushe është bërë ndërmjet viteve 1970-1989, gjithnjë duke u bazuar në kuotën e pasurimit të bibliotekave kombëtare dhe publike, sepse Kosova ka pasur një produksion shumë të vogël prej 0.10 % për krye të banorit. Sipas llogaritjeve, nga 0.90 %, që do të formonte kuotën minimale prej 1 libri për krye të banorit, fondet bibliotekare janë dëmtuar për 1 260 000 njësi bibliotekare nga moshyrja e produksionit të përgjithshëm kombëtar e botëror. Produksioni vendës nënkupton depoziturën ligjore, ndërsa ai botëror dhuratën dhe këmbimin. Ndërsa me fjalën "produksion kombëtar" nënkuptohet hyrja e botimeve në gjuhën shqipe edhe përtej kufijve të Kosovës. Vëllimi i botimeve kombëtare dhe ndërkombëtare mund ta tejkalojë këtë shifër nëse marrin mesataren evropiane të pasurimit prej 1.5 - 2.5 libra për kokë të banorit.

Etapa e shkatërrimit të bibliotekave (1990-1999)

Në këtë etapë, si mjet mbrojtjeje kishte mbetur vetëm sensibilizimi i opinionit ndërkombëtar për shpëtimin dhe ruajtjen i koleksioneve dhe bibliotekave nga gjenocidi kulturor i regjimi serb. Megjithëkëtë, bibliotekat e Kosovës përjetuan kohë të pafuqishme të organizimit të mbrojtjes së fondeve dhe veprimtarisë bibliotekare. Kjo decenie shënon shkatërrimet finale të bibliotekave publike, speciale, shkollore dhe familjare. Duhet përmendur se dëmet në bibliotekat publike të Kosovës të shkaktuara nga ish-regjimi serb, cilësojnë edhe një të dhënë fundamentale - mosrespektimin total të konventave ndërkombëtare, në të cilat definohet qartë ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore botërore.

Në vjeshtën e vitit 1990 e tutje, në mënyrë sistematike kishte filluar shkatërrimi i rrjetit bibliotekar në Kosovë, përfshirë edhe bibliotekat publike dhe degët e tyre. Për shkak të këtyre masave të mëdha represive të regjimit serb, që ishin të njohura edhe ndërkombëtarisht, sistemi bibliotekar ishte çorientuar pothuajse 10 vjet, ndërsa veprimtarinë konkrete e kanë përcjellë faktorë të ndryshëm shkatërrues. Bibliotekat e Kosovës janë mbyllur intensivisht nga regjimi serb, sidomos, gjatë viteve 1990-1995. Fonde të tëra janë zhdukur nga raftet e këtyre bibliotekave. Statistikat janë tmerruese: më 1990 bibliotekat publike kishin të depozituara 1 927 000 njësi bibliotekare, më 1992 - 1 859 000, ndërsa më 1999 - 1 116 560.

Një vijë rënieje të vazhdueshme kanë pësuar edhe bibliotekat shkollore, të cilat më 1989 numëronin 328, më 1992 -146, më 1995 - 144 sosh. Për gjashtë vjet janë mbyllur 184 biblioteka shkollore. Vetëm deri më 1995 janë mbyllur 301 biblioteka publike dhe shkollore.

Dëmtimi në pasurim (etapa e parë): 1 260 000 njësi bibliotekare, zhdukja e 100 000 vëllimeve më 1991 nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe 810 440 njësi të djegura nga ushtria dhe policia serbe në bibliotekat publike (etapa e dytë), pra gjithsej mungojnë 2 170 440 njësi bibliotekare. Dëmi i shkaktuar vetëm në koleksione sipas llogaritjeve të mësipërme është: 15 193 080 €.

Etapa e përpjekjeve për mëkëmbjen e bibliotekave (1999-2005)

Në varësi të rregullimeve politike, bibliotekat e Kosovës gjatë historisë së tyre kanë ndërruar dy herë infrastrukturën ligjore. Rregullimi i parë shënon Ligji për Bibliotekat e Kosovës (KK nr. 630-2/77 - 28 prill 1978), ndërsa rregullimi i dytë ligjor vjen me ndërrimin e sistemit politik në Kosovë, pas çlirimit të Kosovës nga Serbia, në vitin e fundit të shekullit XX-(Ligji për Bibliotekat e Kosovës nr. 2003/6). Pra, katër vjet pas çlirimit të Kosovës (1999) dhe 25 vjet pas miratimit të ligjit të parë për biblioteka (1978), është miratuar Ligji i ri për Bibliotekat e Kosovës (4 prill 2003), i cili edhe pse lë vend për t'u diskutuar, megjithatë, rregullon infrastrukturën ligjore të rrjetit bibliotekar. Në bazë të këtij ligji, rrjeti i bibliotekave të Kosovës funksionon në krye me institucionin qendror bibliotekar - Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Atë e përbëjnë: Biblioteka Kombëtare dhe

Universitare, bibliotekat ndërkomunale, komunale, universitare, speciale dhe shkollore.

Statistikat e fundit tregojnë se Kosova numëron 498 biblioteka duke filluar nga tipi kombëtar, universitar, publik, special e deri te ai shkollor. Ky numër i bibliotekave duket mjaft voluminoz, por si përbërje profesionale nuk funksionon as në masën 30 %. Fondet e përgjithshme të këtyre bibliotekave përbëhen nga 1 396 121 tituj dhe 3 465 372 njësi bibliotekare, ndërsa në to punojnë 352 punonjës. Sipas rritjes demografike, kuota e librit duket kështu: 1.92 njësi bibliotekare dhe 0.77 tituj për një banor. Krahasuar me dy etapat e para, pas çlirimit Kosova ka shënuar përparime dhe brenda pak vitesh synon edhe kuotën evropiane të pasurimit të fondeve.

Megjithatë, hedhja e hapave konkretë të faktorëve përgjegjës për zhvillimin e bibliotekave moderne lë për të dëshiruar në pjesën e parë të etapë së fundit. Përveç pasojave të trashëguara nga periudhat pararendëse, edhe një sërë faktorësh të tjerë ndikuan në mosndryshimin e shpejtë të pamjes teknike dhe përbërjes profesionale të bibliotekave tona në periudhën e tretë. Këtu hyjnë: paqartësitë e projektimit real të së ardhmes së rrjetit bibliotekar; stërmadhimi i shifrave financiare për donatorët ndërkombëtarë, që do të investonin për mëkëmbjen fizike e profesionale të bibliotekave të Kosovës; refuzimi i reformave e i ndryshimeve të shpejta në biblioteka; përtëritja e udhëheqjeve moniste në biblioteka; kuadri i vjetruar dhe kapaciteti i pamjaftueshëm i kuadrove aktuale për të bartur barrën e ndryshimit modern të bibliotekave për shkak të shkëputjes së gjatë nga proceset e veprimtarisë së bibliotekave.

Si pasojë e mungesës së revizioneve të domosdoshme, që do të pasqyronin gjendjen reale në bibliotekat e Kosovës, tashmë variojnë shifra të llojllojshme joinstitucionale, duke krijuar konfuzion statistikor. Sipas Ligjit për Bibliotekat e Kosovës, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës është mbikëqyrëse e rrjetit të bibliotekave. Në këtë kuadër vepron Departamenti për Hulumtimin dhe për Zhvillimin e Veprimtarisë Bibliotekare, që mbikëqyrë gjendjen profesionale të rrjetit bibliotekar në Kosovë. Ky departament ka të dhënat më të sakta për zhvillimet retrospektive dhe vijuese të bibliotekave në Kosovë. Mund të thuhet se etapa e tretë shënon edhe dy elemente të pakëndshme: nivelin e pakënaqshëm të përfaqësimit të bibliotekave në arenën ndërkombëtare dhe në vend, si dhe shprehjen e diletantizmit profesional e menaxhues në bibliotekat e Kosovës

Vitet 2003-2005 shënojnë fillimin e përpjekjeve kapitale për reformimin e kapaciteteve bibliotekare, pasurimin e fondeve, automatizimin e të dhënave bibliografike dhe jobibliografike, botimin e literaturës profesionale, shënimin tradicional të Javës së Bibliotekës në Kosovë, realizimin e shumë projekteve teknike, ndërsa bartëse qendrore e proceseve profesionale mbetet Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës.

Përfundim

Në përgjithësi bibliotekat kosovare zhvilluan veprimtari të varur nga politika, u përcollën me publikime të kufizuara kërkimore, krijuan koleksione në përputhje me politikën diskriminuese të regjimit serb dhe mënjanuan fonde të domosdoshme (mjafton të kujtojmë togfjalëshin "fondi i mbyllur"), si dhe pësuan dëmtime, shkatërrime dhe djegie marramendëse të fondeve dhe lokaleve të bibliotekave.

Një gjë që vërehet qartazi gjatë shfletimit të dokumentacionit, vjetarëve statistikorë, raporteve të punës, letrave komunikuese në nivele institucionale, botimeve serike dhe monografike për biblioteka, është përjashtimi i shumicës shqiptare nga proceset vendimmarrëse ose pengimi i atyre proceseve për modernizimin e bibliotekave në Kosovë. Po ashtu, komunikimi delikat dhe veprimtarija informative-botuese është mbështjellë nga privilegjet sunduese të pakicës serbe në Kosovë. Nën trysninë e këtyre elementeve diskriminuese janë anashkaluar përparimet, lëvizjet pozitive dhe ndryshimet vijuese të bibliotekave.

Në vijimësi mbizotëron një kontrast i madh e i paqëndrueshëm, i cili nuk është adekuat për krahasim të raporteve të dikurshme dhe të raporteve të sotme për biblioteka. Nuk është çudi, pse pushtuesit i kanë vënë në rend të parë për shkatërrim bibliotekat dhe përgjithësisht institucionet kulturore, por është çudi sesi vetëdija e sotme institucionale i vë ato në vijën e fundit të kujdesit të saj.

Me këtë do të përmblidheshin edhe synimet tona për të ardhmen, të cilat do të ndihmonin në zhvillimin e demokracisë, modernizimin e bibliotekave dhe ruajtjen e trashëgimisë së shkruar të të gjitha etnive në Kosovë, duke filluar nga koordinimi profesional e teknik i rrjetit tonë bibliotekar, trajtimi i prioriteteve e deri te konkretizimi i tyre në përmasa të gjera.

Pra, ky këndvështrim retrospektiv e aktual flet mjaft se kah duhet të shkojë përmbledhja e caqeve të domosdoshme të veprimtarisë sonë bibliotekare, për krijimin e bibliotekave moderne, që do t'i përmbushin nevojat e përdoruesve kosovarë dhe do të hynin në mesin e familjes së madhe të bibliotekave amerikane e evropiane.

Literatura:

1. Ligji për Bibliotekat e Kosovës, KK Nr. 630-2/77 28 prill 1978;
2. Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës: monografi, Prishtinë, 1984;
3. Akademia e Shkencave e RPSSH: Fjalor enciklopedik shqiptar, Tiranë, 1985;
4. Gazeta ditore Bujku, 24 mars 1998;
5. Libraries in Kosova/Kosovo, IFLA/FAIFE Report No.I, 2000, by Carsten Frederiksen and Frode Baken, Copenhagen;
6. Misioni i Bibliotekës së Kosovës: raporti i IFLA/FAIFE-së, prill 2000: Aneks 3 - raport nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës;
7. Fjalor enciklopedik, Tiranë 2002;
8. Ligjin për Bibliotekat e Kosovës nr.2003/6;
9.Java e Bibliotekës në Kosovë: 7-13 prill 2003, Prishtinë, 2004;
10. Monografi: Biblioteka Ndërkomunale e Prizrenit, Prizren, 2004;
11. Vjetar statistikor për vitin 2004, DHZHVB, 2005.
12. Arkiva e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

(Kumtesë e paraqitur në tryezën me bibliotekarë: "Gjendja e bibliotekave publike në Kosovë 1990-2005", të mbajtur më 16 prill 2005 në Prizren)



Besim Kokollari
Kryetar i Shoqatës së Bibliotekarëve të Kosovës

Fazat e integrimit të bibliotekave publike në rrjetin e automatizuar bibliotekar

Sot do të flas, në mënyrë të përgjithësuar për disa faza, nëpër të cilat duhet të kalojë një bibliotekë publike, në rrugën e saj drejt automatizimit. Këto faza nuk kanë asnjëherë një kufi të qartë ndarës, por ky kufi do të jetë gjithmonë në njëfarë mase i turbulltë dhe faza me fazën shpesh do të ndeshen ndër vete. Kjo, që do të them këtu, është pak a shumë një këshillë, e cila nuk është e definuar dhe e prerë, por mbështetet në përvojën, në vështirësitë dhe në problemet, nëpër të cilat po kalon Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, në përpjekje drejt automatizimit të shërbimeve të saj. Por, pavarësisht prej asaj që do të them në vijim, asnjëherë nuk duhet harruar se secila bibliotekë publike, por edhe të tjerat, medoemos, i kanë specifikat e veta buxhetore, kushtet dhe rrethanat, në të cilat vepron, mjedisin në të cilin gjendet etj. Kësaj ia shtojmë, po ashtu edhe mundësitë dhe lehtësimin që siguron për to Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës në aspektin e programeve të aftësimit, përkthimit të dokumentacioneve, marrëdhënieve, tash-

më veç të vëna me kompaninë Ex Libris etj.
Hapi i parë në këtë drejtim është përpilimi i një plani, i cili do të udhëhiqte bibliotekën tuaj drejt fazave të mëtejme, mundësive buxhetore dhe mënyrave të zbatimit të sistemit të automatizuar. Plani duhet të jetë i qartë, i hollësishëm dhe me informacione të bollshme. Ky plan nuk duhet që të përpilohet në tërësi nga ndonjë palë tjetër e tretë, pa përfshirjen e bibliotekës suaj, edhe nëse do të ekzistonte një ofertë e tillë. Biblioteka juaj duhet të jetë gjithsesi e përfshirë në përpilimin e të ardhmes së vetë. Po ashtu, është shumë me rëndësi që ky plan të përpilohet nga një grup i caktuar, të cilit biblioteka ia lë përgjegjësi të merret me këtë projekt të rëndësishëm. Një gjë që duhet të kihet parasysh, është edhe mendimi dhe parimi me të cilin duhet të udhëhiqet ky grup - atë të transparencës dhe të shtjellimit të paqartësive brenda bibliotekës së tyre përmes kërkimit të ndihmës.
Plani, po ashtu, duhet t'i parashohë kërkesat dhe dëshirat e bibliotekës suaj në raport me kompaninë Ex Libris. Është shumë me rëndësi që kompania shitëse të dijë, sa më shumë për bibliotekën tuaj, si dhe për atë se çfarë synoni të bëni me sistemin e automatizuar. Kjo do t'i ndihmojë ata në konfigurimin e programit kompjuterik, ALEPH 500, në mënyrë që ai t'i përshtatet dhe t'i përmbushë sa më mirë nevojat e bibliotekës suaj, për arsye se secila bibliotekë karakterizohet me shërbime, programe dhe iniciativa të ndryshme, të cilat mendon t'i realizojë, por në mënyra të ndryshme.
Ju e dini se Biblioteka Kombëtare dhe Universitare, tashmë është në implementim e sipër të sistemit të automatizuar ALEPH 500, prodhim i kompanisë Ex Libris. Dhe duke qenë i përfshirë në këtë program drejtpërsëdrejti do t'ju këshilloja që pa e parë se si do të shkojë ky proces në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare, të mos nguteni për të marrë ndonjë hap të shpejtë, ndonjë vendim të ngutshëm, duke përjashtuar këtu parapërgatitjet për një gjë të tillë, si dhe të qenit aktiv në kapjen e informacioneve të asaj që po ndodh në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.
Disa nga parapërgatitjet e një biblioteke entuziaste për të hyrë sa më shpejt në këtë sistem do të ishin: aftësimi i personelit të saj në lëmin e gjuhës angleze dhe në atë të kompjuterit. Përgatitja e bibliotekës në aspektin teknik është e pazëvendësueshme, pa të cilin as që mund të bëhet fjalë. Kjo do të shpiente pastaj në një fazë tjetër të planit tuaj për automatizim, atë të aftësimit të suksesshëm të personelit tuaj në programin e Bibliotekës Kombëtare dhe

Universitare, si nga ana praktike dhe nga ajo teorike. Dhe këtu dalim në atë që thashë në fillim se pse kufiri midis fazave nuk do të jetë i ndarë qartë, por në një masë i turbulltë. Arsyeja pse e them këtë qëndron në atë se gjatë trajnimit, me njohjen më të hollësishme të sistemit, me kuptimin e ecurisë së punës në mënyrë praktike, ide të reja do të vijnë dhe mund të intervenohet në shumë pika në planin e përpiluar më parë. Këtu më duhet të cek, se plani, në asnjë mënyrë, nuk duhet të jetë i ngurtësuar, por në asnjë mënyrë edhe i pabazuar. Fjala vjen, të jetë bërë vetëm për hatër, që të kihet një plan përpara. Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës do të jetë më se e kënaqur që ta përcjellë dijen e saj, në këtë fushë, te të tjerët, por jo edhe para se ajo vetë ta përvetësojë atë. Edhe si Bibliotekë Kombëtare dhe Universitare e Kosovës edhe si kryetar i Shoqatës, do të isha shumë i palumtur që problemet e dijes me të cilat përballemi ne, tash, në këtë fazë të implementimit, të barteshin edhe në bibliotekat e tjera. Kjo nuk duhet të ndodhë. Kjo nuk guxon të ndodhë.
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës do të kujdeset për këtë çështje, pasi edhe ligji e detyron dhe e ndjen për përgjegjësi. Shoqata e Bibliotekarëve të Kosovës do të kujdeset për këtë plan, pasi që e ndjen për detyrë të ndihmojë në të gjitha aspektet e mundshme.
Pikë tjetër me rëndësi, gjatë hartimit dhe ndryshimit të planit, është se duhet të ketë transparencë. Po ashtu, edhe në marrjen e vendimeve për bibliotekën tuaj duhet të ketë transparencë dhe përgjegjësi. Secili nga punonjësit tuaj dëshiron dhe duhet të dijë se çfarë po ndodh me bibliotekën e tij. Dihet se do të ndodhë një transformim me rastin e zbatimit të një sistemi të automatizuar, ndërsa sa më transparente dhe më e hapur që të jetë biblioteka në dhënien e informacioneve, aq më i lehtë do të jetë kalimi prej një faze në tjetrën. Te punëtorët nuk guxon të mbretërojë mjegullia se çfarë do të ndodhë më tej.
Dua t'i them edhe disa fjalë, sa i përket asaj se a do të ketë kundërshtim nga ana e bibliotekarëve për zbatimin e sistemit të ri. Mendoj se po. Madje, në disa pika, sa i përket transformimit të plotë, që pësojnë disa prej shërbimeve bibliotekare. Mirëpo, nga të gjitha kontaktet që kam pasur me bibliotekarë amerikanë e evropianë, asnjëherë nuk kam hasur në ndonjërin, i cili ka dalë i zhgënjyer nga automatizimi i shërbimeve të tyre. Këta bibliotekarë, me të cilët kam kontaktuar, kanë përjetuar fazën e kalimit prej kryerjes së shërbimeve bibliotekare me dorë në atë kompjuterike.

Bibliotekave të Kosovës, në këtë fazë të dëshirës së zbatimit të sistemit të automatizuar u nevojitet, më shumë se kurrë, një koordinim i mirë, i sinqertë, i mirëfilltë, i frytshëm e kuptimplotë ndërmjet Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe Ministrisë së Kulturës. Andaj, nga pozita e kryetarit të Shoqatës, më lejoni që të bëjë thirrje, që ky bashkëpunim të vihet në binarë. Koordinim, duhet të ketë, edhe ndërmjet bibliotekave publike dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, sepse kjo nuk guxon të lihet fare në harresë.

Në fund, desha t'i them nja dy fjalë edhe për Shoqatën. Dhe, dua të përmend, se kam pasur disa korrespodenca me personelin e IFLA-s, ku kam mësuar se Shoqata jonë nuk mund të anëtarësohet si Shoqatat e tjera të rajonit, shtetet e të cilave janë të pavarura. Por, ekziston një mënyrë tjetër e anëtarësimit në këtë organizatë, e cila do t'ia lehtësojë Shoqatës sonë regjistrimin në dy sesione profesionale falas, ndërsa për çdo anëtarësim në sesione të tjera kërkohen një shumë simbolike prej 48 eurosh. Me këtë, nuk them se ne do të heqim dorë nga përpjekjet tona që të regjistrohemi, si anëtarë, me të drejta të plota. Sa i përket anëtarësisë, jam i lumtur që disa biblioteka kanë filluar ta bëjnë mbledhjen e tyre dhe shpresoj se kjo do të jetë e suksesshme. Paraja juaj do të thotë përgjegjësi për ne. Krejt në fund, në emër të Shoqatës, do ta kisha falënderuar drejtorin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare, prof. dr. Sali Bashotën, për gatishmërinë që ka treguar në mbështetjen financiare për botimin e revistës "Biblioteka 2". Besoj se do të hasim në mirëkuptim edhe me Ministrinë e Kulturës, si dhe me institucione të tjera kulturore në Kosovë.

(Kumtesë e paraqitur në tryezën me bibliotekarë: "Gjendja e bibliotekave publike në Kosovë 1990-2005", të mbajtur më 16 prill 2005 në Prizren)

Sahadete SADIKAJ
Drejtoreshë e Bibliotekës Ndërkomunale të Prizrenit

Gjendja e bibliotekave në rajonin e Prizrenit 1990 -2005

Kur flasim për këtë periudhë kohore, edhe pa dashje, mund të preket aspekti politik, sepse të gjitha ngjarjet dhe zhvillimet e institucioneve janë kushtëzuar nga ky aspekt. Për bibliotekat në rajonin e Prizrenit mund të flasim si për institucione mjaft të hershme dhe të shumta, pasi që dihet se ato datojnë që nga 1513 e tutje, duke shkuar në faza të ndryshme të zhvillimit dhe përhapjes së librit. Mirëpo, një gjë të tillë nuk mund ta themi edhe për periudhën kohore për të cilën edhe flitet, sepse dihet së kjo ishte një periudhë shumë e rëndë për Kosovën. Pra, edhe për institucionet e saj.

Në vitin 1990 rajoni i Prizrenit kishte këto biblioteka: Bibliotekën në Prizren dhe degët në fshatrat: Sreckë, Zhur, Lubizhdë, Mamushë, Piranë, Velezhë dhe Zym; Bibliotekën Komunale në Malishevë, me degët në Kijevë, në Bajë, në Lubizhdë dhe në Bellanicë; Bibliotekën Komunale në Sharr me degët në Bresanë, në Breznë, në Brod, në Bellobradë dhe në Krushevë, si dhe Bibliotekën Komunale në Therandë me degët në Nishor, në Mohlan, në Bllacë, në Mushtisht, në Reshtan, në Samadraxhë, në Studençan dhe në Bukosh.

Tabela 1. Vendet ku kanë funksionuar bibliotekat, numri i koleksioneve, numri lexuesve, dhe numri i librave të lexuara

Viti	Biblioteka	Nr. i librave	Nr. i lexuesve	Nr. i librave të lexuara
1990	Prizren	58979	2529	32913
	Sreckë	4625	60	1020
	Zym	6146		
	Zhur	7723	100	4600
	Lubizhdë	3335	55	526
	Velezhë	5668	49	632
	Piranë	3616	40	135
	Mamushë	3997	9	160
1991	Prizren	60207	2086	22915
	Sreckë			
	Zym			
	Velezhë			
	Piranë			
	Mamushë			
	Zhur	7723	200	4818
	Lubizhdë	3335	18	118
1992	Prizren	54549	1440	11538
	Sreckë	4656	75	1275
	Lubizhdë	3335	260	981
1993	Prizren	54925	2302	23952
	Lubizhdë	3335	87	924
	Sreckë	4656	60	916
1994	Prizren	55323	1445	17475
1995	Prizren	53324	1672	17325
1996	Prizren	53822	1493	16771
1997	Prizren	55082	1523	19248
1998	Prizren	54462	1118	17232
1999	Prizren	s`ka të dhëna	1057	
2000	Prizren	63591	1414	15383
	Zym	5600	90	963
2001	Prizren	64010	2494	26909
	Zym	5600	185	2016
2002	Prizren	64382	2417	27276
	Zym	5600	65	830
2003	Prizren	68838	3298	29447
	Zym	6206	108	1758
	Libërbusi (19 fsh.)	4030	585	3988
2004	Prizren	75424	3516	36552
	Zym	5890	103	1863
	Libërbusi (21 fsh.)	5015	793	5913
	Gjonaj	6100	589	5596

Ndërkaq, në vitin 2005 priten të hapen edhe bibliotekat në Mamushë, në Velezhë, në Lubizhdë dhe në Korishë.

Më 19.06.1999 punëtorët janë kthyer dhe kanë filluar rregullimin e Bibliotekës në Prizren, me ç'rast bëhet sistemimi i librave, ndërsa grupit të punëtoreve të bibliotekës sonë iu bashkëngjit edhe punëtori i bibliotekës së Zhurit, i cili me vite të tëra kishte qenë i dëbuar nga biblioteka-degë. Nga biblioteka e fshatit Zhur, pas dëmtimit të objektit dhe vjedhjes së shumë librave, punonjësi i kësaj biblioteke kalon me punë në Bibliotekën e Prizrenit, duke marrë me vete dhe një pjesë të inventarit.

Gjatë vitit 2000 fillon punën edhe biblioteka në Zym, ku fillimisht punëtori paguhet nga Biblioteka e Prizrenit, pastaj kalon në kuadër të Drejtorisë së Kulturës. Numri i librave të kësaj biblioteke është 5 890.

Në vitin 2002, si donacion i Fondacionit për Shoqëri të Hapur dhurohet Libërbusi për rajonin e Prizreni. Ky Libërbus apo Infobus, punën në terren e filloi më 01.02.2003 pas një trajnimi të punëtorëve në Slloveni. Në vitin e parë në agjendën e tij të frekuentimit kishte 19 fshatra, ndërsa në vitin 2004 përfshiu 21 fshatra të komuniteteve të ndryshme.

Më 2004 rihapet biblioteka në Gjonaj, ku për një kohë kishte funksionuar si bibliotekë shkollore, ndërsa me rregullimin e shtëpisë së kulturës, është ndarë një hapësirë adekuatë për punë, kështu që edhe kjo bibliotekë tani funksionon si bibliotekë e fshatit, me një numër prej 6 100 librash.

Për vitin 2005 është e paraparë rihapja e bibliotekave në Mamushë (ku ekziston vendi shumë i përshtatshëm, po ashtu edhe numri i librave është i mjaftueshëm

falë donacioneve dhe një dhurate nga biblioteka e jonë, por ndjehet vetëm mungesa e punëtorit), biblioteka në Lubizhdë (objektit i duhet një renovim, librat janë të mjaftueshme për hapjen e saj, edhe këtu mungon punëtori), biblioteka në Velezhë (po ashtu edhe këtu kemi shfaqjen e problematikës së njëjtë - mungesën e punëtorit pasi që librat edhe hapësira janë të mjaftueshme). Pra, që të tri këto biblioteka, do të mund të aftësoheshin në momentin e pranimit të punëtorëve në punë. Edhe biblioteka në Korishë kërkon të aktivizohet si bibliotekë e fshatit. Kjo bibliotekë, ka filluar punën vitin e kaluar si biblioteka shkollore.

Gjendja e sotme në Bibliotekën Ndërkomunale të Prizrenit

Tash për tash, kjo bibliotekë funksionon në lokalet e Shtëpisë së Kulturës me një hapësirë prej 234 metrash katrorë, me kërkesë të vazhdueshme që të gjendet një zgjidhje më adekuate. Nga Kuvendi Komunal është ndarë lokacioni shumë i përshtatshëm, mirëpo për shkak të mungesës së donacioneve nuk është gjetur ende ndonjë zgjidhje. Me vendimin e Ministrisë së Kulturës nr.19/2002, kjo bibliotekë ka ndërruar statusin dhe është bërë institucion i pavarur nga Shtëpia e Kulturës, edhe pse vazhdoi të punonte deri në prill të 2003 me të njëjtën formë. Tash kjo bibliotekë numëron 14 punëtorë më tendencë shtimi të vazhdueshëm.

Sektorët e Bibliotekës janë:

- Sektori i Përpunimit
- Sektori i Hulumtimit dhe i Zhvillimit
- Sektori i Fëmijëve
- Sektori i të Rriturve
- Salla e Internetit
- Sektori i leximit për fëmijë
- Sektori i leximit për të rritur

Në kuadër të veprimtarisë së bibliotekës numërohen:
- Ofrimi i koleksioneve bibliotekare për të gjitha grupmoshat pa dallime;
- Ofrimi i shërbimeve të informacionit;
- Organizimi i takimeve të ndryshme kulturore;

- Mbajtja e seminareve dhe kurseve të ndryshme;
- Organizimi i këshillimeve të ndryshme në lëmin e bibliotekarisë;
- Hapja e ekspozitave të librit dhe të piktorëve të bibliotekës;
- Organizimi i grupeve të ndryshme si: Grupi letrar i bibliotekës, Grupi i recituesve, Grupi dramatik etj.;
- Organizimi i takimeve me shkrimtarë;
- Zgjeron rrjetin bibliotekar (në hapjen dhe rihapjen e bibliotekave);
- Mbikëqyrja e bibliotekave komunale të rajonit të Prizrenit dhe bibliotekave në degë;
- Bashkëpunimi në aspektin profesional me të gjitha bibliotekat shkollore.

Pos këtyre aktiviteteve, vitin e fundit, biblioteka për nder të 60-vjetorit të punës ka botuar edhe përmbledhjen e parë të punimeve të Klubit Letrar të Bibliotekës me emrin *Puhizë lirike*, e cila pritet që të jetë tradicionale, si dhe botimin e Monografisë së bibliotekës, ku janë paraqitur materiale të ndryshme që nga viti 1513 e këndej.
Biblioteka ka një bashkëpunim mjaft të gjerë me BKUK-në, me të gjitha bibliotekat ndërkomunale, komunale dhe bibliotekat në degë, si dhe me bibliotekat shkollore dhe entet botuese. Është binjakëzuar me Bibliotekën e Elbasanit. Ka një bashkëpunim të rregullt me Qendrën e Infobusve në Budapest, ku çdo vit organizohen konferenca të ndryshme, fillimisht në Budapest, pastaj në Mal të Zi, ndërsa këtë vit në Maqedoni. Po ashtu, edhe në aspektin profesional zhvillon bashkëpunim me Bibliotekën e Tollminit në Slloveni.
Biblioteka është ndihmuar dhe vazhdon të ndihmohet nga shumë institucione dhe organizma të tjerë, si dhe mbikëqyret nga Ministria e Kulturës. Sa i përket ndihmës ndihmohet nga BKUK-ja, nga Sorosi, OSI i Budapestit, Zyra Zvicerane, Zyra Amerikane, KFOR-i turk, KFOR- i gjerman, UNHCR, UNICEF etj.

Dëmtimet e bibliotekave publike

Biblioteka e Prizrenit nuk pësoi ndonjë dëmtim në objekt, por vetëm në pasurim me koleksione në gjuhën shqipe. Këtu vlen të thuhet se në vitet 1992, 1995, 1997, 1998 dhe 1999, biblioteka nuk është pasuruar me asnjë libër. Statistikat thonë se gjatë viteve 1993-1996, biblioteka jonë është pasuruar vetëm me 3 libra në gjuhën shqipe. Punëtorët shqiptarë janë dëbuar nga puna,

ndërsa lexuesve shqiptarë u është pamundësuar qasja në shërbime. Objekti i degës së Zhurit është dëmtuar, ndërsa librat janë vjedhur, kështu që pas rikthimit të punëtorëve shqiptarë në Bibliotekën e Prizrenit, është inkuadruar edhe punëtori i bibliotekës së Zhurit, ndërsa librat kanë qëndruar në fondin rezervë, bashkë me inventar. Objekti i bibliotekës së Piranës është djegur bashkë me inventarin përcjellës. Biblioteka e Sreckës është djegur. Biblioteka e Novakës është djegur bashkë me librat e bibliotekës së Velezhës. Biblioteka e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit është dëmtuar, ndërsa librat janë tërhequr në BKUK, kurse punëtori i kësaj biblioteke speciale kishte mbetur pa vendin e punës, pjesa tjetër e librave është vjedhur ose dëmtuar nga lagështia.

Edhe bibliotekat komunale të rajonit të Prizrenit kishin vështirësitë e tyre gjatë kësaj kohe. Biblioteka në Malishevë tani funksionon në një hapësirë shumë të vogël dhe të papërshtatshme për punë. Mund të thuhet se në momente të caktuara kjo bibliotekë është e rrezikshme për fëmijët e vegjël, të cilët janë të shumtë në bibliotekë, sepse kati i tretë është i pakufizuar. Këtu punojnë dy punëtorë, me mjaft përkushtim, njëri është bibliotekar, ndërsa tjetra përgjegjëse - menaxhere e bibliotekës. Shpresohet se do të ndahet edhe një hapësirë, e cila do të shërbente për lexuesit e shumtë të bibliotekës. Nga bibliotekat në degë funksionon vetëm biblioteka në Kijevë, ndërsa bibliotekat në Bajë, në Bellanicë dhe në Lubizhdë, të cilat dikur kanë qenë aktive, tani nuk funksionojnë për shkak të dëmtimeve. Biblioteka në Sharr funksionon në një lokal jofunksional për bibliotekë, me shpresë se do të gjendet ndonjë zgjidhje më adekuate. Në këtë bibliotekë punojnë dy punëtorë: një librar dhe një përgjegjësi i bibliotekës. Numri i librave në bibliotekë është 19.711 libra. Ndërsa, sa i përket degëve, ato nuk janë dëmtuar dhe janë funksionale në Brod, në Bellobradë, në Krushevë, në Brezne dhe në Bresanë, punëtori i të cilës nuk punon, por pritet të punësohet një tjetër. Biblioteka në Therandë është djegur në vitin 2001, ndërsa para se të digjej kishte 22.000 libra. Nga kjo bibliotekë kanë shpëtuar vetëm 8 570, disa prej tyre me dëmtime serioze.

Tani funksionon në një lokal të montuar në oborrin e shkollës, e cila as për së afërmi nuk i plotëson nevojat e bibliotekës, por me një vullnet dhe përkushtim të punëtorëve mbahet gjallë fryma e leximit. Këtu punojnë tre punëtorë, një librar, një bibliotekar dhe menaxheri i bibliotekës. Të djegura janë edhe bibliotekat në Reshtan, në Studençan, në Bukosh dhe në Mushtisht, ndërsa në Nishor dhe në Mohlan degët janë aktive.

Bibliotekat shkollore

Edhe bibliotekat shkollore pësuan mjaft. Pos dëmtimeve që pësuan disa biblioteka shkollore, gjatë luftës, të tjerat pësuan më vonë, me rastin e aplikimit të vendimit për mbylljen e të gjitha bibliotekave shkollore, kështu që shumë punëtorë të bibliotekave shkollore u pushuan nga vendet e tyre të punës. Viteve të fundit, disa shkolla prapëseprapë kanë filluar riaktivizimin e bibliotekave të tyre. Hap ky, i cili është mirëpritur. Nga biblioteka jonë është dërguar një ekip, në të gjitha shkollat, që të njihet me gjendjen dhe që t'u ofrohet ndihmë, aty, ku mund t'u ofrohet.

Tabela. 2. Gjendja e bibliotekave shkollore

Shkolla	Nr. i librave	Nr. i punëtorëve	Vështirësitë
Fakulteti i Edukimit	47276	+	
SHM “Gjon Buzuku”	22554	+	Lokali i papërshtatshëm
SHM ”Ymer Prizreni”	Nuk dihet	+	Ndihma profesionale
”Gani Qavderbasha”	3878	+	
“Mati Logoreci”		S`ka punëtor	Është shndërruar në klasë mësimi
”Fadil Hisari’’	Nuk dihet	S`ka punëtor	Është shndërruar në klasë mësimi
‘’Motrat Qiriazi ‘’	2500	+	Hapësira shumë e vogël
‘’Mustafa Bakiu’’	7015	+	Ndjehet mungesë e lekturës shkollore
‘’Emin Duraku’’	7310	+	Hapësira e ngushtë si dhe pa libra të anëtarësisë
‘’ Abdyl Frashri ‘’	3298	+	Mungesë librash
‘’Lidhja e Prizrenit’’	1100	+	Orari 4 orë - ndjehet mungesë e madhe librash
‘’Luciano Motroni’’	5321	+	Libri i inventari dhe vulat

(Kumtesë e paraqitur në tryezën me bibliotekarë: "Gjendja e bibliotekave publike në Kosovë 1990-2005", e mbajtur më 16 prill 2005 në Prizren)

Sylejman PIREVA
Drejtori i Bibliotekës Ndërkomunale "Hivzi Sulejmani" e Prishtinës

Biblioteka publike e kryeqytetit të Kosovës - dje dhe sot

Historiku

Biblioteka Ndërkomunale "Hivzi Sulejmani" e Prishtinës është hapur në vitin 1945, por në një ndërtesë tjetër nga kjo e sotmja. Kjo, ku ndodhet tani, daton nga viti 1948. Sipas shënimeve dhe shumë dëshmive, roli i kësaj biblioteke në rrafshin kombëtar është vërejtur fare pak për tri decenie me radhë, pasi politika unitariste ish-jugosllave e më vonë regjimi i Millosheviqit, ndërruan kahet reale të zhvillimit në aspektin kuadror dhe në veprimtarinë e përgjithshme të saj. Për 29 vjet - gjer më 1977, asnjëherë nuk ishte emëruar në krye të saj një udhëheqës shqiptar, kurse vetë struktura nacionale e të punësuarve dhe e literaturës ishte diskriminuese gjer në skaj. Në vitin 1977, nga 25 punonjës, sa kishte kjo bibliotekë, vetëm 4 prej tyre ishin shqiptarë, ndërsa mbi 90 % e koleksioneve ishin në gjuhën serbe. Gjithashtu, bibliotekat që hapeshin si degë të saj, hapeshin kryesisht në vendbanime me popullatë serbe, ose me shumicë nga ky minoritet, por shumë rrallë në vendbanimet me shumicë shqiptare.

Kthesa e vonuar

Kështu ishte gjer në vitin 1977, kur në krye të kësaj biblioteke emërohet një udhëheqës shqiptar. Vetëm nga ky vit nis ajo kthesa e pritur, por tepër e vonuar, kur edhe ndodhin ndryshimet e një politike më racionale, qoftë në përmirësimin e kuadrit sipas çelësit nacional, qoftë në pasurimin e koleksioneve me literaturë në gjuhën shqipe ose dhe në gjuhë të tjera. Në fakt, këtë periudhë e karakterizon ndërmarrja e duhur për hapjen e disa bibliotekave në vendbanimet me shumicë shqiptare. Për tetë vjet ishin hapur 12 biblioteka, madje edhe në skajet më të largëta në vende malore: në fshatrat Koliq, Marec, Mramor, Breznicë etj.

Rishfaqja e obskurantizmit 1992 - 1999

Dhjetëvjetëshi i fundit i mileniumit që lamë pas, karakterizohet me rikthimin e gjendjes së paraviteve 1977, që personifikon një obskurantizëm serb të llojit mesjetar. Kjo fatkeqësi rrënuese e bibliotekës publike të kryeqytetit filloi në mars të vitit 1992, kur në krye të saj erdhi një drejtor serb. Ajo që ishte arritur me shumë mund, për vite me radhë, nisi të rrënohet shumë shpejt.
Në vitet pasuese deri në vitin 1992 - para administrimit të dhunshëm serb në këtë bibliotekë dhe në rrjetin e saj, ishte kjo gjendje: biblioteka qendrore kishte 27 degë: 3 në komunën e Fushë Kosovës: në Fushë Kosovë, në Bardh të Madh (Bellaçevc) dhe në Sllatinë; 4 në komunën e Kastriotit: në Kastriot, në Hade, në Breznicë dhe në Miloshevë; 2 në komunën e Artanës (Novo Bërdë): në Artanë dhe në Prekovc; dhe 18 në komunën e Prishtinës: Biblioteka Qendrore në Pallatin e Rinisë, në "Përralla ", në " Lektura", "Biblioteka Përkujtimore ", në Llukar, në Koliq, në Keqekollë, në Bardhosh, në Barilevë, në Hajvali, në Graçanicë, në Çagllavicë, në Llapna Sellë, në Slivovë, në Mramor dhe në Viti të Marevcit, si dhe biblioteka në Spitalin e Mushkërive; 48 punonjës: 28 shqiptarë, 17 serbë, 1 kroat, 1 turk dhe 1 rom; 210 680 libra në gjuhën shqipe, 143 174 libra në gjuhën serbe, 5 945 libra në gjuhën turke dhe 2 000 libra në gjuhë të huaja - pra, gjithsej: 361 800 libra. Gjatë administrimit serb dhe luftës (1992-1999) Biblioteka Qendrore kishte këtë gjendje: shqiptarë të punësuar: 10; të larguar: 38; serbë të punësuar: 34;

libra në gjuhën shqipe: 39 048; libra në gjuhën serbe: 31 885; libra në gjuhën turke: 802 dhe libra në gjuhët e tjera: 250. Nga shfletimi i librave të inventarit dhe dëshmitë e tjera të dokumentuara, del nga koleksionet e kësaj biblioteke janë të zhdukur: 71 985 libra.
Në bazë të kritereve të përcaktuara për çmimin e kopjes vlerësohet se dëmi arrin: 503 895 €. Dëmet e tjera gjatë luftës në Bibliotekën Qendrore vlerësohen të jenë: dëmtimi i kulmit të Bibliotekës Qendrore nga detonimet e NATO-s: 10 000 €; plaçkitja e veturës së tipit Renault 4: 3 500 €; telefoni: 20 €; fax-i: 170 €; makina llogaritëse: 150 € dhe vegla të punës: 500 €. Pra, gjithsej: 27 840 €.
Ndërsa, dëmet gjatë luftës në degët e Bibliotekës Qendrore janë këto: biblioteka në fshatin Hade : djegia e 8 523 librave: 59 661 €, objekti dhe inventari: 95 000 €; biblioteka në fshatin Koliq: 3 500 libra: 24 500 €; biblioteka në Viti të Marecit: 4 890 libra: 33 600 € dhe objekti i bibliotekës i djegur plotësisht: 87 000 €; biblioteka në Sllatinë: abuzimi i 2000 kopjeve, në tualet dhe jashtë në oborr: 14 000 €; biblioteka e Spitalit të Sëmundjeve të Brendshme: zhdukja e 3 500 librave: 24 500 € dhe inventari: 1 800 €; biblioteka komunale e Artanës - Novo Bërdës (deri më 1999 ishte nën mbikëqyrjen profesionale të Bibliotekës Qendrore 12 000 libra: 84 000 € dhe inventari: 2 500 €. Pra, gjithsej: 426 561 €. Duke i bashkuar të gjitha dëmet në Bibliotekën Qendrore dhe në degë, del se dëmi i përgjithshëm është: 946 296 €.

Rilindja e bibliotekës

Gjysma e dytë e vitit 1999, është një periudhë tjetër kur filloi mëkëmbja e kësaj biblioteke. Me mobilizim të vetë punonjësve filloi sanimi dhe konsolidimi i gjithanshëm i këtij institucioni në të gjithë sektorët dhe në ato degë, ku mund të punohej. Mirëpo, për përmirësimin e kësaj gjendjeje dhe për zhvillimin e mëtejmë kishin kontribuar dukshëm organizatat e ndryshme ndërkombëtare. Një vit pas përfundimit të luftës, nga një projekt i përbashkët i SOROS-it dhe i një kompanie hebraike nga Britania e Madhe, u bë renovimi i bibliotekës së fëmijëve "Përrallat", e cila ndërroi krejtësisht pamjen dhe u pajis me inventar të ri, me mbi 1 000 libra dhe me pesë kompjuterë. Ndërsa, Agjencia Evropiane për Rindërtim, investoi në renovimin e objektit të Bibliotekës Qendrore.

Data 28 qershor, i çdo viti, është datë jubilare, e cila shënohet në këtë bibliotekë dhe personifikon fillimin e mëkëmbjes së përgjithshme të saj. Po në këtë datë, punonjësit e Bibliotekës u kthyen në institucionin e tyre, por më pak se gjysma, vetëm 16 prej tyre, nga 45 sa kishte para ndërhyrjes së NATO-s. Pas hyrjes së misionit ndërkombëtar në Kosovë lypsej kompletuar kuadri i bibliotekës për të funksionuar si duhet të gjithë sektorët dhe në të gjitha degët, si dhe për të filluar puna, si më parë, në dy turne, në Bibliotekën Qendrore dhe në tri degë të saj. Kjo është arritur relativisht shpejt dhe tani biblioteka numëron 37 punonjës: 8 me fakultet, 3 me shkollë të lartë, 23 me shkollë të mesme dhe 3 me shkollë fillore.

Përtëritja dhe pasurimi i fondit librar

Kthimi ynë në bibliotekë, pas mbarimit të luftës, shënoi një gjendje të tmerrshme të koleksioneve në Bibliotekën Qendrore: libra shqip - 19 mijë, serbisht - 34 mijë, turqisht - 3 mijë dhe në gjuhë të huaja 2 mijë. Kjo gjendje e konstatuar ishte tepër dëshpëruese për kolektivin e bibliotekës. Çdo të thoshte kjo për një kryeqytet, me 0.5 milionë banorë?! Ishin edhe katër degë të tjera në pjesë të ndryshme të qytetit, por sa vlen kjo, kur të gjitha së bashku nuk bënin më shumë 40 mijë libra. Me gjithë përpjekjet që në forma të ndryshme ta rrisnim këtë numër të librit shqip në numër gjashtëshifrorë, ende nuk i jemi ofruar shifrës 50 000. Ende jemi larg për barazim me shifrën e librit në gjuhën serbe. Me këtë nuk duam të themi se jemi kundër librit në gjuhën serbe, por kërkesat janë të pakta për të, ndërsa disa herë më të shumta janë për librin shqip. Nga të dhënat që morëm këto ditë nga Sektori i Përparimit dhe i Zhvillimit të Veprimtarisë Bibliotekare, gjer më tash biblioteka është pasuruar me 30 mijë kopje të librit në gjuhën shqipe.

Përdoruesit

Nga viti në vit shihet një interesim në rritje i numrit të përdoruesve të bibliotekës. Nga 3 500 anëtarë, sa kishte në vitin 2000, në vitin 2004 kishte mbi 5 100, kurse këtë vit ky numër pritet të rritet afër 6 500, fakt ky që na gëzon, pasi që konsiderojmë se interesimi për lexim po shënon rritje permanente.

Revizioni i koleksioneve

Në mungesë të kuadrit dhe të përgatitjes profesionale, sado që kjo ishte imperativ pas përfundimit të luftës së fundit, nuk kishte mundësi që të bëhet revizioni i koleksioneve të bibliotekës, e që kishte aq shumë nevojë, për shkak të rrethanave të njohura. Mënyra se si ishte vepruar atëherë, ishte e pasigurt dhe jo aq e saktë. Vetëm pas kompletimit dhe ngritjes së kënaqshme profesionale të punonjësve, pikërisht në qershor të vitit 2004, filloi puna e revizionit, që pritet të përfundojë në muajin e ardhshëm (fjala është vetëm për fondin e koleksioneve të bibliotekës në qendër, sepse degët pritet të fillojnë më vonë). Që nga viti 1978, për herë të parë, po bëhet një revizion si duhet dhe në mënyrë shumë profesionale, me metodologji shumë profesionale dhe që nuk të lë vend për të gabuar, prandaj dhe për herë të parë pritet të konstatohet gjendja e saktë e këtij fondi, me të cilin është manipuluar në mënyrë çoroditëse dhe të palejueshme.

Interneti

Ndonëse me vonesë, biblioteka është pajisur me Internet në mars të vitit të kaluar. Tani qasje në të kanë edhe përdoruesit, por edhe punonjësit e shumicës së sektorëve. Përdoruesve, që janë anëtarë të bibliotekës, u është mundësuar që ta përdorin falas, në të kundërtën, nuk do të kishte interesim për të dhe nuk ia vlenin shpenzimet e bëra për instalimin e tij.

Aktiviteti kulturor

Përveç zhvillimit të suksesshëm të veprimtarisë bibliotekare, kjo bibliotekë njihet edhe me zhvillimin e një spektri të gjerë aktivitetesh kulturore, shënime të ngjarjeve të rëndësishme të traditës, po kështu, edhe manifestime të tjera nga fusha e artit, letërsisë etj.

Klubi i Letrarëve të Rinj të Bibliotekës

Para dy vjetësh, në prill të vitit 2003, pikërisht gjatë "Javës së Bibliotekës në Kosovë" është formuar Klubi i Letrarëve të Rinj të Bibliotekës, i cili ka organizuar takime dhe orë letrare në fakultete dhe në shkolla të mesme. Ky klub

ka marrë pjesë nëpër konkurse të ndryshme letrare, ndërsa anëtarët e saj janë shpërblyer. Shumë anëtarë të këtij Klubi kanë botuar prej 1-3 tituj zhanresh të ndryshme, si dhe një përmbledhje poezish me 30 autorë - anëtarë të Klubit.

Veprimtaria botuese

Biblioteka tashmë është bërë edhe botuese e librit. Ajo ka botuar tre libra të anëtarëve të Klubit dhe ka nxjerrë numrin e parë të revistës letrare me titull "Oaza". Gjer më tani, mjetet janë siguruar kryesisht nga buxheti i bibliotekës dhe në dy raste të tjera nga Drejtoria për Kulturë dhe nga një firmë private. Brenda një muaji pritet të dalë edhe numri i dytë.
Pas përfundimit të luftës (1999) është ndryshuar edhe statusi i bibliotekës. Nga institucioni komunal, që ishte më parë, kaloi me status në Ministrinë e Kulturës. Gjatë kësaj kohe, togfjalëshi i saj ndërroi tri herë: biblioteka e qytetit, biblioteka rajonale dhe së fundi biblioteka ndërkomunale, për shkak se mbikëqyrë punën edhe të pesë bibliotekave të tjera komunale. Kjo është paraparë edhe me Ligjin për Bibliotekat në Kosovës. Për bindjet e mia, statusi i bibliotekës nuk është fiktiv, sepse ka mbetur me standard të dyfishtë: edhe bibliotekë komunale edhe bibliotekë e Ministrisë së Kulturës. Me një këmbë në komunë e me një këmbë në ministri. Gati gjysma e punonjësve marrin të ardhurat nga buxheti komunal, e pak më shumë se gjysma në ministri. Mjete për blerje të librit 3-4 herë më shumë jep komuna sesa që jep ministria. Çështja e statusit të bibliotekës është disi e ngatërruar dhe duhet të definohet qartë. Mbështetur në Ligjin për Bibliotekat në Kosovë, biblioteka ka hartuar Statutin e ri, por as pas një viti Ministria e Kulturës nuk ka dhënë përgjigje se a është i pranueshëm, ndonëse e ka aprovuar dhe nënshkruar njeriu i kësaj ministrie.

(Kumtesë e paraqitur në tryezën me bibliotekarë: "Gjendja e bibliotekave publike në Kosovë 1990-2005", të mbajtur më 16 prill 2005 në Prizren)

Hajrullah MUSTAFA
Drejtor i Bibliotekës Ndërkomunale "Latif Berisha" të Mitrovicës

Veprimtaria bibliotekare në rajonin e Mitrovicës - dikur, sot dhe nesër

Veprimtaria bibliotekare si një sferë me rëndësi shoqërore, por edhe bibliotekat si bartëse dhe strumbullare e rëndësishme në rajonin e Mitrovicës, kanë një histori, përvojë dhe traditë mjaft të begatshme në zhvillimin e shoqërisë kosovare, e posaçërisht në zhvillimin e kulturës shpirtërore. Edhe pse, gjatë këtij zhvillimi pati ngritjet dhe rëniet, përkatësisht, sfidat e saj, ashtu siç pati edhe tërë populli i Kosovës.
Ndonëse kanë ekzistuar shumë biblioteka personale ose familjare e edhe shumë më herët, konstituimi dhe organizimi institucional i bibliotekave në rajonin e Mitrovicës, arrihet pas Luftës së Dytë Botërore, në nëntor 1945, kur edhe themelohet biblioteka publike e Mitrovicës, e cila që nga kjo kohë u bë bazamenti më i fortë për zgjerimin dhe afirmimin e librit dhe të kulturës së të lexuarit në këto treva.
Edhe pse me shumë vështirësi dhe pengesa, siç ishin: mungesa e hapësirave, mungesa e mjeteve financiare për pasurimin e fondeve, mungesa e kuadrit profesional, prapëseprapë, gjerë në vitin 1990, kishte një përparim në zhvillimin e kësaj sfere. Futja e masave të dhunshme në BKUK, nga pushteti i atëhershëm serb, në vitin 1990, jo vetëm që ndërpreu, por pothuajse shkëputi plotësisht zhvillimin e veprimtarisë bibliotekare në Kosovë, e edhe atë të Mitrovicës.

Se cila ishte gjendja e bibliotekave në regjionin e Mitrovicës në vitin 1990, shihet nga të dhënat e mëposhtme:

Tabela: 1

Nr. rend.	Komuna	Biblioteka publike	Fondi librar	Degët	Fondi total librar
1	Mitrovicë	1	111.546	7	152.858
2	Vushtrri	1	34.049	8	77.284
3	Albanik	1	11.366	3	15.949
4	Skënderaj	1	20.000	6	68.000
5	Zubin Potok	1	9221	---------	9221

Përveç këtyre funksiononin edhe këto biblioteka: biblioteka në bashkësinë vendore në Zveçan, biblioteka në Institutin për Plumb dhe Zink në Kombinatin "Trepça", biblioteka e Fakultetit XMT dhe SHLT, si dhe një rrjet shumë i gjerë i bibliotekave të shkollave të mesme dhe fillore të Mitrovicës. Si biblioteka të tipit të veçantë ishin: Biblioteka në Spitalin Rajonal dhe Biblioteka për Persona me Aftësi të Kufizuar në kuadrin e shkollës speciale të Mitrovicës.
Pas vitit 1990, tërë kjo strukturë e rrjetit të bibliotekave në rajonin e Mitrovicës, fatkeqësisht, merr pamje tjetër. Ndërpritet puna e shumë nëndegëve të bibliotekave publike, largohen punëtorët nga vendet e tyre të punës, studentët dhe nxënësit nga lokalet e tyre dhe mohohet tërësisht e drejta e popullsisë shqiptare për të pasur qasje dhe për të shfrytëzuar librin dhe materialin tjetër bibliotekar. Kështu, prej këtij viti e gjerë në qershor të vitit 1999, libri shqip u bë "halë në sy" për pushtetin e atëhershëm serb, kurse punonjësit dhe distributorët e librit shqip, të cilët punonin në përhapjen e librit, ishin njerëzit pothuajse ,,më të rrezikshëm". Edhe ato pak biblioteka që me shumë përpjekje mbaheshin, u shkatërruan dhe u dogjën nga lufta. Ndonëse mbijetuan tri biblioteka publike: e Mitrovicës, e Vushtrrisë dhe e

Skënderajt, shumë nëndegë të tyre u shkatërruan dhe u dogjën. Duhet përmendur se vetëm në Komunën e Mitrovicës u dogjën, tërësisht, më se 18 biblioteka të tipit shkollor dhe nëpër bashkësi vendore, si dhe shumë biblioteka personale, përkatësisht, familjare të shumë personaliteteve krijuese e publike të Mitrovicës, që i kishin ruajtur dhe pasuruar, me vite të tëra, nëpër shtëpitë e tyre.

Rrjeti bibliotekar i Mitrovicës në realitetin politik të Kosovës

Realiteti i ri politik i Kosovës pas luftës, por edhe i tërë Kosovës e gjeti rrjetin bibliotekar të Mitrovicës tërësisht të shkatërruar dhe të djegur, edhe pse tri biblioteka publike në Mitrovicë, në Vushtrri dhe në Skënderaj mbijetuan prej luftës. Në korrik të vitit 1999, filloi punën biblioteka ndërkomunale e Mitrovicës, ndërsa pak më vonë edhe ajo e Vushtrrisë dhe e Skënderajt. Kushtet ishin shumë të vështira për punë. Pa inventar. Pa mjete për punë, por duke iu falënderuar entuziazmit dhe vullnetit të punonjësve, shumë shpejt filloi rehabilitimi i objekteve, rritja e stafit të punonjësve, pasurimi i fondeve librare, shtimi i përdoruesve të librit dhe të materialit bibliotekar, si dhe mbajtja dhe organizimi i shumë aktiviteteve kulturore, të cilat kishin për qëllim promovimin dhe avancimin e kulturës në rajonin e tyre.

Në tekstin e mëposhtëm është struktura e fondit librar të bibliotekave publike të këtij regjioni sipas të dhënave për vitin 2004:

Tabela: 2

Nr. rend.	Bibliotekat publike	Fondi librar	Nëndegët	Fondi libr. në degë	Gjithsej
1	Mitrovicë	69.440	3	14.560	84.000
2	Vushtrri	21.450	5	30.754	52.204
3	Skënderaj	10.736	1	871	11607
4	Zubin Potok	22.494	----------	----------	22.494

(Nuk kanë të dhëna të sakta të fondit librar në bibliotekat publike të Zveçanit dhe për tipat e tjerë të bibliotekave në regjionin e Mitrovicës)

Ndërsa, gjendja e përdoruesve të librit dhe e materialit tjetër bibliotekar shihet në këto të dhëna nga viti 2004:

Tabela: 3

Nr.rend.	Bibliotekat publike	Nr. i lexuesve	Nr. i shërbimeve
1	Mitrovicë	4.151	50.881
2	Vushtrri	1.968	39.729
3	Skënderaj	794	4.432

Kuadri

Tabela: 4 - Numri i punëtorëve dhe struktura kualifikuese dhe profesionale në bibliotekat publike në regjionin e Mitrovicës.

Nr. Rend.	Bibliotekat publike	Bibliotekarë	Librarë	Punonjës administro.	Punonjës teknikë	Gjithsej
1	Mitrovicë	3	11	1	4	19
2	Vushtrri	----------	9	----------	----------	9
3	Skënderaj	----------	4	----------	----------	4

Lokalet për shërbime bibliotekare në bibliotekat publike në regjionin e Mitrovicës

Bibliotekat publike	Hapësira	Sallat e leximit	Hapësira në degë	Gjithsej
Mitrovicë	1089 m²	25 m²	48 m²	1137 m²
Vushtrri	163.20 m²	----------	155 m²	318.2 m²
Skënderaj	90 m²	----------	12 m²	102 m²

Nga të dhënat e paraqitura, shihet se ende gjendemi larg standardeve dhe nevojave që kërkon realiteti dhe momenti i zhvillimeve për konsolidimin e mirëfilltë të kuadrit bibliotekar, sepse ende dominon një strukturë e personelit me përgatitje të mesme shkollore dhe kemi mungesë lokalesh për shtrirjen e shërbimeve bibliotekare në bibliotekat publike të Vushtrrisë dhe Skënderajt. Këto të fundit janë ballafaquar me mungesën e punonjësve (bile edhe atyre teknik), gjë që nuk ka nevojë të komentohet më tepër. Me ndryshim nga këto të fundit, Biblioteka Ndërkomunale "Latif Berisha", duke komunikuar dhe duke bashkëpunuar me shumë institucione ndërkombëtare

dhe vendore, me shumë fondacione dhe shoqata të ndryshme, si dhe duke qenë partnere serioze në zbatimin e shumë projekteve, jo vetëm që pati përfitime, por u avancua shumë në pasurimin e koleksioneve bibliotekare dhe në këmbimin e përvojave me vendet më të zhvilluara dhe më të përparuara në sferën e bibliotekarisë. Ajo, tani, jo vetëm që bashkëpunon me shumë biblioteka të Kosovës, të Shqipërisë (me Bibliotekën Publike të Fierit, me të cilën jemi binjakëzuar), por edhe me Bibliotekën e Brestit në Francë, me biblioteka të Zvicrës, të Bihaqit në B.H., me Bibliotekën e Oslos në Norvegji, me biblioteka të Kroacisë dhe me Komunën e Hassleholmit në Suedi (e cila na ka dhuruar edhe Bibliobusin shumë bashkëkohor e të rëndësishëm për ne).

Bibliobusi i dhuruar nga Komuna suedeze e Hassleholmit

Duke elaboruar rrjedhat e gjertanishme të bibliotekarisë në rajonin e Mitrovicës, shihet qartë se kah duhet të fokusohemi dhe cilat do të jenë objektivat në të ardhmen, me të vetmin qëllim që të arrijmë një shkallë, shumë më të avancuar të bibliotekarisë dhe që sa më shpejt të futemi në rrjedhat e bibliotekarisë perëndimore. Duke u bazuar në analizën e gjendjes së bibliotekave publike të Vushtrrisë dhe të Skënderajt, por edhe në tipat e tjerë të bibliotekave të kësaj ane, prioritet i

të gjitha prioriteteve duhet të jenë: investimi shumë më i madh në pasurimin e fondit librar, që do të mundësonte shtimin më të madh të përdoruesve të librit dhe të materialit bibliotekar; shtimi i domosdoshëm i personelit bibliotekar dhe angazhimi i domosdoshëm i një personeli me përgatitje profesionale universitare; zgjerimi i hapësirave të bibliotekave dhe hulumtimi i mundësive për hapjen e sallave të leximit dhe të aktiviteteve të tjera kulturore; trajnimi dhe aftësimi i vazhdueshëm profesional i bibliotekarëve; ngritja shumë më e lartë e nivelit të punës profesionale, sipas standardeve ndërkombëtare bibliotekare, si dhe aplikimi i metodave më efikase për përdoruesit e materialit bibliotekar; organizimi shumë më i madh i aktiviteteve përcjellëse kulturore brenda bibliotekave publike; zgjerimi i mëtutjeshëm i degëve të bibliotekave nëpër vende rurale, si dhe fokusimi për punë shumë më profesionale.

Duke analizuar zhvillimin e gjertanishëm të veprimtarisë bibliotekare të këtij rajoni edhe Biblioteka Ndërkomunale "Latif Berisha" e Mitrovicës, ndonëse në realitetin e ri politik të Kosovës, shënoi hapa në strategjinë e zhvillimit të ardhshëm, parashtroi objektivat kryesore, duke u fokusuar dhe duke u pozicionuar kah: pasurimi dhe begatimi më i madh i fondit librar; automatizimi dhe profesionalizimi i punës dhe i shërbimeve bibliotekare, në harmoni me ligjin për bibliotekat, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, si dhe sipas kërkesave dhe standardeve ndërkombëtare; kalimi në fonde të hapura të bibliotekës për përdoruesit; bashkëpunimi edhe më i lartë ndërbibliotekar ndërmjet shumë bibliotekave, për të cilin shumë njohës dhe specialistë të bibliotekarisë e radhisin këtë faktor në grupin e faktorëve më të rëndësishëm të progresit, të zhvillimit dhe të masivizimit të bibliotekave dhe bibliotekarisë; nxitja dhe afirmimi i një veprimtarie bibliotekare kërkimore-hulumtuese, e cila do të ndihmonte ndër të tjera edhe në identifikimin dhe plotësimin e kërkesave, edukimin dhe synimin më praktik, në qasjen të përdoruesve të bibliotekave. Mendoj se këto objektiva mund, por edhe duhet të realizohen vetëm me një bashkëpunim reciprok dhe shumë të sinqertë ndërmjet pushtetit lokal dhe atij qendror në Kosovë, në mesin e të cilave ndodhet, vepron dhe funksionon edhe biblioteka publike, si institucion shumë i rëndësishëm kulturor, edukativ dhe informativ.

(Kumtesë e paraqitur në tryezën me bibliotekarë "Gjendja në bibliotekave të Kosovës 1990-2005", e mbajtur më 16 prill 2005 në Prizren)

Shefki OSMANI
Drejtor i Bibliotekës Ndërkomunale "Fan S. Noli" të Gjilanit

Pasqyrë e aktiviteteve në BN "Fan S. Noli" në Gjilan

Gjendja e bibliotekave pas luftës

Pas vitit 1990, regjimi serb shembi çdo institucion në Kosovë. Edhe biblioteka e qytetit (tash me emërtimin rajonale) "Fan S. Noli" kishte të njëjtin fat. Ajo nuk u pasurua me fond të ri librar. Objekti i Bibliotekës së Gjilanit nuk ishte mirëmbajtur. Për shkak të luftës u gjend në një gjendje të mjerueshme. Inventari dhe pajisjet e tjera ishin vjedhur. Pluhuri dhe merimangat kishin mbuluar librat dhe çdo gjë tjetër. Gjithçka ishte në një gjendje kaotike. Një shkatërrim të madh e kanë pësuar, sidomos, bibliotekat e fshatrave Përlepnicë, Zhegër, Cërnicë, Malishevë, Dobërçan dhe Shurdhan, kurse ajo e fshatit Llashticë u dogj me themel. Fondi librar ishte vjedhur ose djegur, pajisjet ishin shkatërruar. Me një fjalë duhej nisur nga e para.

Hapja dhe rihapja e bibliotekave të reja

Me një angazhim të madh të të gjithë punonjësve të bibliotekës, për një kohë të shkurtër, u arrit të hapet biblioteka e re në fshatin Llashticë, e cila gjatë luftës u dogj e tëra dhe biblioteka e re në fshatin Miresh. Pastaj, u rihapën bibliotekat në Zhegër, Përlepnicë, Bresalc, Pasjan, Budrikë e Ulët, Partesh dhe Koretishtë. Po ashtu, në kuadër të bibliotekës qendrore, në vitin 2000, u hap Sektori Shkencor, ndër të parët i këtij lloji në Kosovë. Në vitin 2002 u hap Sektori i Krijuesve të Vendlindjes, në të cilin janë përfshirë veprat e krijuesve të Gjilanit, të Dardanës, të Vitisë, të Artanës, të Bujanocit, të Preshevës dhe të Kumanovës. Në të gjitha këto biblioteka dhe këta sektorë, tashmë, ka një fond të mjaftueshëm për lexuesit.

Kronologji e mbajtjes së panaireve

Panairi i librit 1999 u hap në fillim të muajit nëntor, në kushte tejet të vështira. Ishte panairi i parë, paslufte, i organizuar në Kosovë. Në këtë panair, që u hap në sallën e leximit të Bibliotekës "Fan S. Noli", me mbi 800 tituj të rinj, morën pjesë 12 botuesit më të njohur mbarëkombëtar: "Rilindja", "Toena", "Buzuku", "Libri Shkollor", "Flaka", Instituti Albanologjik, "Vatra", "Iliriku", "Jeta e re", "Zëri", "Pionieri" e "Shkëndija". Panairi kishte karakter shitës, kështu që, entet, institucionet, themelatat arsimore e organizatat e firmat shoqërore a private, patën rastin t'i begatojnë bibliotekat e tyre me titujt më të rinj të librave shqip. Këtë mund e bënë edhe qytetarët. këtë e bënë, edhe për shkak të çmimit të zbritur, për 20 për qind. Panairi ishte i hapur deri më 6 nëntor, kurse u mbajt në kuadër të "Muajit të librit" dhe në shenjë të 28 Nëntorit - Ditës së Flamurit.
Prej datës 27-30 shtator të vitit 2000, biblioteka organizoi Panairin e librit 2000. Gjatë këtij panairi, lexuesit mund të furnizoheshin me libra, po ashtu me një çmim më të lirë, për 20%. Në Panair morën pjesë shumë shtëpi botuese nga Kosova, nga Shqipëria e Maqedonia, siç janë: "Rilindja", Instituti Albanologjik, "Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës", "Buzuku", "Libri Shkollor", "Enti i Teksteve Mësimore", "Faik Konica", "Jeta e re", "Zëri" dhe "Dija" të Prishtinës, pastaj "Dukagjini" i Pejës, "Toena", "Onufri", Akademia e Shkencave, "Fan Noli", "Dritëro", "Kombi", "Elena Gjika" e të tjerë nga Tirana; "Camaj-Pipaj" nga Shkodra, "Flaka" nga Shkupi, dhe "Ura" e "Drita e jetës" nga Gjilani. Pasi që hapësira e Bibliotekës ishte e vogël për interesimin e madh të dashamirëve të librit, Panairi u mbajt në lokalet e mrekullueshme të Shkollës së Lartë Pedagogjike "Skënderbeu"

në Gjilan.
Panairi i librit 2001 u organizua në muajin nëntor. Morën pjesë 40 shtëpi botuese nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Panairin e vizituan më se 5 500 qytetarë. Biblioteka nuk arriti të pasurohet me fond të ri nga ky panair, në mungesë të mjeteve të mjaftueshme materiale. Megjithatë, shtëpitë botuese nga Shqipëria, i dhuruan një sasi solide bibliotekës, për pasurimin e fondit të saj
librar.
Panairi i librit 2002 u mbajt prej 11-14 shtator, në Sallën e Qendrës Rinore, në Shtëpinë e Kulturës, ku librin e ekspozuan botues nga Shqipëria, Kosova dhe më gjerë. Ishte një Panair Jubilar, i 30-ti me radhë (duke pasur parasysh edhe panairet e paraluftës). Në këtë panair u prezantuan 42 shtëpi botuese, ku pati edhe botime të reja, mjaft tërheqëse, për lexuesit dhe një botues nga Franca.
Në kuadër të panaireve, të cekura më lartë, u mbajtën edhe aktivitete të tjera përcjellëse kulturore, siç ishte prezantimi i veprave të krijuesve të ndryshëm letrarë e shkencorë.
Panairi i librit 2003 shënoi pjesëmarrjen e botuesve nga Kosova, Shqipëria dhe trojet shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi. Pra, në Gjilan është mbajtur Panairi i 31-të i librit "Gjilani 2003", të cilin e ka hapur kryetari i Kuvendit Komunal të Gjilanit, Lutfi Haziri. Në kuadër të panairit është bërë promovimi i krijimtarisë letrare të Xhemë Karadakut (librat me tregime dhe vjersha "Lavjerrësi i kohës" dhe "Histori për një dashuri"), u promovuan edhe libri "Artikuj të përzgjedhur pedagogjikë" të mr. Shefik Halitit dhe libri me tematikë historike "Fan S. Noli" i autorit Mehmet Gëzhilli. Panairi, si zakonisht, kishte karakter shitës dhe u mbajt në hapësirën e Galerisë së Arteve në Gjilan, prej datës 20-24 tetor.
Në Gjilan, nga data 8-10 shtator 2004, u mbajt Panairi i 32-të i Librit (i 6-ti pas luftës në Kosovë). Panairi u organizua në mjediset e Teatrit Kombëtar të Gjilanit. Në panair morën pjesë botues nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe një pjesë e botuesve nga Shqipëria.

Pasurimi i koleksioneve të Bibliotekës me botime të reja

Fondi librar me dekada, lëre që nuk ishte pasuruar me botime të reja, por edhe ai fond që kishte qenë, ishte dëmtuar, e madje një pjesë e mirë e tij edhe ishte zhdukur fare. Pra, që në ditët e para të pasluftës (1999) një ndër prior-

itetet ishte edhe pasurimi me fond të ri librar, si një ndër kushtet kryesore për hapjen e bibliotekave të reja ose për rihapjen e atyre që kishin ekzistuar.
Në bazë të Raportit të punës për vitin 1999 kemi këto të dhëna:

1. Numri i librave që mungonin në fshatra ishte:

- Në gjuhën shqipe	42.852 copë
- në gjuhën serbe	6.691 copë
- Në gjuhën turke	181 copë
- Në gjuhë të tjera	1 copë

Gjithsej të zhdukura në fshatra: 49.725 copë

2. Fondi i dëmtuar dhe i zhdukur në Bibliotekën Qendrore në Gjilan:

-Në gjuhën shqipe	500 copë
-Në gjuhën serbe	1 500 copë

Në Bibliotekën Qendrore mungojnë 2 000 copë. Pas luftës (prej vitit 1999) Biblioteka u pasurua me 21 250 njësi bibliotekare të reja, përmes këtyre formave: blerjes, dhurimit dhe këmbimit. Pasurimi i Bibliotekës me botime të reja ndikoi drejtpërdrejt në shtimin e numrit të lexuesve, ku vetëm në vitin 2002 numri i shfrytëzuesve të materialit bibliotekar dhe shërbimeve të Internetit, arriti në 32 120. Kjo shifër tregon se numri i shfrytëzuesve është rritur, nga viti në vit, për mbi 20%. Në vitin 2002, Biblioteka ka pasuruar fondet librare me botime të reja për 4 978 ekzemplarë, vlera e të cilëve është përafërsisht 25 000 €. Bibliotekën e ndihmuan sidomos 140 krijuesit e Anamoravës, të cilët dhuruan afro 1 150 ekzemplarë, me të cilët u mundësua hapja e Sektorit të Krijuesve të Vendlindjes. Pa ndihmën e donatorëve të shumtë, qoftë individualë, qoftë institucionalë, Biblioteka do ta kishte vështirë t'i pasuronte koleksionet e veta me botime të reja e me të edhe shtimin e përdoruesve.

Promovimi i librave të ndryshëm

Me qëllim të përhapjes së librit, me qëllim që libri të arrijë sa më afër përdoruesve dhe me dëshirë, që krijuesit të jenë sa më të pranishëm në mesin e lexuesve, Biblioteka ka bërë, herë pas here, promovimin e librave të kri-

juesve tanë të afirmuar. Në çdo promovim, që është bërë, interesimi i dashamirëve të librit ka qenë në një nivel të lartë. Aty është biseduar për librin, i cili është promovuar, por edhe për librin në përgjithësi. Promovimet janë bërë, zakonisht në kuadër të panaireve të librit, por ndonjëherë është bërë promovimi special i librave të krijuesve. Deri më tash janë promovuar librat e: Rifat Kukajt, Agim Vincës, Flora Brovinës, Don Shan Zefit, Shaip Krasniqit, Xhemë Karadakut, Angjelina Gjekës, Sabit Rrustemit, Ismajl Sylës, Faik Shkodrës, Reshat Ramadanit, Fadil Kadriut, Bislim Pirevës, Alban Ajetit, Prend Buzhalës etj. Në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport është organizuar Mbrëmje Letrare kushtuar poetit të njohur Ali Podrimja.

Shpërblimet për mikun e librit, lexuesin më të mirë dhe librin më të lexuar

Biblioteka Ndërkomunale "Fan S. Noli" nga Gjilani ka dhe do të ketë synim parësor çdo gjë të mirë për librin dhe rreth librit. Projektet për t'u realizuar janë të shumta, por edhe ato që janë realizuar nuk janë të pakta. Në fillim, siç u cek më lart, u desh sanimi i gjendjes kaotike nëpër biblioteka, u desh pasurimi me fond librar, pajisja me mjete dhe orendi të domosdoshme, për një punë sado normale. U desh aq shumë të bëhej në kthimin e vetëdijes se libri është vërtet një mik i njeriut, pa të cilin nuk mund të mendohet. Dalëngadalë, njerëzit në forma të ndryshme filluan ta ndihmojnë Bibliotekën, filluan ta ndihmojnë librin shqip. Ndihmat erdhën nga njerëz dhe subjekte të ndryshme. Pa ndihmën e tyre Biblioteka jonë dhe fondi librar në to do të ishte krejt ndryshe. Nuk do të ndihej kjo gjallëri. Nuk do të arrinim këtë sukses. Përkundër punës titanike, Biblioteka do të mbetej prapa, po të mos ishin njerëzit dashamirë të librit, njerëzit që ndanë një pjesë nga vetja, për t'ia ofruar këtij tempulli të diturisë. Pikërisht për këtë, Biblioteka në vitin 2001 themeloi Shpërblimin "Miku i Librit", i cili solemnisht në shenjë falënderimi do t'u jepet atyre që kontribuojnë, në mënyrë të veçantë, për Bibliotekën dhe librin. Për herë të parë Shpërblimin "Miku i Librit" e mori atdhetari, bamirësi, miku i vërtetë i Bibliotekës dhe i librit në përgjithësi, Imzot Mark Sopi. Ndihma e Imzot Mark Sopit dhe Kishës Katolike është e gjithanshme, e duhet veçuar dhurimin e 1000 librave të rëndësishme në vlerë prej 10.000 DM, të

cilat pasuruan dukshëm fondin librar të Bibliotekës sonë. Në vitin 2002 Shpërblimin "Miku i librit" e mori donatori i përhershëm i saj z. Bejtullah Kçiku, pronari i Ndërmarrjes "Bejta Commerce" nga Gjilani, i cili nuk kurseu asnjëherë për t'i dalë në krah Bibliotekës, që nga ditët e para të pasluftës. Lista e donatorëve është e gjatë. Atë e ndihmuan, në mënyra të ndryshme, edhe ndërmarrjet private, edhe institucionet, edhe individët dashamirë të librit, edhe krijuesit. Besojmë se shumëkush prej tyre në të ardhmen do të jenë të nderuar me Shpërblimin "Miku i Librit". Biblioteka, në bazë të evidencës së udhëhequr, përherë zgjedh edhe Lexuesin më të mirë për të rritur dhe për të vegjël, në shenjë respekti dhe mirënjohjeje. Po ashtu, shpallet edhe libri më i lexuar për të rritur dhe për fëmijë.

Binjakëzimi

Me qëllim të shkëmbimit të njohurive dhe të literaturës së nevojshme, me qëllim të njohjes së përvojave me bibliotekat, që kanë një traditë të gjatë të punës dhe të menaxhimit të punëve bibliotekare dhe me qëllim të miqësimit me punëtorë e profesionistë të kësaj natyre, Biblioteka "Fan S. Noli" nga Gjilani është binjakëzuar me këto biblioteka, jashtë Kosovës: Bibliotekën Publike nr. 5 të Tiranës, Bibliotekën Publike "Bogdan Ogrezoviq" nga Zagrebi dhe Bibliotekën Publike "Thimi Mitko" të Korçës.
Binjakëzimi, si një formë e bashkëpunimit, do të vazhdojë edhe me ndonjërën nga bibliotekat e tjera, me qëllim që rrethi i bashkëpunimit të zgjerohet në përputhshmëri me nevojat e lexuesve dhe me kërkesat e kohës.

Ndihma e ofruar për bibliotekat komunale të rajonit

Biblioteka Ndërkomunale "Fan S. Noli" e Gjilanit ka një bashkëpunim shumë të mirë me bibliotekat komunale të: Dardanës, Vitisë dhe Artanës. Bashkëpunimi me këto biblioteka ndërlidhet kryesisht në ndihmën profesionale, që u ofrohet këtyre bibliotekave, si dhe në pasurimin me fond librar. Këto biblioteka publike kanë edhe hallet e problemet e veta, të cilat edhe sot e kësaj dite nuk i kanë zgjidhur. Për shembull, bibliotekat veprojnë në kuadër të shtëpive të kulturës dhe do të ishte shumë më mirë po të punonin të pavarura, në mënyrë që menaxhimin ta bënin në përputhshmëri me nevojat e kohës.

Në gjendje më të mirë është Biblioteka Publike e Artanës, në kuadër të së cilës u hapën 3 biblioteka të reja, duke arritur që në një bibliotekë të kenë qasje 1 200 banorë. Biblioteka "Fan S. Noli" e Gjilanit u ka ofruar këtyre bibliotekave ndihmë përmes organizimit të trajnimeve të ndryshme, të punëtorëve, me qëllim të aftësimit të tyre në organizmin e punëve bibliotekare. Një ndihmë të tillë do ta vazhdojë edhe në të ardhmen.

Gjendja e tashme e Bibliotekës

Duke pasur parasysh të dhënat, që u cekën më lart, mund të konkludohet se Biblioteka gjatë këtyre 4 vjetëve ka pësuar ndryshime rrënjësore. Këto ndryshime mund të vërehen që nga hyrja në oborr deri në çdo hapësirë të objektit të saj. Fondi i tërësishëm i Bibliotekës, me degët e saj, është pasuruar dukshëm dhe arrin shifrën prej 147 684 ekzemplarësh. Këtu nuk janë përfshirë bibliotekat shkollore dhe bibliotekat e institucioneve të ndryshme, të cilat, po ashtu, kanë një numër solid librash e materialesh të tjera bibliotekare. Biblioteka, e cila është e vendosur në një objekt të ndërtuar qëmoti, sivjet pësoi një dëmtim të madh nga tërmeti i 24 prillit. Tërmeti bëri aq dëme të mëdha saqë pamundësoi shfrytëzimin e saj. Punonjësit e Bibliotekës me një vetëmohim të madh iu rrekën punës për të gjetur forma të ndryshme për sanimin e kësaj gjendjeje të rëndë. Ishin donatorët, dashamirë të librit, të cilët nuk kursyen ndihmën materiale dhe çdo ndihmë tjetër, për t'ia kthyer këtij tempulli të diturisë gjallërinë me lexuesit e saj, duke e krijuar një hapësirë edhe më të përshtatshme dhe më të bukur se më parë.

Biblioteka Amë, tashmë ka dhjetë degë nëpër fshatra, të cilat u hapën ose u rihapën gjatë kësaj periudhe. Ato janë: biblioteka në fshatin Bresalc, Llashticë, Përlepnicë, Miresh, Zhegër, Pogragjë, Budrikë, Pasjan, Partesh dhe Koretishtë.

Në Bibliotekën Qendrore veprojnë këta sektorë: Sektori i Përpunimit dhe i Katalogimit, Sektori për Hulumtim dhe Zhvillim, Sektori i Fëmijëve, Sektori i të Rriturve, Sektori Shkencor, Sektori i Krijuesve të Vendlindjes dhe Sektori i Informimit dhe Internetit.

Për punën dhe rezultatet e arritura në bibliotekë, rreth afirmimit, përhapjes dhe mbjelljes së dashurisë ndaj librit, biblioteka jonë dhe punonjësit e saj janë nderuar me shumë mirënjohje, lëvdata dhe diploma, në mesin e të cilave do

veçuar: në vitin 1999 institucionet komunale, bibliotekën e shpallën si institucionin me të suksesshëm kulturor në komunë; në vitin 2000, Shoqata e Punonjësve të Bibliotekave të Kosovës, Bibliotekën "Fan S. Noli" e shpalli Bibliotekën me të mirë në Kosovë; në vitin 2000 Shoqata e Punonjësve të Bibliotekave të Kosovës, drejtorin e Bibliotekës "Fan S. Noli" e shpalli punëtorin më të mirë bibliotekar në nivel të Kosovës; në vitin 2001, Kuvendi Komunal, Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport, drejtorin e Bibliotekës "Fan S. Noli" e shpall punëtorin më të mirë; në vitin 2002, Kuvendi Komunal, Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport, Bibliotekën "Fan S. Noli" e shpalli si institucionin më të dalluar në segmentin e kulturës.

(Kumtesë e paraqitur në tryezën me bibliotekarë "Gjendja në bibliotekave të Kosovës 1990-2005", e mbajtur më 16 prill 2005 në Prizren)

Teuta DEMIRI
Drejtoreshë e Bibliotekës Ndërkomunale "Anton Çetta" në Ferizaj

Veprimtaria e Bibliotekës Ndërkomunale "Anton Çetta" 1989-2005

Historik i shkurtër

Me përmbylljen fitimtare të kapitullit çlirimtar, sprovës tonë kombëtare më të vështirë historike, kemi hapur perspektivën e gjithanshme të jetës së lirë. Në rrethana të reja lirie kemi fatin dhe përgjegjësinë e ndërtimit të një realiteti të ri bashkëkohor e përparimtar në të gjitha drejtimet e jetës. Preokupimi i përgjithshëm, rifillues, i një përvoje të re, vetëm sa hap perspektivën e jetësimit të vlerave të kultivuara kombëtare dhe njerëzore për një qytetërim të ri dhe, kjo nuk parakupton se jeta e një populli fillon me çlirimin e tij. Kultura përbën shtyllën vertebrale të një populli. Libri është arteria më ushqyese që përvijon vazhdimësinë kulturore të njeriut nga e kaluara në të sotmen dhe e përcjell drejt së ardhmes, si një tërësi vlerash dhe përvojash zhvillimore në përgjithësi. Shpirti i jetës së një populli është kultura e tij, e cila jo vetëm fitohet e trashëgohet, por edhe krijohet, duke përvijuar ndër gjenerata, si një vlerë e gjithmbarshme njerëzore, që tejkalon përmasat individuale, për t'u shndërruar në bashkëkohësinë universale të qytetërimit.

Në tërësinë zhvillimore të kultivimit dhe të përparimit kulturor, arsimor e shkencor, institucioni i bibliotekës ka rëndësinë e veçantë dhe të pazëvendësueshëm. Biblioteka, jo vetëm grumbullon pasurinë e mençurisë njerëzore të të gjitha qytetërimeve dhe të të gjitha kohëve, por edhe përhap ushqyeshëm gjithë diturinë e kultivuar mendore e shpirtërore në shërbim të një të ardhme, gjithnjë e më të bukur.
Edhe Biblioteka Ndërkomunale "Anton Çetta", që nga themelimi i saj, prej disa dekadash dhe veçanërisht pas luftës, ka krijuar, ka zhvilluar dhe ka përhapur traditën e shkëlqyer të komunikimit, të njohjes, të edukimit e të zhvillimit kulturor e qytetërues për lexuesin dhe qytetarin ferizajas.
Biblioteka në Ferizaj është themeluar në vitet '50-të, nga Këshilli i rrethit të Ferizajt, e emërtuar si Biblioteka e Qytetit. Në vitin 1961 emërohet Biblioteka Amë. Fondi librar i bibliotekës së themeluar ka numëruar 400 libra dhe ka punuar vetëm me një punëtor. Në kuadër të kësaj biblioteke kanë funksionuar edhe degët e saj në Nerodime, në Talinocin e Muhaxherëve, në Gaçkë dhe në Shtime. Në vitet '80-të janë formuar edhe degët në Komogllavë dhe në Babush, ndërsa në vitin 1993 biblioteka në Dardani. Me themelimin e komunave të Shtimes dhe Shtërpcës këto degë ndahen nga biblioteka qendrore e Ferizajt.
Puna në bibliotekë është bërë në nivel të standardeve dhe të normave të veprimtarisë bibliotekare: Sistemi i renditjes sipas Klasifikimit Universal Decimal (KUD), përpunimi i ISBD(M), si dhe skedari alfabetik dhe ai i autorëve. Fondi librar i bibliotekës, në vitin 1992 ka numëruar 51 000 libra prej të cilit 80% ka qenë beletristikë, ndërsa fondi tjetër literaturë shkencore. Krahas fondit librar, biblioteka kishte edhe materiale periodike.

Periudha e pasluftës

Edhe në bibliotekën tonë u ndien pasojat e rënda të luftës, sidomos në zhdukjen e koleksioneve në gjuhën shqipe, i cili u gjet i përgjysmuar. Në kushte shumë të vështira teknike dhe me mungesë të kuadrit: mungesë libri, personeli dhe fondi, asgjësim të skedarëve ekzistues, biblioteka rifilloi punën më 5 punëtorë. Përballja dhe tejkalimi i vështirësive u mundësua me ndihmën e Fondacionit "Soros", i cili kontraktoi renovimin e ambienteve të bibliotekës dhe u krijuan kushte të nevojshme teknike në funksion të punës së mirëfillte

dhe në shërbim të lexuesit.
Në bibliotekë u instalua edhe interneti, si dhe iu dhuruan 10 kompjuterë, si një mundësi dhe përvojë e re e komunikimit dhe qasjes bashkëkohore në zhvillimet e përmasave të gjera. Kështu, biblioteka arriti shpejt të tërheqë vëmendjen dhe interesimin e qytetarit ferizajas, por jo edhe të institucioneve komunale, që treguan vetëm mospërfillje për çfarëdolloj përkujdesjeje a ndihme, pa u munduar të blinin qoftë edhe një libër të vetëm. Përkundrazi, Kuvendi Komunal ndërmori edhe vendime të dëmshme për veprimtarinë bibliotekare, duke mbyllur bibliotekat e degëve në Gaçkë dhe në Babush, kurse fondin librar e barti në shkollën fillore të Gaçkës, përkatësisht, në biblioteka të tjera. Pas shumë vështirësive, biblioteka nën emërtimin Biblioteka Ndërkomunale, kaloi nën përkujdesjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Çështjeve Jorezidente. Me këtë u hap edhe një perspektivë e përgjithshme e sukseseve të vazhdueshme. Ky sukses, gjithnjë në rritje, i dedikohet punës së palodhshme, të përgjegjshme dhe profesionale të personelit të bibliotekës, Ministrisë së Kulturës, Fondacionit "Soros", si dhe qytetarëve ferizajas.
Me kalimin e bibliotekës nën menaxhim të Ministrisë së Kulturës në vitin 2002 filloi edhe epoka e sukseseve të gjithmbarshme, që reflektohet në pasurimin e fondit librar, krijimin e kushteve të përshtatshme, në rritjen e numrit të punëtorëve (që tani është dhjetë), në ngritjen e sektorëve të nevojshëm, në profesionalizimin dhe efikasitetin e shërbimeve bibliotekare dhe shtimin e vazhdueshëm të numrit të lexuesve. Biblioteka, për herë të parë në historinë e vet, është emëruar me emrin e personalitetit shqiptar, Anton Çetta, më 19 korrik të vitit 2001. Ndërsa, në korrik të vitit 2004, u vendos edhe busti i profesor Anton Çettës, i financuar nga qytetarët ferizajas. Degët e bibliotekës janë në Talinoc të Muhaxherëve, Nerodime, Komogllavë dhe Dardani, me fond librar 12 499. Në degët e bibliotekës, çdo vit, anëtarësohen 1 302 lexues me 16 164 libra të lexuara.
Tani, biblioteka e zhvillon veprimtarinë në këta sektorë:

1. Sektorin i huazimit të librit për fëmijë;
2. Sektorin i huazimit të librit për të rritur;
3. Sektorin i informatikës;
4. Sektorin i katalogimit të librit;

5. Sektorin i hulumtimit dhe i zhvillimit;
6. Sektorin i financave;
7. Sallën e leximit për të rritur dhe
8. Sallën e leximit për fëmijë.

Sot, koleksionet në gjuhën shqipe numërojnë 13 597 ekzemplarë, në gjuhën serbe 4 000, në gjuhën angleze 177 dhe në gjuhën gjermane 586. Pra, 18 360 libra me 5 426 tituj në gjuhën shqipe. Biblioteka ka edhe periodikun nga vitet '70, si: "Rilindjen"dhe gazetën në gjuhën serbe "Politika" deri në vitin 1990, revistat "Përparimi", "Bota e re", "Jeta e Re" ndërsa në ditët e sotme pasurohet me tri gazeta ditore dhe me dy revista javore. Biblioteka anëtarëson 3000 lexues në vit, të cilët përdorin 53 497 njësi bibliotekare. Sallën e leximit e shfrytëzojnë 13 620 lexues.
Në kuadër të profesionalizimit të punës është formuar edhe Këshilli i bibliotekës, i cili këshillon dhe sugjeron rreth punëve të bibliotekës.
Krahas punës themelore, që bëhet në bibliotekë, organizohen dhe veprimtari të tjera në shërbim të afirmimit të librit dhe kulturës në përgjithësi. Organizimet janë të karakterit afirmativ kulturor e arsimor, si: ekspozita të veprave artistike, orë letrare, takime me shkrimtarë, debate publike, ekspozita koleksionesh, manifestime kulturore, zgjedhja e lexuesit më të mirë, grupi letrar i bibliotekës, konkurse letrare, promovime etj.
Biblioteka bashkëpunon me shumë biblioteka të tjera dhe është binjakëzuar me Bibliotekën "Shefqet Musaraj" të Vlorës. Bashkëpunimet karakterizohen me dhurim të koleksioneve dhe shkëmbim përvojash. Kemi bërë përpjekje për t'u binjakëzuar edhe me ndonjë bibliotekë nga shtetet perëndimore.
Stafi i bibliotekës ka marrë pjesë në seminare dhe trajnime të vazhdueshme në Kroaci, në Ulqin, në Shqipëri, si dhe në trajnimet e organizuara nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Ministria e Kulturës. Biblioteka ka ndihmuar me koleksione bibliotekat në degë, si: bibliotekën e Shtimes, të Kaçanikut, të Shtërpcës, të Malishevës, të Rahovecit, bibliotekën shkollore në fshatin Jezerc, si dhe bibliotekën e qytetit të Peshkopisë. Kurse, bibliotekës sonë i kanë ndihmuar: Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, "Sorosi", Qendra për Përparim, Edukim dhe Arsimim, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Ministria e Kulturës, KFOR-i amerikan dhe qytetarë të ndryshëm ferizajas.

Bibliotekat e tjera publike

Në mungesë të të dhënave konkrete nga bibliotekat në Kaçanik dhe në Shtërpcë nuk kemi mundur të paraqesim gjendjet e këtyre bibliotekave.
Biblioteka Publike e Kaçanikut ka filluar të funksionojë më 01.10.2001. Këtë bibliotekë e financoi KK dhe organizatat ndërkombëtare: USAID, AOF, KTI dhe Save the Children. Pasurimin e bibliotekës me fond librar, për të parën herë, e bëri IOM. Fondi librar i bibliotekës publike ka 5 302 tituj me 16 762 kopje. Në bibliotekë funksionojnë 15 salla leximi e pune, ku frekuentojnë shumë studentë, nxënës dhe qytetarë. Në të janë punësuar 9 punëtorë. Biblioteka ka rrjetin e Internetit me 8 kompjuterë, sallën e arkivimit, të shtypit periodik, një sallë leximi për fëmijë dhe një kënd për leximin e shtypit. Në lokalet e bibliotekës zhvillohen edhe aktivitete të ndryshme, si: hapje ekspozitash, tribuna shkencore, orë letrare dhe promovime. Çdo vit anëtarësohen 1 700 lexues dhe prej 30 000 frekuentues.
Biblioteka e Shtimes ka filluar të funksionojë pas Luftës se Dytë Botërore, si degë e bibliotekës së Ferizajt. Fillimisht ka punuar në objektin e ish-kooperativës bujqësore. Në vitin 1989 biblioteka numëronte 6 000 libra, prej të cilave 3 500 në gjuhën shqipe, të tjerat në gjuhën serbe dhe turke. Gjatë okupimit të pushtetit serb, lexuesit shqiptar asnjëherë nuk patën qasje në bibliotekë. Në vitin 1995, biblioteka u mbyll dhe fondi librar u transferua në ish-shkollën fillore, kurse tani është Shkolla e Mesme "Naim Frashëri". Gjatë pushtimit serb, librat e shkruara nga autorët nga Shqipëria u asgjësuan dhe mbetën kryesisht titujt e librave sllavë. Pas luftës, numri i librave të shpëtuara ishin 1 300, pa asnjë dokument tjetër, që i përkiste bibliotekës. Pas dy vjetësh u mor iniciativa nga KK-ja që përsëri të formohet biblioteka në ish-shkollën e vjetër, me 1 000 libra. Më pas biblioteka u zhvendos në një lokal afër KK-së dhe hapësira momentale është 56 metra katrorë.
Në gusht të vitit 2003, Biblioteka Ndërkomunale "Anton Çetta" në Ferizaj, ia dhuroi bibliotekës së qytetit të Shtimes 200 libra. Kjo bibliotekë ka nevojë të pasurohet edhe më shumë, posaçërisht me lekturën shkollore.
Fondi librar i bibliotekës është: në gjuhën shqipe 1 886 libra me 1 231 tituj, në gjuhën angleze 34 libra me 22 tituj, në gjuhën gjermane 71 libra me 70 tituj.

(Kumtesë e paraqitur në tryezën me bibliotekarë: "Gjendja e bibliotekave publike në Kosovë 1990-2005", të mbajtur më 16 prill 2005 në Prizren)

Mr.Tahir FONIQI
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Veprimtaria botuese - informative e bibliotekave në Kosovë

Fushë e rëndësishme e bibliotekave është edhe veprimtaria botuese-informative. Biblioteka nuk duhet të jetë vetëm një "servis", për të dhënë libra në shfrytëzim, por në të duhet të zhvillohet jetë dinamike e brendshme, përmes formave të punës bibliotekare: ekspozitave, orëve letrare, trajnimeve, veprimtarisë botuese etj.
Veprimtaria botuese-informative në Kosovë ka filluar më l959, me botimin e buletinit "Bilten", përkatësisht "Nasha praksa", që ka dalë deri më l966, organ i Qendrës së Bibliotekave të Kosovës, botim i shaptilografuar. Kjo veprimtari në Kosovë është zhvilluar me vakume, ku dallohen tri periudha: l973-l986, l988-2OO2 dhe 2OO3- 2OO5. Ndërkaq, vitet l944-l972 njihen si periudhë shterpë në këtë fushë.
Gjatë periudhës l959-korrik 2OO5 bibliotekat kanë botuar dyzet e gjashtë tituj: 41 të librave e 5 të periodikut, pa i llogaritur botimet efemere dhe ato në gjuhën serbokroate, të botuara gjatë periudhës l99O-l999.
Me veprimtari botuese-informative, deri më tash, janë marrë Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe bibliotekat publike.

Botimet e BKU të Kosovës

Veprimtarinë botuese-informative kjo bibliotekë e ka filluar më l973 me katalogun Një pasqyrë e veprimtarisë botuese në Kosovë=Pregled izdavaçke delatnosti na Kosovu, Prishtinë, l973. Prej këtij viti deri në qershor 2OO5 kjo bibliotekë ka botuar 36 tituj: 34 të librave e 2 të periodikut: "Biblioteka" (ka dalë vetëm numri l/ l984), organ i Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës dhe "Biblioletra"(ka filluar të dalë në mars 2OO4), organ i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.
Në vijim, po i japim disa nga titujt më të arrirë të kësaj biblioteke, duke u ndalur sidomos te ata të viteve 2OO3-2OO5:

l. IFLA: Parimet mbi Përkujdesjen dhe Përdorimin e Materialit Bibliotekar, hartuar nga Edward P. Adcock, Prishtinë, 2OO4;
2. Java e Bibliotekës në Kosovë, 7-l3 prill 2OO3, Prishtinë, 2OO4;
3. Java e Bibliotekës në Kosovë = Library week in Kosova, l9-24 Prill-April,2OOO, Prishtinë, 2OO5;
4. Tahir Foniqi: Bibliografia e revistës Koha l978-l989, Prishtinë, 2OO4;
5. Gjon Berisha: Bibliografia e revistës Kosova l972-2OO3, Prishtinë, 2OO4;
6. Bedri Gashi: Sfidat e zhvillimit të bibliotekave publike në Kosovë, Prishtinë, 2OO4;
7. Vehbi Miftari: Bibliotekat në Kosovë dhe qasja në informata, Prishtinë, 2OO4;
8. Bedrije Mekolli: Problemet e përgjithshme të ruajtjes dhe konservimit të materialit bibliotekar, Prishtinë, 2OO5 etj.

Në mënyrë të veçantë janë pritur mirë botimet nën numrin rendor 4, 5 e 6. Kështu, për Bibliografinë e revistës Koha është thënë edhe kjo: "Për rëndësinë e Bibliografisë dëshmon shumë puna e palodhshme e autorit, që ka sistemuar 2 359 njësi bibliografike dhe mënyra se si janë sistemuar gjatë librit, duke ua lehtësuar shumë punën studiuesve të ndryshëm, për të cilët ka material kjo revistë". Në këtë bibliografi, për herë të parë në tekstet e botuara bibliografike në gjuhën shqipe në Kosovë, mbase edhe në Shqipëri, futet tërësia lëndore: Artet pamore.
Ndërkaq, për tekstin Bibliografia e revistës Kosova : l972-2OO3 thuhet:

"Botimi i Bibliografisë... është një lehtësim për punën e atyre që merren me shkencën e historisë për gjetjen e numrave dhe temave të ruajtura në faqet e revistës Kosova" . Bibliografia e revistës Kosova : 1972-2003 është hartuar me bazë alfabetike globale dhe kronologjike. Ajo është pasuruar edhe me treguesin alfabetik të autorëve. Ndërsa, libri i Bedri Gashit Sfidat e zhvillimit të bibliotekave publike në Kosovë "me përkushtim dhe në mënyrë profesionale i qaset problemeve me të cilat ballafaqohen sot bibliotekat publike në Kosovë" . Ky libër është sprovë e mirë në këtë përpjekje, ndërkohë që autori duhet të kërkojë edhe sfida të tjera brenda këtyre bibliotekave, si përpunimi profesional i materialit bibliotekar, politika kuadrore, roli arsimor e kulturor i bibliotekave të përmendura, veprimtaria botuese etj.
Mund të thuhet se me botimet e fundit sidomos, BKU e Kosovës e ka stabilizuar mirë
veprimtarinë e saj botuese-informative, me kusht që, në të ardhmen, ajo duhet t'i kushtojë kujdes botimit të literaturës teorike bibliotekare, përmes përkthimit e formave të tjera të botimit.

Veprimtaria botuese-informative e bibliotekave publike

Këtë veprimtari, bibliotekat publike në Kosovë e kanë filluar më l978 me botimin serik të shaptilografuar Fëmijët e Jehonës, botim i Bibliotekës Komunale të Klinës, që ka dalw gjatë periudhës l978-l986.
Ndërkaq, gjatë periudhës 2OO3-korrik 2OO5, ky tip i bibliotekave ka botuar dhjetë tituj: një titull periodiku Oaza dhe nëntë tituj librash: monografi për bibliotekat dhe pwr letërsi. Prej këtyre titujve pesë i ka botuar Biblioteka Ndërkomunale e Prishtinës dhe nga dy Biblioteka Ndërkomunale "Xhemajli Berisha" e Prizrenit dhe Biblioteka Ndërkomunale "Fan S. Noli" e Gjilanit dhe një Biblioteka Ndërkomunale "Anton Çetta" e Ferizajt. Ja disa nga këta tituj:

l. Monografi për Bibliotekën Ndërkomunale të Prizrenit, përgatitën: Sahadete Sadikaj, Mr. Tahir Foniqi, Abdullah Thaçi, Berat Batiu, Prizren, 2OO4;
2. Kalliri i plotë : shënime bio-bibliografike dhe shkrime të tjera për Odhise Grillon (l933-2OO3), materialin e mblodhi dhe e përgatiti për shtyp Sabit Jaha, Gjilan, 2OO4;
3. Ta dëgjoj jetën, poezi, redaktor Agim Gjakova, Prishtinë, 2OO3;

4. Donjeta Gashi: Në syprinë të shpresës, poezi, Prishtinë, 2OO3;
5. Kastriot Berisha: Sy vjeshte, poezi, Prishtinë, 2OO4 etj.

Tipat e tjerë të bibliotekave: universitare, speciale e shkollore nuk kanë zhvilluar veprimtari botuese gjatë periudhës në shqyrtim: l944-qershor 2OO5.
Kështu, Monografia për Bibliotekën Ndërkomunale të Prizrenit, sipas Sahadete Sadikajt "mëton të paraqesë punën 6O-vjeçare të këtij institucioni kulturor dhe arsimor në Prizren". Ndërkaq, nga libri Kalliri i plotë veçojmë këtë citat: "Veprat e Odhise Grillos janë shkruar në kohë dhe situata të ndryshme. Secila vepër, në mos me tërësinë e saj, së paku me pjesët e thurura me mendime e stil figurativ arsyetojnë shenjën dalluese të kohës".
Nismë të mirë botuese ka shënuar sidomos Biblioteka Ndërkomunale "Hivzi Sulejmani" e Prishtinës, e cila, për vetëm tre vjet, ka botuar pesë tituj: një botim serik Oaza, revistë letrare, me kryeredaktor Veli Veliun; monografinë Biblioteka Ndërkomunale "Hivzi Sulejmani"= Intermunicipal Library of Prishtina "Hivzi Sulejmani", Këshilli Redaktues: Sylejman Pireva, Fatime Mehmetaj, Veli Veliu, Hyrie Hoti dhe tre tituj poetikë për të rritur: Donjeta Gashi, Në syprinë të jetës, Prishtinë, 2OO3; Ta dëgjoj jetën, vëllim shumautorësh, Prishtinë, 2OO3 dhe Kastriot Berisha, Sy vjeshte, Prishtinë, 2OO4, duke u bërë kështu, biblioteka, vatër e dalluar e aktiviteteve kulturore e letrare-artistike.

Rezultate e mangësi

Por, ka në këto botime edhe shkrime të diskutueshme (plagjiatë e kompilime tekstesh), si dhe mangësi të tjera profesionale. Kështu, në revistën Biblioletra gjejmë edhe këto shprehje: "Pas përshkrimeve historike të bibliotekës dhe fytyrave të ndritura të bibliotekarisë shqiptare…" (këtu mbase është bërë ndonjë ngatërrim me shprehjet: "Bibliografi kombëtare", "Bibliografi shqipe" etj.). Nuk më duket e qëlluar as shprehja: "bibliotekaria kosovare". Kurrkund nuk haset: "bibliotekari amerikane", "bibliotekari britanike" etj., sikurse nuk haset: "kimi amerikane", "kimi britanike" etj. Nuk qëndrojnë as shprehjet: "për personalitetin e bibliotekarëve", "profesioni i bibliotekarëve". Së voni, janë botuar edhe dy libra voluminozë të BKU të Kosovës: Katalogu Alfabetik i librit në gjuhën shqipe 2OOO-2OO2; Katalogu Alfabetik i librit

në gjuhën shqipe 2OO3 dhe Katalogu Alfabetik i librit në gjuhë të huaja=Alphabetic Catalogue of books on foreign languages 2OOO-2OO3.
Titulli i këtyre botimeve duhet të jetë: Libri shqip : (Hyrjet në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës 2OOO-2OO2, përkatësisht Libri i huaj : (Hyrjet në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës 2OOO-2OO3). Këto botime nuk janë pasqyrë reale e të gjitha botimeve të hyra në këtë bibliotekë, gjatë periudhës 2OOO-2OO3. Për ilustrim, po përmendim, librin Simfoni e mallit nga Ragbete Zabërgja-Uka, Prishtinë, 2OO2. Në anën tjetër, në këta libra, kanë hyrë edhe botimet e viteve l993, l995, l996, l997, l998, l999 etj. Po ashtu, këtu janë ngatërruar edhe vitet e botimeve të njësive bibliografike. Po e zëmë libri i Brikenë Cerajës Fytyra e babait është botuar më 2OO2 e jo më 2OO3. Në këto botime ka edhe gabime gjuhësore.

LITERATURA

1. "Biblioletra", Prishtinë, 2OO5, Numri l (Prill), f. 24;
2. Adem Abazi, "Bibliografia e revistës Kosova". "Koha Ditore", Prishtinë, 2OO4, 3O nëntor 2OO4, f. l8;
3. Po aty, f. l8;
4. "Zëri", Prishtinë, 25 qershor 2OO5, f. 2l;
5. Dr. Sc. Faik Shkodra, "Krijimtaria e Odhise Grillos"-intonim i veçantë e ligjëratë specifike poetike. "Kalliri i plotë: shënime bio-bibliografike dhe shkrime të tjera për Odhise Grillon (l933-2OO3), Gjilan, 2OO4, f. 3l;
6. "Biblioletra", Prishtinë, 2OO4, Numri l (Mars), f. 24, l4;
7. "Biblioletra", Prishtinë, 2OO5, l, (Prill), f. l3, l5;
8. "Biblioletra", Prishtinë, 2OO5, Numri l (Prill), f. l3-l5;
9. "Katalogu Alfabetik i librit në gjuhën shqipe 2OOO-2OO2", Prishtinë, 2OO5, f. 475, 487, 494, 5l3;
10. "Katalogu Alfabetik i librit në gjuhën shqipe 2OO3", Prishtinë, 2OO5, f. lO, 72, l2l, 2Ol, 5O9, 549.

Botues:

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË 3

Shtypi:
"Prograf"
Prishtinë

Prishtinë,
2006

Katalogimi në botim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

021.4 (496.51)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës (Prishtinë)
Java e Bibliotekës në Kosovë = Library Week in Kosova : 11-16 Prill = April 2005 ; 3 / [Kryeredaktor i botimeve Sali Bashota].- Prishtinë : Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, 2006 (Prishtinë : Prograf).- 151 f. ; ilustr. ; 21 cm.- (BKUK : Botime të veçanta : Java e Bibliotekës ; 3)

ISBN 9951-13-018-6